



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

TRANSKRIPT

I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,  
E MBAJTUR MË 30 DHE 31 KORRIK 2015

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,  
ODRŽANE 30. I 31. JULA 2015. GODINE

KORRIK - JULI  
2015

## **Rendi i ditës**

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,
4. Interpelanca e ministrit të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, z. Memli Krasniqi,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për digjitalizimin e transmetimeve radiodifuzive tokësore.
6. Zgjedhja e pesë (5) anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.

## **Dnevni red**

1. Vreme za izjave van dnevnog reda,
2. Vreme za skupštinska pitanja,
3. Usvajanje zapisnika sa prethodne sednice,
4. Interpelacija Ministra za poljoprivredu, šumarstvo i ruralni razvoj, g. Memli Krasniqi,
5. Drugo razmatranje N/zakona o digitalizaciji zemljanih radiodifuzivnih prenosa,
6. Izbor pet (5) članova Borda Radio televizije Kosova.

## **Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.**

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

### **1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës**

Koha për deklarime jashtë rendit të ditës është e kufizuar deri në 30 minuta, diskutimi në emër të grupit parlamentar zgjat deri në 5 minuta, ndërsa diskutimi i deputetit deri në 3 minuta.

Deputetët e paraqitur për diskutim duhet të deklarohen se në çfarë cilësie e kërkojnë fjalën.

Fjalën e ka Margarita Kadriu-Ukelli, pa grup.

MARGARITA KADRIU-UKELLI: I nderuar kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Javën e kaluar u votua Projektligji për faljen e borxheve, që përfshin detyrime të personave fizikë dhe juridikë, në vlerë prej 680 milionë eurosh. Ministri i Financave, në fjalën e tij, kur e pati prezantuar këtë projektligj, tha se kryesisht përfitojnë rastet e njerëzve me vështirësi ekonomike, me mirëqenie të dobët, por mungesa e transparencës së plotë ka krijuar një dozë të pritshme dyshimi se kush në të vërtetë po përfiton, pas kaq shumë vjetësh.

Në listën e borxhlinjve ka edhe biznese që u janë shmangur pagesës së taksave, falë tolerimit korruptiv, që ua kanë bërë administratat respektive - Doganat dhe Administrata Tatimore.

Për të shmangur e për të mos lejuar përhapjen e pritshme të dyshimeve të ligjshme të opinionit të gjerë, e sidomos të bizneseve që rregullisht i kanë paguar të gjitha detyrimet ndaj shtetit, në këtë rast Ekzekutivi do të duhej të ishte plotësisht transparent dhe ta publikojë menjëherë listën e përfituesve nga falja e borxheve që përfshin amnistia e ligjit në fjalë.

Është mirë që publiku, bizneset, të gjithë, ta shohin vetë se kush është në atë listë, ku përfitohet nga falja e borxheve. Bëhet fjalë për 680 milionë euro, andaj duhet të ketë transparencë të plotë, e cila arrihet vetëm nëpërmjet bërjes publike të listës dhe të vlerave përfituese nga buxheti i shtetit.

Në listë mund të ketë edhe qytetarë të Kosovës që ndoshta as nuk janë ngopur me bukë, e lëre më t'i paguajnë edhe rrymën, ujin, mbeturinat, ngrohjen, tatimin në pronë etj.

Mirëpo, ajo që Qeveria urgjentisht duhet të bëjë, natyrisht nëse nuk ka çka të fshehë, e po dua të besoj se nuk ka arsye të fshehë, është që ta bëjë publike listën e plotë, se cilave biznese iu falën borxhet dhe për çfarë vlerash bëhet fjalë, në mënyrë që të sigurohemi se nuk i kemi amnistuar

kontrabanduesit, shmangësit e tatimeve apo bizneset e lidhura me individë të papërgjegjshëm të administratave të shtetit. Faleminderit!

KRYETARI: Labinotë Demi-Murtezi, në emër të Partisë Demokratike të Kosovës, e ka fjalën.

LABINOTË DEMI-MURTEZI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Në vazhden e problemeve të shumta në vendin tonë po shkojnë duke u rritur ato që kanë të bëjnë me moralin individual të përgjithshëm dhe duke rrëshqitur kështu drejt një krize të thellë morale në vendin tonë.

Lajme të shumta e kronika të zeza, si ato: Policia manipulon me vajza të mitura, burri e detyron gruan të ushtrojë prostitucion, mësimdhënësit kryejnë ngacmime seksuale ndaj nxënësve e shumë tituj të tjerë bombastikë na bëjnë të skuqemi kur i lexojmë dhe tani që duhet t'i citojmë ato.

Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit e ka radhitur Kosovën në rendin e dytë të ashtuquajturit 'TIER 2', ku radhiten shtetet, përkatësisht qeveritë e shteteve të cilat nuk i përmbushin kriteret minimale për luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore me qëllim të shfrytëzimit të trafikimit të tyre seksual.

Sipas këtij raporti, gratë dhe vajzat i nënshtrohen trafikimit seksual nëpër shtëpi private, klube të natës dhe komplekse të masazheve. Kosova si shtet i ri pa dyshim se ka shumë sfida para vetes, por ky raport i përshkruar mjaft detajisht e paraqet Kosovën si destinacion për gratë, burrat dhe fëmijët të cilët i nënshtrohen trafikimit seksual dhe punëve të dhunshme të detyruara.

Nuk duhet mbyllur sytë as qëndruar duarkryq. Edhe pa një raport të tillë, e kemi ditur se gjendja është alarmante. Morali i shoqërisë sonë po bie, ndërkaq Qeveria duhet ta tregojë vigjilencën e saj dhe bashkëpunimin me organet e rendit dhe të sigurisë për t'i luftuar dukuritë negative që po e shkatërrojnë shoqërinë tonë, dikur shumë të shëndoshë.

Për përgjegjësi sigurisht më e madhe do të ishte e kryeministrit të vendit, gjithashtu edhe e ministrit të Punëve të Brendshme për ta hartuar një strategji efektive, e cila do t'i inkurajonte gjithë qytetarët për bashkëpunim.

Të nderuar qeveritarë,

Publikoni emrat e policëve keqpërdorues së detyrës duke abuzuar me të miturat, suspendoni ose largoni fare nga puna mësimdhënësit që i ngacmojnë nxënëset e tyre, mbyllni lokalet e ndryshme, kafeteritë e shumta në bashkëpunim me qeverisjet lokale që janë më afër shkollës, edhe se bibliotekat e libraritë e shumta që duhet t'i kenë qytetet, ndërmerrni edhe hapa të tjerë pos këtyre, dhe shiheni pastaj gjendjen e atyre vajzave, grave të cilat përpijnë gjithçka për të mos e humbur vendin e tyre të punës.

Me të tilla iniciative që janë jetike substanciale për prijësit e vendit nuk ngarkohet buxheti shtetëror, por në një formë a tjetër shihet se sa është e përkushtuar Qeveria dhe të gjitha institucionet për të garantuar siguri dhe mirëqenie për të gjithë qytetarët e tyre. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ali Sadriu, në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, e ka fjalën.

ALI SADRIU: Faleminderit, zoti kryetar!

Nderime për ju ministër,

Të nderuar deputetë,

Dua të ngreh një shqetësim që në Komisionin për Mbikëqyrje të Financave Publike është identifikuar një dukuri, kur në një udhëtim zyrtar, i cili përgatitet të jetë diku më 7 shtator, që duhet t'i bëhet Bundestagut Gjerman kërkohet që të sigurohen pasaportat e reja fillimisht. Unë e kam pasur pasaportën diplomatike, që afatin e ka pasur mbi 10 muaj, është kërkuar që të ndërrohet ajo pasaportë. I kemi ndërruar disa që na është kërkua, e së fundit kërkohet edhe një certifikatë e bashkësisë familjare, gjë që mua më ka prekur në dinjitet, jo mua, por e ka prekur institucionin se deri në çfarë niveli kemi degraduar.

Unë jam njëri nga ministrat e parë në kohën e protektoratit, e mandej edhe nën mbikëqyrjen e pavarësisë, e gjëra të tilla nuk janë kërkuar nga deputetët. Çka nënkupton certifikata e bashkësisë familjare? Nënkupton se unë duhet ta siguroj ambasadën në këtë rast se nuk kam pretendime që të shkoj dhe të emigroj në Perëndim. Ky është një denigrim që asnjëri s' duhet ta pranojë dhe unë e them publikisht mendimin tim, por sa kam dëgjuar edhe shumë anëtarë të tjerë të komisionit, ne do ta refuzojmë këtë ndihmë që është shumë e domosdoshme për komisionin, por me një ofendim të tillë unë nuk do të shkoj.

Por, ju lutem, pasaporta është diplomatike, e ku është kuptimi i saj? Çfarë kuptimi paska pasaporta diplomatike, nëse kërkohet edhe kjo certifikatë? Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Rexhep Selimi, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes "Vetëvendosje", e ka fjalën.

REXHEP SELIMI: Zonja dhe zotërinj deputetë,

Kosova, si shtet i ri me siguri të brishtë dhe të atakuar përditë, herë nga lindja e herë nga veriu, i duhen institucione të sigurisë, të cilat do të ishin garanci e ruajtjes së jetës së qytetarëve dhe ruajtjes së tërësisë territoriale dhe sovranitetit të Republikës së Kosovës.

Por, a i ka Kosova këto institucione?

Qeveria e Kosovës, në listën e institucioneve të autorizuara të sigurisë nuk e ka të listuar atë më kryesoren - ushtrinë për mbrojtjen e sovranitetit dhe integritetit territorial. Madje, as FSK-në nuk e liston në kuadër të institucioneve të autorizuara shtetërore të sigurisë.

Në ndërkohë, nëpër rrugë procedurale, herë në Qeveri e herë në Parlament ka kohë që qarkullojnë amendamentet kushtetuese për shndërrimin e FSK-së në Forca të Armatosura. Këto amendamente i kishim edhe vjet, në legjislaturën e kaluar, i kemi edhe tani.

Edhe atëherë, edhe tani, Lëvizja “Vetëvendosje” i ka mbështetur dhe do t’i mbështesë këto amendamente kushtetuese, me gjithë vërejtjet që i ka dhe po ashtu me gjithë dëshirën e Qeverisë që ne t’i kundërshtojmë ato.

E them kështu, sepse Qeveria e kaluar dhe kjo e sotmja kanë tentuar ta fajësojnë opozitën për mosvotimin e këtyre amendamenteve kushtetuese. Serbët e kundërshtonin, e ne na akuzonin, serbët e kundërshtojnë e ne prapë na akuzojnë për mosvotimin respektiv të këtyre amendamenteve për Ushtrinë e Kosovës.

Ka ditë që në Parlament janë proceduar amendamentet kushtetuese për FAK-un. Siç dihet tashmë, Qeveria i ka sjellë në Kuvend këto amendamente për dy qëllime, por asnjëri qëllim nuk është që ne vërtet të kemi ushtri.

Duke e ditur se këto amendamente kërkojnë votë të dyfishtë në Kuvend; duke e ditur se kërkohet vota e shumicës së Kuvendit dhe e shumicës së pakicave; duke e ditur që këto vota nuk i ka në ndërkohë mazhoranca në Kuvend; duke e ditur se Lista serbe si partner në koalicion është deklaruar kundër këtyre ndryshimeve tashmë; atëherë shtrohet pyetja: Pse i ka sjellë Qeveria këto amendamente kur paraprakisht e di që nuk i kanë votat?

Po ashtu, nëse nuk do t’i kishim të proceduara në ndërkohë edhe ndryshimet kushtetuese për Gjykatën Speciale, a do t’i binte ndërmend Qeverisë për t’i sjellë këto amendamente në Kuvend për themelimin e Forcave të Armatosura të Kosovës? Natyrisht që jo!

Atëherë, qëllimi i Qeverisë është i qartë: Kjo qeveri e ka futur fatin e ushtrisë së vendit në lojë të keqe me Listën serbe. Kjo lojë, përveç që është e keqe, është edhe e rrezikshme për sigurinë e vendit. Përveç se lojë e keqe, është edhe pazar i rëndë për Kosovën.

Qeveria e kaluar dhe kjo e sotmja po vazhdojnë të bëjnë pazar e të luajnë me diçka që nuk luhet. Edhe në vitin e kaluar, Qeveria i pati sjellë këto amendamente në kuvend për t’i futur në pazar me vendet e rezervuara për serbët në Kuvendin e Kosovës. Edhe sivjet, sa e sa herë u mat që këto ndryshime t’i fusë në pazar me Gjykatën Speciale. Edhe tash, po e njëjta situatë duket që është në raport me koncesione në dëm të Kosovës.

Pra, Ushtria e Kosovës është nxjerrë në “aksham pazar” tashmë nga Qeveria. Këto amendamente po sillen këtu në Kuvend, jo për t’i kaluar ato, por sa herë ka diçka të keqe të votohet për Kosovën.

Si përfundim, Qeveria e ka sjellë Kuvendin e Kosovës në një situatë kur duhet ta pyesim Listën serbe që ta kemi apo mos ta kemi ushtrinë tonë. Duke e ditur që Lista serbe për gjithçka vepron me direktivat e Beogradit, atëherë ne sot po presim leje nga Beogradi që ta bëjmë ushtrinë tonë, apo jo! E sa here e pyesim Beogradin për këtë gjë, dihet mirëfilli përgjigja e tyre.

Në këtë situatë, qeveritë e kanë sjellë vendin tonë.

Sidoqoftë, sa herë që t’i sjellë këto amendamente në Kuvend, ne do t’i mbështesim, megjithëse Qeveria e pret me padurim nga ne të kundërtën. Por, njëkohësisht kurrë nuk do të pranojmë që të bëjmë pazar me fatin e ushtrisë dhe të sigurisë së vendit.

Kosovës i duhen Forcat e Armatosura. Vendeve anëtare të NATO-s i duhet një partner i cili do të merrte barrë nga barra e NATO-s që ka në Kosovë. Kosova nuk do të duhej të shpenzonte tashmë, por të prodhonte siguri. Qytetarëve u duhet mbrojtja.

Pra, ne duhet që patjetër ta themelojmë ushtrinë tonë - Forcat e Armatosura të Kosovës.

Madje, pikërisht Serbia është arsyeja kryesore se pse Kosova duhet të ketë ushtri të fortë dhe të përgatitur mirë.

Sa më shumë që e kundërshton Serbia themelimin, në fakt aq më e fuqishme duhet të bëhet nevoja dhe argumenti që ne ta kemi të themeluar tashmë ushtrinë.

**KRYETARI:** Donika Kadaj-Bujupi, në emër të Grupit Parlamentar Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, e ka fjalën.

**DONIKA KADAJ-BUJUPI:** Faleminderit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Përfaqësues të Qeverisë,

Më 26 janar të këtij viti, respektivisht më 5 shkurt, bashkë dhe në koordinim me të gjitha grupet parlamentare, me iniciativën e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, është nxjerrë një rezolutë për pengimin e migrimit ilegal të qytetarëve të Kosovës.

Nga debati i asaj kohe ka dalë një rekomandim, i cili lidhet me nevojën për angazhim më të madh të Qeverisë së Republikës së Kosovës në zhvillimin ekonomik, me theks të veçantë në shtimin e vendeve të reja të punës për qytetarët e Kosovës dhe konform kësaj janë nxjerrë edhe tetë pika të tjera, në mes e tyre është edhe një pikë - anulimi i menjëhershëm i udhëzimit administrativ numër 04/2014 për përcaktimin e kostos së shpenzimeve të transportit, të mallrave të importuara, i cili është në kundërshtim të plotë me ekonominë e tregut.

Sot, edhe pse ka kaluar një kohë e gjatë, në Doganat e Kosovës ky udhëzim administrativ vazhdon të jetë në fuqi, nuk është shfuqizuar sipas rekomandimit dhe rezolutës së nxjerrë dhe po u shkakton jashtëzakonisht shumë probleme kompanive të mëdha, të cilat janë në mesin e tatimpaguesve më të mëdhenj dhe futin para në Buxhetin e Republikës së Kosovës, ndërkaq janë transportuese.

Në këtë vazhdë, edhe pse e kanë një përvojë jashtëzakonisht të keqe nga e kaluara dhe këtu dua t'i referohem vitit 2012, kur në njëfarë forme është bërë rutinë që të ketë pengesa të vihen incidente ekonomike dhe tregtare ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë, po ndodh edhe kjo. Do të thotë, jo vetëm që kjo rezolutë nuk është zbatuar në asnjë pikë të saj, sepse siç na ka thënë kryeministri ajo merr kohë, por nuk është zbatuar as në ato pika, ku zbatimi është dashur të fillojë menjëherë, dhe po vazhdon të jetë në fuqi një udhëzim administrativ, i cili e ka datën 2014, i cili është nënshkruar asokohe nga kryeministri Hashim Thaçi dhe i cili po vazhdon të shkaktojë jashtëzakonisht shumë barriera të mëdha për këto kompani dhe ndërmarrje dhe, në të përgjithshmen, pasi këtu i kam deklaratat për media të përfaqësuesve të këtyre kompanive tregtare dhe importuese, njëra prej tyre ka humb në këtë periudhë kohore rreth 1 milion euro, para të cilat është dashur të shfrytëzohen për pikën në të cilën ne themi, si deputetë dhe si

Kuvend, krijimi i menjëhershëm i lehtësirave doganore, tatimore dhe administrative për të gjithë ata të cilët hapin më tepër se 10 vende të reja të punës.

A është dashur të ndërmarrë Qeveria veprime të menjëhershme në pikat ku është e mundur, ku nuk kërkohet investim, ku kërkohet veç vullnet politik që ta zbatojë këtë rezolutë dhe pikën 5 të saj, në mënyrë që pika 6 të fillojë të zbatohet dhe në mënyrë që në vend që u mbledhim buxhet fiktiv kompanive të caktuara, të cilat paguajnë shuma marramendëse në Buxhetin e Republikës së Kosovës në emër të taksave, t'u mundësohet dhe t'u krijohen lehtësira që ato ta rritin punësimin, respektivisht t'u mundësohet që të punojnë sipas politikave të tregut të lirë, e jo sipas vendimeve të cilat nxirren në emër të interesave të ngushta të grupeve politike dhe pastaj, kur të tjerët të vijnë në pushtet, nuk e kanë as guximin, e as vullnetin që ta zhvlerësojnë të njëjtin.

Unë ju thërras kryeministër, pasi erdhët, që ta merrni këtë rezolutë ta trajtoni edhe një herë me Kabinetin tuaj. Ne jemi të vetëdijshëm që 120 mijë vende pune nuk do t'i hapni nëpërmjet kësaj rezolute, se është goxha e vështirë, edhe pse keni premtuar, por të paktën pika 5, e cila lidhet me këtë vendim, me këtë udhëzim administrativ të vitit 2014, udhëzim i cili më shumë është tagrambledhës, se që në fakt i lehtëson kompanitë dhe në fakt nuk e rrit Buxhetin e Republikës së Kosovës, sepse janë taksa fiktive, ta zhvlerësoni dhe kompanive t'u mundësoni që të operojnë në një mjedis të mirëfilltë. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “Nisma”, Shukrije Bytyqi e ka fjalën.

**SHUKRIJE BYTYQI:** Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Duke bërë përpjekje që të jemi sa më afër qytetarëve për të mos e harruar komponentin kryesor, siç është shëndeti, sot do të përpiqem të ngre çështjen rreth problemeve në Ministrinë e Shëndetësisë.

Shëndetësia në Kosovë, një ndër shtyllat më vitale të kapaciteteve të një shteti, mbetet ndër sektorët e anashkaluar dhe me keqpërdorime të pakufishme. Kemi vlerësuar se gjendja në shëndetësinë e Kosovës vjen e përkeqësohet çdo ditë e më shumë dhe kjo gjendje është për shumë arsye të thjeshta, sepse shëndetësia nuk është prioritet as i kësaj Qeverie, e as i qeverive të kaluara.

Shëndetësia po vuan nga keqmenaxhimi, nga korrupsioni dhe shumë afera tjera, të cilave u paraprijnë edhe skandalet e trashëguara me aferat e stentave, vjedhja e aparaturave, punësime në baza familjare, klanore, fisnore dhe mungesë e profesionalizmit. Keqmenaxhimin në Ministrinë e Shëndetësisë më së miri e ilustron skandale të shumta, të cilat janë bërë dukuri e zakonshme në këtë institucion dhe në institucionet vartëse të saj. Janë afera të shumta korruptive, procedura të shumta disiplinore, shkelje ligjore, punësime, rehatime të dajave, nipave, problemet në prokurimin publik, pastaj kemi keqpërdorim të tenderëve dhe tani së fundi kemi pasur edhe arrestime të shumë zyrtarëve të Ministrisë së Shëndetësisë.

Problemet që e përcjellin shëndetësinë kosovare gjatë gjithë viteve po vazhdojnë mjerisht edhe këtë vit; mungesa e barnave të listës esenciale, e cila që prej pasluftës nuk ka arritur asnjëherë t'i

përmbushë tërësisht kërkesat e qytetarëve; mungesa e sallave të operacionit, hetimet e zyrtarëve të lartë shëndetësorë janë bërë çështjet më problematike dhe më të zakonshme në këtë vend, ku për çdo ditë proklamohet ruajtja e shëndetit të qytetarëve, e asgjë nuk ndërmerret në atë drejtim.

Të nderuar deputetë,

Si mund ta kemi një shëndetësi të plotë te qytetarët e vendit kur nuk kanë kushte as minimale të ofrimit të shërbimeve shëndetësore? Nuk ka ilaçe të mjaftueshme, nuk ka as ku të bëhen analizat, nuk punojnë aparatet rëntgenografike, e shumë të tjera.

Duke e ditur gjendjen e vështirë sociale në vend, shumica e qytetarëve e kanë të vështirë ta përballojnë koston private të ofrimit të shërbimeve dhe po mbeten të anashkaluar nga e drejta e tyre për jetë, në mungesë të ofrimit të shërbimeve shëndetësore, ilaçeve apo diç të tillë.

Institucionet shëndetësore publike nuk kanë mekanizëm të monitorimit dhe menaxhimit të pajisjeve mjekësore. Nuk kanë hartuar as procedura dhe spitalet nuk kanë ndërmarrë ndonjë iniciativë për një organizim adekuat të monitorimit për mënyrën e menaxhimit të pajisjeve mjekësore nga stafi përgjegjës.

Kështu, këtë e cek edhe raporti i Auditorit të Përgjithshëm i viteve 2012, 2013 dhe 2014, që janë të njëjtat probleme dhe nuk është ndërmarrë asnjë hap në përmirësimin e tyre. Mosfunksionimi i pajisjeve mjekësore nëpër spitalet publike bën të pamundur që qytetarët të kryejnë shërbime. Një prej pajisjeve të rëndësishme, që shumë herë nuk është në funksion në institucionet publike, është tomografia e kompjuterizuar. Kjo pajisje shërben për diagnostifikimin e sëmundjeve të ndryshme me anë të rrezeve X, e njëjta është funksionale në spitale private që ofrohet nëpërmjet saj dhe është shumë e shtrenjtë dhe e papërbalueshme për xhepat e varfër të qytetarëve.

Një skanim i pjesshëm kushton nga 200 deri në 1 000 euro, e kjo tregon se sa vështirë e kanë qytetarët që ta kryejnë këtë shërbim.

Të nderuar kolegë deputetë,

As pas tre muajve të formimit të këshillit për funksionalizmin e shërbimit të kardiokirurgjisë në QKUK, ky shërbim nuk është i hapur. Gjatë kësaj periudhe, këshilli ka bërë vetëm analizën dhe vlerësimin e gjendjes së këtij shërbimi dhe stafit të mesëm dhe nuk ka ndërmarrë asnjë hap tjetër. Derisa shërbimi kardiokirurgjik është i mbyllur, Ministrisë së Shëndetësisë këto i kushtojnë me mijëra euro për dërgimin e pacientëve në institucionet private, duke përfshirë edhe kardiokirurgjinë invazive, dhe kjo po e neglizhon mosfunksionimin e shëndetit në vend.

Të nderuar kolegë deputetë,

Për çdo ditë nëpër korridoret e Institutit të Onkologjisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës shihen pacientë të shumtë të prekur nga sëmundjet e kancerit. Mosha e tyre vërehet prej 18 deri në 70 vjeç, që për çdo ditë presin në korridoret e këtij institutit për aplikimin e terapive të ndryshme. Shpesh ndodh që këto terapi mungojnë, ndërsa çmimi i tyre është tepër i lartë. Vetëm një terapi e quajtur 'herceptinë' për një pacient në barnatoret private kushton 1 600 e diku 1 650 euro.

Pacientët e Onkologjisë ankohen se në të nuk ka as citostatikë, ndërsa brenda një dite aty aplikohen deri në 200 terapi të ‘herceptinës’, ndërsa përgatitja e saj kërkon përkushtim dhe mbrojtje fizike. Sëmundja e kancerit i prek të gjitha organet dhe të gjitha grupmoshat. Në rekomandimet e Agjencisë për mbrojtje kundër rrezatimit në vitin 2014 thuhet se Instituti i Onkologjisë duhet ta trajtojë stafin e tij për të dominuar...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYETARI:** Ju kisha lutur, vazhdojani fjalën deputetes!

**SHUKRIJE BYTYQI:** Faleminderit, kryetar!

Rekomandimet e Agjencisë vazhdojnë duke kërkuar nga Instituti i Onkologjisë që ta specializojë stafin e fizikantëve nga fusha e fizikës mjekësore dhe të bëjë përshkrimin e detajuar për lokacionin e objektit të onkologjisë.

Prandaj, nëse ne dëshirojmë që sa më shpejt ta përmirësojmë shëndetin tonë, duhet të kemi një Qeveri të përgjegjshme, një Qeveri pa skandale, një Qeveri që u përgjigjet nevojave të qytetarëve. Kërkojmë që të hetohen të gjithë personat përgjegjës për skandalet në shëndetësi, të rritet buxheti në aspektin e financimit të barnave nëpër komuna, të pajisen me aparatura përkatëse QKMF-të në shumicën e komunave që mungojnë, duke filluar prej Gjakovës, Drenasit, Malishevës, Prizrenit etj.,

Prandaj, të nderuar kolegë, për ta ruajtur shëndetin e të familjeve tona dhe tonin, në përgjithësi, duhet që së bashku t’i ngremë këto çështje delikate për shëndetin, përmirësimin e kushteve në spitale, ofrimin e shërbimeve dhe të gjitha këto. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Fjalën e ka Blerta Deliu-Kodra.

**BLERTA DELIU-KODRA:** Faleminderit, i nderuar kryetar i Parlamentit!

I nderuari kryeministër,

Të nderuar ministra,

Kolege dhe kolegë deputetë,

Do të flas sot, apo më mirë të them se do t’i paraqes dy tema, të cilat na shqetësojnë, qoftë ne si deputetë të Parlamentit të Kosovës, qoftë edhe qytetarët e këtij vendi. Tema e parë ka të bëjë drejtpërdrejt me Kosovën dhe me zhvillimin e mëtejshëm të lirisë së shprehjes, si dhe të promovimit të transparencës dhe nuk do të duhej të lejohej nga askush, as nga zyrtarë policorë, që të ndërhyjë në mënyrë arbitrare dhe ta rrezikojnë përparimin që është arritur në lirinë e shprehjes në Kosovë.

Policia e Kosovës, si njëra prej institucioneve që gëzon besueshmërinë dhe respektin më të lartë të qytetarëve të vendit, duhet të vazhdojë që të jetë garantuese e këtyre lirive dhe të drejtave të qytetarëve të vendit. Transparenca e kërkuar nga mediat për zyrtarët e lartë që janë të thirrur ta luftojnë krimin, si dhe korrupsionin, është e arsyeshme dhe nuk duhet të ndiqej, e as të pengohet nga askush. Prandaj, sot rreshtohem karshi fjalës së lirë dhe të drejtë të qytetarëve për informim të saktë dhe parimor dhe jam kundër kërcënimeve, të cilat nuk i kontribuojnë dhe nuk i kanë kontribuar asnjëherë një shteti demokratik.

Të nderuar kolegë deputetë,

Çështja e dytë ka të bëjë me rifunksionalizimin e maternitetit në Luginën e Preshevës, çështje e cila është diskutuar edhe në këtë Parlament, në një takim të përbashkët të gruas mbarëshqiptare, që është mbajtur në muajin mars. Mendoj që mungesën e maternitetit për 26 vjet askush nuk e ka vuajtur më shumë se sa gratë shqiptare, të cilat kanë qenë të detyruara që fëmijët e tyre t'i lindin, qoftë në ndonjë qytet të Kosovës, qoftë në qytete të largëta të Serbisë, në Vranjë, që është një qytet me mbi 40 km distancë një drejtim.

Pas kaq viteve të diskriminimit të shqiptarëve të Luginës, të cilëve në format më jodemokratike u janë mohuar të drejtat e tyre, kryeministri serb Vuçiq mori pjesë në ceremoninë e inaugurimit të maternitetit në Luginë. Edhe në këtë rast diskutimi i tij ishte kundër simboleve shqiptare dhe identitetit shqiptar.

Të nderuar deputetë,

Natyrisht që hapja e maternitetit dhe lindja e fëmijës së parë paraqet një hap para drejt avancimit të shëndetësisë në Luginë. Mirëpo, unë mendoj që ky maternitet ka nevojë të plotësohet me mjete shtesë, meqë vetëm lindjet e thjeshta dhe pa komplikime mund të kryhen brenda këtij materniteti. Prandaj, konsideroj se brengë e grave preshevare dhe grave të Luginës është që materniteti të plotësohet me pajisje shtesë, në mënyrë që këto gra të mos kenë nevojë të maltreohen dhe të marrin sërish rrugën, qoftë të Kosovës, qoftë të Vranjës. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Fatmir Rexhepi e ka fjalën.

**FATMIR REXHEPI:** Faleminderit, zoti kryetar!

Përshëndetje kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

Unë edhe një herë do ta rikthej në Parlament dhe do të ngre shqetësimin e opinionit që është në rritje lidhur me sektorin e energjisë, përkatësisht perspektivën e ndërtimit të kapaciteteve të reja në Kosovë. Edhe kohëve të fundit, ato që po i lexojmë dhe po i shohim, janë një sfidë shumë e madhe edhe për Qeverinë, por edhe për neve, për atë se çka po na pret në sektorin e energjisë.

Arsyeja është se ne nuk ishim të zotët as për 15 vjetëve, cilido mandat i Parlamentit, apo i Qeverisë, që të ndërtojmë kapacitet të reja. Kjo kohë ka ikur. Tani çka është para neve, unë po them është shqetësimi në ngritje apo në rritje, sepse nuk do të kemi as investitorë, por nuk do ta përballojë as ekonomia, qoftë sektori prodhues, qoftë konsumatori nesër, në qoftë se vendoset ashtu qysh unë lexova këto ditë në lidhje me kushtet që ofron ofertuesi për ndërtimin e Termocentralit Kosova e Re.

Pra, kërkesa e këtyre kushteve dhe unë mendoj këtu Qeveria duhet të jetë shumë e kujdesshme dhe shpresoj se do të jetë, por është shumë e rëndë për ne në qoftë se pranohen ato kushte në ndërtimin e Kosovës së Re, sepse nesër është e pamundur ta përballojmë çmimin, i cili do të jetë tepër i lartë edhe për familjarët, por edhe për ekonominë e vendit.

Atëherë, çka na mbetet ne? Unë mendoj që nuk duhet Qeveria të dorëzohet para kësaj. Mendoj që ata janë në dijeni më mirë se ne, që kërkesat që janë shtruar për alternativat tjera të

shqyrtohen. Të gjenden fonde që Qeveria në partneritet publiko-privat ta mundësojë projektin, i cili është ofruar para një kohe prej firmës gjermane, për të cilin janë të njoftuar, në mënyrë që të shikohet kjo alternativë se kur mund të realizohet, si mund të sigurohen mjetet, si mund të sigurohet fondi, në mënyrë që të jepen garancitë financiare dhe sigurisht që konkurrenca do ta bëjë të veten dhe do të kemi kapacitete të reja. Por, nesër do të kemi edhe çmime shumë më të favorshme për shfrytëzimin e energjisë elektrike.

Prandaj, e ngreha këtë shqetësim për të kërkuar që brenda këtij viti, Qeveria ta shohë mundësinë realisht për këtë projekt, ta shohim edhe atë mundësinë tjetër që e jep ligji, që patëm mundësi ta shqyrtojmë edhe para pak ditës këtu prej Fondit Pensional, që kemi të drejtë të investojmë diku rreth 30% të atyre mjeteve, të shihet nëse kemi mundësi që ato aty të bëjmë ndryshime dhe plotësime që t'i kthejmë në funksion të këtij investimi, të kësaj garancie, pra një mundësi, një alternativë, në mënyrë që diku afro 300 mijë punonjës të Kosovës, të cilët e ndajnë fondin e vet pensional, rreth 30% të mjeteve, pra të jemi aksionar në ndërtimin e këtij termocentrali, ndërsa Qeveria e përgatit krejt dokumentacionin dhe ndryshimet dhe plotësimet, qoftë në ligj, qoftë në ofrimin e modalitetit, apo të këtij partneriteti, në mënyrë që të startojmë....

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYETARI:** Të lutem regjia, mos ia ndal fjalën asnjërit!

**FATMIR REXHEPI:** Për të mos e zgjatur më shumë, pra edhe një herë provova që në këtë Parlament, meqenëse është këtu edhe kryeministri, ministri i Financave dhe ministri i Zhvillimit Ekonomik, i cili e ka për detyrë, që realisht të jemi të kujdesshëm, por mos ta harrojmë këtë alternativë. Pra, të bëjmë përpjekje maksimale, sepse shumë shpejt kalon koha, sikurse kaluan 15 vjet dhe pastaj dikush tjetër do ta paguajë këtë çmim shumë të lartë.

Unë mendoj që e kanë parasysh dhe po u bëj ftesë, pra që edhe njëherë ta shikojnë alternativën e re dhe mundësitë e reja që jep ky projekt dhe këto fonde, për t'i vënë në funksion të zhvillimit, ndërtimit të kapaciteteve të reja dhe zhvillimit ekonomik. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Teuta Haxhiu e ka fjalën.

**TEUTA HAXHIU:** Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Çështjen që do ta ngre sot është rreth emërtimit të institucioneve të arsimit të lartë privat, çështje të cilën e kam ngritur edhe në mandatin e kaluar dhe sot e kësaj dite është gjendja është e njëjtë.

Edhe këtë vit, asnjë nga bartësit e arsimit të lartë nuk kanë plotësuar kushte të akreditohen si universitete, madje janë shumë larg tyre, thuhet nga ekspertët në kuadër të Agjencisë për Akreditim. Pas publikimit të rezultateve, pra të procesit të akreditimit, nga Agjencia e Akreditimit të Kosovës, që kanë përfshirë 26 institucione private dhe publike, vendim pozitiv për zgjatjen e akreditimit, madje edhe për disa programe ka marrë vetëm Universiteti Publik "Hasan Prishtina", Universiteti Publik i Pejës dhe ai i Prizrenit, për një periudhë trevjeçare, ndërsa institucionet private të arsimit të lartë vazhdojnë të mbesin siç edhe kanë qenë, kolegje.

Pra, siç ka thënë drejtoresha e këtij këshilli, cilësia në këto kolegje private është shumë e ulët. Këto kolegje nuk kanë arritur kriteret e parapara me Ligjin për arsimin e lartë, që të akreditohen si universitete.

Për momentin, thotë, asnjëri prej këtyre nuk ofron tri ciklet, që është kusht për të qenë Universitet. Dhe, sipas ligjit parashihet që institucionet të kenë të akredituara doktoratura, së paku në tri fusha, për të arritur nivelin e kolegjit universitar, ndërsa duhet të ofrojnë edhe në pesë fusha doktoratura, për të qenë universitete. Dhe, kjo në këto institucione çdo ditë shihet haptazi që Qeveria e Kosovës, përkatësisht Ministria e Arsimit edhe ajo e kaluara, por fatkeqësisht edhe kjo nuk po e bën një hap për të parë se çfarë po ndodh me këto institucione.

Shihni të gjitha adresat elektronike të shumë prej tyre, nuk them 100% të shumë prej këtyre kolegjeve, të gjitha i kanë emërtimet universitete. E kam përmendur kohë më parë, po e përmend edhe sot, Kolegji AAB e ka kamufluar një emërtim të vetin jashtëligjshëm, po ka edhe kolegje të tjera. Pse ndodh kjo? Për përfitime, jo për diçka tjetër. Le të akreditohen si universitete private, ose si kolegje private, është çështje e Agjencisë për Akreditim, edhe pse ajo agjenci, edhe aty i kam dilemat e mija ngase udhëhiqet nga persona që janë në hetime. Kjo nuk do të duhej të ndodhte në shtetin tonë. Pra, do të duhej që edhe ata të japin dorëheqjen, të paktën, morale deri në vërtetimin apo thjesht, derisa të kryhen procedurat e hetimeve. Por, megjithatë, nuk guxojmë t'i mbyllim sytë karshi kësaj që po ndodh, i nderuar ministër.

Po mashtrohen studentët, po mashtrohen prindërit, që cilët po paguajnë shuma shumë të mëdha për t'i shkolluar fëmijët e tyre. Pra, edhe njëherë dua t'ua bëj me dije të gjithë prindërve, të gjithë studentëve që aplikojnë, se në Kosovë emërtimi Universitet është në radhë të parë, pastaj është kolegji universitar dhe rangimi i treti është kolegji. Kështu që, në Kosovë nuk janë as në rangimin e parë, as në të dytin institucionet private. Janë në rangimin e tretë si kolegje dhe kjo është normalisht, për përfitime të njerëzve të politikës, të njerëzve që janë të lidhur ngushtë me politikën dhe i mbyllin sytë karshi këtyre gjërave që po ndodhin në arsim.

Prandaj, ministër ju ftoj që të bëni një hap konkret në këto momente, se me të vërtetë, cilësia në arsim nuk mund të ngritet në qoftë se nuk bëhen hapa konkret. Është mirë që të kemi institucione private, që të jenë karshi institucioneve publike, por thjesht e kundërta ndodh në Evropë e kudo. Atje paguhen dhe aty ku paguhet, normalisht kërkohet edhe llogaridhënie më e madhe. Në Kosovë, për fat të keq po them, shumë prej tyre nga ato të dhëna që i kemi nga këto institucione, që ne i kemi ngritur vetë, janë më shumë për përfitime. Dhe, kjo nuk po ndodh në një periudhë pas luftës, por janë vite të tëra pas lufte dhe kjo edhe sot e kësaj dite po ndodh.

Andaj, përkundër shqetësimeve të vazhdueshme nga prindërit, nga studentët, ju ftoj ministër, që të merrni hapa konkret në këtë drejtim. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Zafir, e ke fjalën.

**ZAFIR BERISHA:** Faleminderit, kryetar!

Unë do të vazhdoj ta ngre çështjen e cila është tepër shqetësuese për perspektivën e vendit tonë.

Gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm nëpër institucione dhe të gjitha njësitë buxhetore, vazhdojnë të mbesin shqetësim edhe për ne si deputetë, por edhe për qytetarët, sepse bëhet fjalë për gjetje dramatike, që e shkatërrojnë imazhin e Kosovës, por të njëjtën kohë e dëmtojnë rënd edhe buxhetin e Kosovës dhe keqpërdorin taksat e qytetarëve të Kosovës.

Gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2014, veçanërisht në fushën e prokurimit publik mbi 600 shkelje, është një dëshmi se njësitë para-politike edhe të këtij koalicioni vazhdojnë të keqpërdorin mjetet e qytetarëve dhe kjo për Qeverinë duhet të jetë një shqetësim, sepse vazhdimi i kësaj situatë me të vërtetë e fundos përfundimisht perspektivën e vendit tonë. Shkeljet vazhdojnë, siç thash, në të gjitha njësitë buxhetore, nëpër ministri, komuna dhe agjenci të pavarura, por unë do të potencoj Ministrinë e Arsimit, ku kemi keqpërdorim, ose përdorim të mjeteve pa kontratë mbi 750 mijë euro dhe të them të drejtën, kjo është më shumë se shqetësuese, për të vazhduar pastaj nga Ministria e Jashtme dhe kështu me radhë, të gjitha ministrinë tjera.

Unë do të ndalem te niveli i dytë i qeverisjes, te komunat, me theks të veçantë te ajo që tashmë dihet publikisht, se kampioni i korrupsionit, krimi të organizuar është Prizreni dhe Auditori i Përgjithshëm vazhdon të publikojë të dhëna shqetësuese për keqpërdorimin e mjeteve të qytetarëve nga grupe para-politike të partisë në pushtet në atë qytet. Dhe, thënë të drejtën, meqë vijë nga ai qytet, shpeshherë kur del në medie për të keq qyteti i Prizrenit, më bën të ndjem keq që jam qytetar i atij qyteti dhe në këtë rast unë po mendoj se niveli qendror i qeverisjes duhet përfundimisht të kthehet nëpër komuna dhe të shikojë se çka është duke ndodhur me njerëzit, domethënë që e ka nivelin e dytë qeverisës.

Ajo që është për shqetësim, është mosrespektimi i rekomandimeve dhe këshillave të Auditorit të Përgjithshëm dhe vazhdimisht, nga viti në vit, rekomandimet e Auditorit të Përgjithshëm në raport me institucionet e caktuara, domethënë nuk përfillen dhe thënë të drejtën në këtë rast, më lejoni që publikisht të pyes edhe kryeministrin edhe organet tjera, se a ka Prokurori ky shtet? Në rast se një mekanizëm konstaton publikisht për shkelje, atëherë thjesht Prokuroria e Shtetit është në gjumë, kur kemi parasysh edhe thujtë çdo ditë Agjencia Antikorrupsion për shkeljet që i konstaton askush nuk shkon në përgjegjësi.

Përfundimisht, në rast se vazhdojmë kështu, unë mendoj se jemi duke dëmtuar tepër rëndë shtetin e Kosovës dhe ne duhet edhe një gjë ta mendojmë, se jetojmë në një shtet në bërje e sipër të demokracisë dhe qeverisja e këtij stili, unë po dyshoj se fundi do t'i vijë durimit të qytetarëve, të cilët gjenden para një kolapsi total. Prandaj, mendoj se gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm dhe mekanizmave tjerë në raport me keqpërdorimet e parasë publike duhet të merren seriozisht, sepse edhe vetë mosvotimi i Auditorit të Përgjithshëm si propozim i presidentes nga ky Parlament, më lë të dyshoj se njësitet para-politike edhe të këtij koalicioni dëshirojnë të vënë dorë edhe në këtë institucion të rëndësishëm të shtetit. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Aida e ka fjalën.

**AIDA DËRGUTI:** Të nderuar deputetë,

Janë bërë më shumë se një vit nga miratimi i ligjit, i cili njih statusin e personave të dhunuar gjatë luftës, e që sot e kësaj dite nuk filloi zbatimin e tij. Obligimet kryesore për Ministrinë e

Punës dhe Mirëqenies Sociale, të dala nga ky ligj janë dy: formimi i Komisionit dhe nxjerrja e akteve nënligjore.

E dimë që ky obligim do të duhej të përmbushej nga ish-ministri Rashiq, paraardhësi i ministrit Abrashi në Qeverinë e kaluar, prandaj qysh në fillim të mandatit të kësaj Qeverie i kam bërë pyetje ministrit Abrashi, në mënyrë që ta ketë parasysh si një nga obligimet ligjore, që duhet përmbushur brenda një afati 6-mujor.

Mirëpo, ministri në fjalë nuk e ka marrë seriozisht as çështjen e as përgjegjësinë si ministër. Këtë e dëshmoi me mospërgjigjen në pyetjet e mija lidhur me këtë çështje pas përmbushjes së afatit ligjor prej gjashtë muajsh.

Pyetjet e mija parlamentare për ministrin Abrashi as në fillim të mandatit të tij e as pas gjashtë muajsh nuk e kanë pasur për qëllim kritikën. Në fakt, duke ia rikujtuar detyrat e tij si ministër, kam dashur që ta nxis atë që t'i përmbushë ato e me ç'rast do të përfitonin në rend të parë viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës.

Njëkohësisht, nga kjo do të përfitonte dhe vetë ministri, i cili me përmbushjen e obligimeve karshi ligjit dhe përfituesve nga ky ligj, do të kishte mundësi që të fliste, së paku, për një sukses të tij. Mirëpo, duke harruar se si pjesë e ekzekutivit të vendit ka për detyrë të zbatojë në praktikë vendimet e Kuvendit, në vend se të jetë boshti i çështjes, ky ministër shkon e bëhet satelit i presidentes, duke u futur në njërin nga Këshillat e saj dhe merret me lobim e promovim të vetvetes lidhur me viktimat e dhunimit seksual gjatë luftës. Kjo tallje e ministrit me viktimat e dhunimit seksual gjatë luftës, vetëm i riviktimizon ato nga nivelet më të larta shtetërore.

**KRYETARI:** Faleminderit! Salih, fjala është për ju.

**SALIH SALIHU:** Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,  
Kolegë deputetë,

Sot dua të diskutoj për pjesën shumë të rëndësishme të popullatës sonë, për njerëzit që djersën dhe trupin e tyre e lënë në vendin e huaj, por mendjen dhe zemrën e kanë gjithnjë në Kosovë. Pra, do të flas për mërgimtarët.

Mërgimtarët, njerëzit më të dashur të popullit tonë, ata që kurrë nuk u ndalën së kontribuari në Kosovë, ata ndihmuan para lufte, ndihmuan luftën, po e ndihmojnë edhe pas lufte. Ata vazhdojnë ende t'i dërgojnë rreth 700 milionë euro në Kosovë, shumë kjo gati sa gjysma e buxhetit të Kosovës dhe thuajse, i vetmi burim që është duke mbajtur gjallë pulsën e kapilarit të fundit të ekonomisë sonë.

Po çfarë ka bërë dhe çka po bën Qeveria jonë për ta? Sa ne jemi mirënjohës për kontributin e tyre dhe sa Qeveria jonë ka adresuar problemet dhe vështirësitë me të cilat po ballafaqohen këta qytetarë të Republikës së Kosovës? A mjafton vetëm fjala - "Mirë se erdhët të dashur mërgimtarë!" për ta?

Një nga problemet kyçe është çështja e së drejtës për votë, realizimi i saj dhe përfaqësimi i tyre në organet vendimmarrëse si Kuvendi i Kosovës. Komplikimi i procedurave të votimit jashtë

vendit dhe refuzimi për ta shtruar çështjen e vendeve të parashikuara për ta në Kuvendin e Kosovës, është shenja më e qartë, se në fakt, një klasë partiakësh këtu në Kosovë, prej vitesh ka zhvatur turpshëm gjithë potencialin e mërgimtarëve tanë.

Ata as nuk mund të votojnë praktikisht e as nuk mund të zgjidhen. Si rrjedhim, ata nuk janë këtu për t'i ngritur direkt problemet e tyre, prandaj unë sot dua që të ngre disa nga ato shqetësime.

1. Ju e dini që gjatë zezonës së verës, por edhe gjatë pushimit dimëror, fluksi i mërgimtarëve është shumë i madh dhe shpeshherë ndodh që gjatë kthimit të tyre, por edhe gjatë ardhjes, kolonat të bëhen 3 – 5 kilometra. Është e papranueshme, se në pikat kufitare të Kosovës të mos ketë një vend ku mërgimtarët tanë kanë mundësi, thjesht t'i kryejnë nevojat e tyre elementare. Shpesh ndodh, që tri – katër orë të pritet edhe matanë kufirit dhe këtu e dimë që ju nuk mund të ndikoni, por qytetarët, mërgimtarët tanë kanë mundësi të kalojnë kufirin këmbë dhe as brenda kufirit të Kosovës nuk ka kushte apo një ambient higjenik-sanitar, ku gratë kanë mundësi t'i ndërrojnë fëmijët e tyre.

Problemi i dytë është, që mërgimtarët që udhëtojnë nëpërmjet Serbisë me makinë apo autobus, vazhdojnë të plaçkiten nga doganat e Serbisë, përkundër faktit se ata janë udhëtarë transit, pra ata detyrohen të paguajnë dy herë doganë, një herë në hyrje të Serbisë dhe një herë në Kosovë. Pra lëvizja e lirë me letërnjoftim dhe jo me pasaportë po ia mundëson Serbisë që qytetarët e Kosovës t'i trajtojë edhe më tutje qytetarë të Serbisë duke i plaçkitur nëpër doganat e tyre.

Problemi i tretë është se çështja e sigurimit të automjeteve, përkundër posedimit të Kartonit të Gjellbër prej vendit nga ata vijnë është e padrejtë. Edhe pse pas diskutimeve të fundit që u bënë në Kuvend, kompanitë e sigurimeve, ulën taksën e sigurimeve dhe megjithatë, plaçkitja e mërgimtarëve ndonëse në përmasa më të vogla, po vazhdon.

Në qoftë se dikush nga ju do të keni rast të udhëtoni me ndonjë mërgimtar në drejtim të Kosovës, do e shihni se sa të organizuar dhe bashkëpunues janë policia dhe kompania e sigurimeve. Nuk ka mundësi të hyhet në Kosovë pa e paguar sigurimin e automjetit, qoftë edhe për një orë, sepse policia nuk lejon. Pra, policia e shtetit i bën shërbim kompanisë private të sigurimit.

Por, është për habi se kurrë nuk ndodh që punëtorët e Kompanisë së Sigurimit apo edhe policia ta pyesin mërgimtarin për sigurimin e tyre shëndetësor. Pra, për çudi këta më shumë përkujdesen për sigurimin e automjeteve të tyre se sa për shëndetin e tyre.

Dhe, nën 4, është fokusimi i projekteve të infrastrukturës rrugore nëpër komuna, të cilët shumë kryetarë të komunave, duke ditur se ndikimi i mërgimtarëve dhe të familjeve të tyre në Kosovë është i madh, tentojnë që nëpërmjet fokusimit të projekteve në kohën pikërisht kur vijnë mërgimtarët në Kosovë të realizojnë projektet për të krijuar një përshtypje kinse janë duke punuar. Kjo mendoj se nuk u ndihmon për arsye se po u shkakton edhe më tepër telashe dhe po i irriton mërgimtarët tanë, sepse pikërisht ata vijnë për t'i bërë pushimet dhe pikërisht në këtë kohë ata i kanë, thjeshtë, përgëzimet dhe ahengjet e tyre dhe kjo po e vonon edhe punën e tyre.

Pra, Lëvizja “Vetëvendosje” konsideron se është e padrejtë që një kategori e caktuar e shoqërisë tonë, që ka kontribuar dhe vazhdon të kontribuojë në zhvillimin e Kosovës, ta trajtojë në këtë formë.

Qeveria e Kosovës duhet të merret seriozisht me shqetësimet e mërgimtarëve, të krijojë kushte të mira dhe ambient të sigurt gjatë qëndrimit të tyre në Kosovë dhe kushtet e favorshme investive për të zgjedhur ata të cilët duan të investojnë në Kosovë.

Duhet ndryshuar logjika e organizimeve të ikjeve masive të tyre, sepse jemi bërë vend që po eksportojmë të rinj dhe ata për fat të mirë po përkujdesen për të afërmit e tyre duke dërguar të holla dhe në mungesë të politikave të mira zhvillimore të shtetit tonë paratë e tyre po i eksportojmë jashtë vendit. Kjo sigurisht që nuk krijon imazh të mirë për Kosovën.

Këtë patët rast ta shihni edhe në bisedën që e pati presidentja jonë me gazetaren gjermane. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, Salih! Lekaj, urdhëro!

PAL LEKAJ: I nderuar kryetar i Parlamentit!

Kryeministër, ministra,

Deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Sado që flasim për zhvillim ekonomik, sado që flasim për mirëqenie, sado që flasim për shëndetësi, për arsim, mendoj se të gjitha janë të kota kur qytetari ynë ballafaqohet me gjërat më elementare.

Sot, qytetarë të nderuar, deputetë, kryeministër i Kosovës, Gjakova, apo gjysma e komunës së Gjakovës, nuk ka rrymë, 14 orë. Prandaj, si mund të arsyetojmë ne veten edhe si deputetë, edhe si Qeveri kur ndër marrjes KOST-i prej orës 2, dje që është ndërprerë rryma, mendoj se as që i ka ra ndërmend dikujt që të merret me këtë çështje.

Prandaj, mendoj se janë të gjitha këto të kota dhe mendoj se ju dhe me siguri Qeveria e ka luksin, sepse nuk i mungojnë këto gjëra elementare, por qytetarët e sidomos diaspora ballafaqohet me atë që nuk duhet të ballafaqohet qytetari në shekullin XXI.

Prandaj, mendoj se ua kemi gërditur edhe atdheun e vet qytetarëve - diasporës që të vijnë dhe t’i kryejnë pushimet pranë familjes kur ata ballafaqohen me këto gjëra. Dhe, Qeveria e kryeministri duhet, dhe kërkoj urgjentisht që të merret me këtë çështje dhe, këto gjëra elementare, t’i kenë qytetarët. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, Pal! Ministri i Financave, Abdullah Hoti e ka fjalën.

MINISTRI ABDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

I nderuar kryeministër, ministra,

Desha të adresoj nja dy çështje që u ngritën këtu. E para, rreth faljes së borxheve, i cili ligj ka kaluar edhe në leximin e dytë dhe për fat të mirë është miratuar me 82 vota për. Pra, e ka një mbështetje të gjerë sa i përket këtij ligji.

Unë mendoj se ky krijon tashmë një momentum të ri, ashtu sikur që e kemi arsyetuar kur e kemi përgatitur këtë projektligj dhe janë 680 milionë euro që falen.

Unë po ju citoj, studimet e pavarura për këtë, të cilat kanë thënë se në 90% të rasteve përfitojnë qytetarët me të ardhura të ulëta që janë në asistencë sociale dhe përfitojnë bizneset të cilat janë të falimentuara ose janë ekzistente tanimë.

Në ligj thuhet se brenda një muaji, nga data e miratimit të ligjit, të gjitha institucionet përkatëse e publikojnë listën e borxhlinjve, dhe kjo mendoj se siguron transparencë të plotë.

Ne jemi duke përgatitur udhëzimin administrativ, shpejt do të miratohet edhe në Qeveri dhe brenda një muaji do të bëhet publike kjo listë. Të gjithë e dinë kush janë ata borxhlinj që i kanë shtetit borxh ndërmarrjeve publike deri më 31 tetor - dhjetor 2008. Më transparente se kaq, në fakt, edhe nuk mund të bëhet.

E dyta. Rregullorja për shpenzime të transportit, që është pjesë e rezolutës në muajin shkurt në Kuvend, menjëherë pas asaj rezolute ne e kemi formuar Grupin punues për të ndryshuar këtë Rregullore.

Dhe arsyetimi atëherë ka qenë që në fund të vitit të kaluar dhe në fillim të këtij viti kostoja e derivateve, çmimi i derivateve pati ra në bursat ndërkombëtare, pati ra në tregun vendor, por ky çmim tani prapë është rritur dhe duhet parë se deri në çfarë mase duhet të ndryshojmë këtë Rregullore.

Unë po ju informoj se e kemi një Këshill fiskal, që e quajmë, brenda doganave ku marrin pjesë edhe odat ekonomike, edhe shoqatat e ndryshme të biznesit, edhe bizneset private dhe është në diskrecionin e tyre se si do ta çojnë përpara. Pra, bizneset janë të përfaqësuara në këtë Këshill dhe unë ju ftoj që të marrin pjesë në ndryshimin e kësaj rregulloreje për aq sa është e mundur.

Mirëpo, e mira e kësaj rregullore, është që nga atëherë kur është miratuar, dhe të shohim tash se sa duhet të ndryshojë në këtë drejtim, është se të gjitha bizneset i ka vendosur në një rrafsh të barabartë, duke i trajtuar shpenzimet jo sipas deklarimeve të ndryshme, por duke marrë koston e transporteve prej pikës A në pikën B dhe duke i trajtuar të gjitha bizneset njësoj.

Kjo duhet të ndryshojë sa herë që ndryshojnë shpenzimet e transportit, pra çmimi i derivateve, ka ra më herët e tash është kthye në nivelet e mëparshme dhe duhet parë arsyeshmërinë a dëshirojmë ta ndryshojmë ende këtë rregullore apo jo. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit, ministër! Dauti, sigurisht ka plotësim. Urdhëro, Daut!

**DAUT HARADINAJ:** Kërkoj falje, kryetar!

Kryeministër, nuk e preka pullën më herët jashtë rendit të ditës. Kisha kërkuar vetëm një sqarim prej ministrit të Financave.

Ka shumë thashë e thëna, nëpër media, kuluareve së Fondi i veteranëve, është devijuar dhe është orientuar në një destinim të ri.

A mundesh një shpjegim vetëm për opinionin publik dhe ata që e shohin televizionin ta shpjegoni se a është e vërtetë kjo dhe sa ka të vërteta, a qëndron apo s'qëndron. Dhe, më fal për ndërhyrje.

**KRYETARI:** Urdhëroni, zoti ministër!

**MINISTRI ABDULLAH HOTI:** Faleminderit!

Më lejoni të ju informoj që Fondi për veteranët është pjesë e buxhetit të rishikuar, që e kemi miratuar në këtë Kuvend. Ai fond është aty dhe sapo të finalizohet lista, e unë kam qenë në kontakt me kryetarin e Komisionit, i kam kthyer përgjigje edhe me shkrim, dhe sapo të finalizohet lista, në përputhje me ligjin ku thuhet që pas listës finale, Ministria e Financave, ulet bashkë me Qeverinë dhe i miraton nivelet e përfitimeve për këtë. Pra, fondi është pjesë e buxhetit dhe është transparent dhe secili prej juve mund ta sheh atë. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Donika, po e shoh që e doni fjalën, dhe a është për këtë çështje? Urdhëro.

**DONIKA KADAJ-BUJUPI:** Ministër,

Te pika e rezolutës, thuhet të anulohet menjëherë udhëzimi administrativ. Dhe, sqarimi ishte i dyanshëm. Thatë që po zbatohet pika e ndërkohë, thatë, se është formuar një Këshill fiskal dhe është në diskrecionin e tyre të merret me plotësim-ndryshimin e kësaj rregulloreje.

Teknikisht, të gjitha ato kompani të cilat në kundërshtim me këtë rregullore kanë paguar për transporte vetjake 200 plus 200, rrjedhimisht 400 euro për maune, dhe këtu po flas për transportin që bëhet prej Shqipërisë në Kosovë, sepse kjo është kategoria më e dëmtuar, të cilët edhe në të kaluarën prej vitit 2012, që e dini nga atëherë kur janë bërë barrikatadat e ndryshme, kanë paguar kosto shtesë dhe kjo nuk shkon as në atë misionin e përbashkët për një treg të lirë, të gjitha ato memorandume që po i nënshkruani ndërmjet Qeverisë së Kosovës e Qeverisë së Shqipërisë, ndërkohë në terren, në vazhdimësi, po mungon zbatimi.

Nëse mundeni, edhe një herë të shpjegoni. Të gjitha ato kompani, e këtu bëhet fjalë edhe për kompani shumë të fuqishme të cilat në buxhetin e Kosovës janë pagues kryesorë të taksave, janë tatimpaguesit më të mëdhenj, dhe kanë humbur jashtëzakonisht shumën të larta, 900 deri në 1 milion euro, sepse ky udhëzim administrativ nuk është fuqizuar në kohë sipas rezolutës.

Pra, çka do të ndodhë me ta dhe cilat do të jenë veprimet të cilat do të ndërmerren në mënyrë që këto kompanive t'u kthehen mjetet e tyre të marra nëpërmjet doganave në formë dhe në kundërshtim me rezolutën dhe kërkesën për anulim të udhëzimit administrativ?

**KRYETARI:** Ministër, nëse mundeni, shkurt!

MINISTRI ABDULLAH HOTI: Faleminderit!

Unë mendoj se është në të mirë të kompanive që kjo rregullore të jetë në fuqi, sepse i vendos në baza të barabarta.

Atë që e thash është se në këtë Këshill janë të përfaqësuara odat ekonomike dhe bizneset që ndikohen prej kësaj rregulloreje. Ata le ta propozojnë, nuk është në diskrecionin tim ta anuloj. Mund ta anuloj, nëse kështu kërkohet edhe prej tyre, por ato janë të përfaqësuara, e kanë zërin aty.

Menjëherë është mbledhur Këshilli pas asaj rezolute dhe kanë vendosur ta ndryshojnë në përputhje me çmimin e derivateve.

KRYETARI: Faleminderit! E ka fjalën ministri i Arsimit, akademik Arsim Bajrami.

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, zoti kryetar!

Unë dëshiroj të jap një sqarim rreth shqetësimeve që i ngriti deputetja Teuta Haxhiu dhe më vjen keq që ajo nuk është për ta dëgjuar përgjigjen e Qeverisë.

Ajo e ngriti me të drejtë një çështje që ka të bëjë me emërtimet e kolegjeve private, sepse asnjë institucion privat i arsimit të lartë nuk ka të drejtë të mbajë emërtimin Universitet, sepse nuk është i akredituar dhe licencuar si Universitet.

Deputetja e ka ngritur këtë çështje edhe në Komision parlamentar dhe është thirrur në gjendjen paraprake, jo në gjendjen ekzistuese dhe besoj që ajo, duke qenë një punëtore e arsimit, i përcjell zhvillimet dhe i ka parë ndryshimet dhe ndryshimet konsistojnë në këtë.

Ka dy muaj që është përfunduar inspektimi special i gjitha kolegjeve private sa i përket përdorimit të emërtimeve dhe mund të them sot se të gjitha kolegjet private i kanë ndërruar emërtimet në ndërtesa, i kanë ndërruar emërtimet në spotet televizive, i kanë ndërruar emërtimet në bill-borde dhe asnjë prej tyre nuk e mban thirrjen Universitet, që ka qenë përpara.

Inspektimi special ka zgjatur një muaj dhe ka konstatuar që më tepër se dhjetë kolegje e kanë shpërdoruar licencën duke përdorur thirrjen Universitet.

Ne, duke vendosur rend dhe rregull, i kemi bërë me dije secilit institucion privat që në qoftë se vërejnë cilindo abuzim të licencës, ne do të revokojmë licencat. Kemi revokuar 5 licenca të pabazuara, të cilat janë keqpërdorur. Ministria, pra ka të drejtë që në çdo kohë ta tërheqë licencën, në qoftë se bartësi i licencës e shpërdoron duke përdorur një emër tjetër.

Tani e kemi vetëm edhe një problem, po edhe atë do ta zgjidhim. Problemet e Facebookut apo të faqeve zyrtare në Facebook, që i kanë këto kolegje dhe u kemi dhënë afat edhe 15 ditë që ato t'i ndërrojnë në Facebook dhe mos ta shkruajnë kurrkund "Universiteti" filan fisteku, por të japin emërtimet. Dhe, të jeni të sigurt, ju lutem, të përcillni dhe të mbani përgjegjësi për fjalën publike secili që ju vëreni dhe që e denonconi se përdorë një emërtim tjetër jashtë emërtimit kolegji, do t'i revokohet licenca dhe nuk do të lejojmë, sepse kemi vendosur që në sektorin privat të vendosim fillimisht ligjshmërinë dhe pastaj standardet e cilësisë në mënyrë që vërtet sektori privat t'i

kthehet misionit akademik e jo misionit të një afarizmi biznesor, sepse jemi të vetëdijshëm që shumica e kolegjeve private në rend të parë e kanë fitimin dhe pastaj e kanë aspektin akademik.

Ne jemi zotuar që do ta mbështesim shumë sektorin publik, sepse Qeveria e financon sektorin e universiteteve publike, dhe jemi zotuar se do ta kontrollojmë shumë ashpër sektorin privat në mënyrë që ky mos të abuzojë me taksat e taksapaguesve dhe t'u ofrojë studentëve shërbime të mirëfillta akademike.

**KRYETARI:** Faleminderit! Teuta, a keni reagim?

**TEUTA HAXHIU:** Faleminderit, kryetar!

Qëllimi im dhe besoj edhe i ministrit dhe i të gjithëve është qëllim mirë.

Ministër, unë po pres hapa konkretë, sikur edhe të gjithë ne, që të bëhen pra ndryshime në adresat elektronike ashtu siç edhe e përmendët, sepse që të gjitha shih janë UN-i. Mbi të gjitha prapë më duhet ta përmend që emërtimi institucion i arsimit të lartë universitar nuk është në ligj. Ky emërtim është tek institucioni privat pra ABB, emërtimet janë: Universitet privat nëse ka s'ka, kolegji universitar kolegji, pra edhe ABB-ja është i akredituar si kolegji dhe emërtimi i tij nuk është pra shihni, unë dua ta përmend, nuk mund t'i ik pra, i keni autobusët që gjithë qytetarët i shohin çdo ditë, edhe reklama televizive unë i kam të fotografuara te televizionet që e kanë logon 'university' në reklama televizive. Faleminderit!

**KRYETARI:** Po urdhëro, menjëherë e ke përgjigjen.

**MINISTRI ARSIM BAJRAMI:** Tani kolege deputete,

Përgjegjësinë për fjalën publike e keni edhe ju edhe unë. Dhe ju po flitni për një gjendje para tre muajve jo për gjendjen tani. Ju e dini se unë ju kam premtua në Komision që ju mund të shihni ueb-faqen e Ministrisë së Arsimit dhe aty e keni të postuar që një muaj raportin e inspektimit special. Nuk është e vërtetë asnjë institucion privat nuk quhet as kolegji universitar as institucion i arsimit të lartë të gjitha i kanë ndërrua e kanë bërë kolegji.

Të jemi korrektë, urdhëroni vizitoni, i keni 50% të këtyre kolegjeve në Prishtinë, vizitoni ose i vizitohet së bashku dhe do të shihni se pas inspektimit që ka bërë ministria të gjitha kanë bërë investime, goxha investime, madje investime deri në 50 mijë euro për t'i gëlqerosur ndërtesat, për t'i ndërruar autobusët dhe kurdo ju që keni kohë ne mund të shkojmë së bashku dhe t'i inspektojmë dhe është mirë që të flasim me fakte konkrete. Ju po flitni me atë se çfarë keni folur para tre muajve në Komision, m'i keni treguar fotografitë edhe në telefonin tuaj, ju kam premtuar që do t'i ndryshoj dhe ejani të shkojmë bashkë dhe i shohim këto ndryshime.

**KRYETARI:** Faleminderit! Edhe ministri i Diasporës e ka fjalën lidhur me diskutimet jashtë rendit të ditës.

**MINISTRI VALON MURATI:** I nderuar kryetar,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Salih, po bashkëbisedoj me ty pak, e shtrova një çështje shumë të rëndësishme çështjen e të drejtës së votimit është shtrua disa herë në Kuvendin e Kosovës. Po dua të ju informoj se çka kemi bërë ne duke pasur parasysh që ne deri në fund nuk mund ta realizojmë këtë, por mund ta

iniciojmë dhe mund ta mobilizojmë çështjen e votimit, sepse kemi edhe pjesë të strategjisë së misionit të ministrisë.

Ne kemi bërë një hulumtim tash së fundi së bashku me DIFORD-in dhe kemi dalë me disa rekomandime se çka duhet bëhet për ta shtua numrin e votuesve dhe për ta fuqizua pjesëmarrjen e diasporës në votime.

Këto rekomandime të cilat jemi duke i përgatitur dhe ende nuk kanë dalë në fazën finale do t'ua dërgojmë të gjitha institucioneve relevante përfshirë grupeve parlamentare, përfshirë kryetarit të Kuvendit të gjitha institucioneve qeveritare që merren me çështjen e zgjedhjeve si dhe të KQZ-së, dhe sigurisht që nga shtatori atje do ta fillojmë një diskutim më të gjerë shoqërorë për çështjen e mobilizimit dhe se çka duhet të ndryshohet që pjesëmarrja e qytetarëve bashkatdhetarëve tanë të jetë më e madhe. Çka mund të ndodhë pa u ndryshua ligj, çka duhet të ndodhë nëse apo çfarë hapash duhet të ndërmerren për të ndryshua ligji e çështje të cilat mund të shkojnë deri te ndryshimet kushtetuese që janë, e dimë të gjithë, pjesë pak më e vështirë e procesit.

Si do qoftë e kemi trajtua seriozisht dhe shumë shpejtë edhe deputetët edhe kryetarët e grupeve parlamentare dhe të gjitha institucionet do t'i kenë edhe hulumtimin por edhe rekomandimet konkrete të cilat normalisht nuk janë fjalë e fundit por që duhet të plotësohen pas një debati edhe qeveritar, edhe ta them politik, edhe konsensual shoqëror.

Çështja tjetër shumë e rëndësishme që u shtrua, për të cilën unë kam edhe pyetje parlamentar por nuk e di deputetja a do të jetë këtu për t'u përgjigjur, por sidoqoftë po flas diçka, është çështja e tarifave të policave të sigurimit kufitar.

Unë mendoj që është një prej atyre çështjeve që në bashkëpunim të shumë mekanizmave ndonjëherë jo çdo herë të koordinuar por ndonjëherë edhe të koordinuar është arritur një hapë, nuk është krye puna por e kemi bërë një hapë tutje dhe në këtë drejtim të gjithë e kanë luajtur rolin e vetë.

Ne si ministri e kemi shtrua disa herë çështjen, Zyra e kryeministrit e ka trajtua, Kuvendi i Kosovës, ju si deputetë të opozitës, kryetari i Komisionit për Financa zoti Osmani, kryetari i Kuvendit nga shumë është shtrua, është diskutua. Ne kemi bërë përpjekje që ta trajtojmë shumë seriozisht dhe të gjemë mekanizma si rezultat të parë ky përgjysmim i çmimit për të cilin unë personalisht nuk jam i kënaqur, mendoj që është bërë vetëm gjysma e punës dhe se duhet të bëjmë gjithë bashkërisht më shumë për ta gjetur rrugën se si të zgjidhet ky problem që nuk është krejt i lehtë, lidhet me vështirësitë e Kosovës për të qenë anëtare e Këshillit të Byrove për shkak se Kosova nuk është anëtare e OKB-së, por unë vazhdoj të mendoj që mund të gjinden alternativa për t'u zgjidhur ky problem.

Sidoqoftë, mendoj që nuk është krejt adekuate që Policia e Kosovës ndonëse nuk është resor i imi të trajtohet si pjesë e ndonjë skeme me byronë kosovare të sigurimit, kjo është një marrëveshje institucionale, ndërsa Policia e Kosovës vazhdimisht është e brengosur, unë jam kontakt me ta dhe kemi bërë edhe unë si ministër edhe Zyra e kryeministrit edhe Policia e Kosovës ka bërë vazhdimisht, kemi bërë letra te Byroja Kosovare e Sigurimit sidomos tash për

kohën e verës që ta shtoj numrin e punëtorëve, çdo herë deri në këtë verë Byroja Kosovare e sigurimeve e ka shtuar numrin e punëtorëve, kësaj radhe nuk e ka shtuar dhe ka shkaktuar radhë të gjata tek ato vendet ku nxirren kartonët, edhe zyra e kryeministrit, edhe Policia, edhe unë personalisht kemi bërë përpjekje që nëpërmjet letrave ta adresojmë këtë çështje, ende nuk është zgjidhur ky problem por vetëm po dua të ju tregoj që edhe Policia me të cilin ne kemi bashkëpunim edhe kemi një bashkëpunim shumë korrekt në priten e bashkatdhetarëve edhe institucione tjera jemi duke bërë përpjekje në kuadër të përgjegjësive tona që t'i adresojmë këto probleme.

**KRYETARI:** Faleminderit, ministër për këto sqarime. Salih, urdhëro!

**SALIH SALIHU:** Faleminderit ministër për këto sqarime!

Këtu është fakt që ndoshta e di që si qëndrojnë dhe i keni adresua dhe jeni duke i adresuar sigurisht. Por, çështja e ndërtimit të objekteve hijeno-sanitare, e cila ndoshta nuk është pjesë e sektorit të juaj por e kolegëve tuaj mendoj që është çështje shumë urgjente, mua nuk më duket fer që për shembull mërgimtarët gra dhe fëmijë me dal tash me hy malit për nevojat e tyre fiziologjike. Ndërkaq bëjmë manifestime, organizime kështu thjesht që na kushtojnë shumë më shumë se sa këto objekte dhe këto mund të bëhen në çdo pikë kufitare. Është keq shumë të themi tash të kthehemi 50 kilometra te një objekt të them në restorant ta shfrytëzosh një tualet kur s'ke në shembull në kufi. Prandaj, mendoj që është e pandershme ndaj tyre, këto mund të bëhen me pak para dhe kjo është në kompetencën e ministrive tona që nuk varet nga dikush tjetër, por ne vetë.

**KRYETARI:** Faleminderit! Urdhëro, ministër prapë!

**MINITRI VALON MURATI:** Salih, pa dashur ta shndërroj këtë në një debat, çështje shumë e rëndësishme. Ne e kemi trajtua në ministri këtë problem, e kemi trajtuar me Policinë e Kosovës është çështje që e kemi trajtuar po flas para zezonës dhe ka qenë vonë të ndërhyhet për të bërë diçka më shumë, në bisedat e mia që i kam pasur me Policinë e Kosovës del se është përgjegjësi e komunave dhe ne shumë seriozisht që nga ta them mos ta them që sigurisht do ta kemi vështirë për periudhën e verës por për periudhën e vitit të ardhshëm shumë seriozisht me komunat të cilat kanë mundësinë ne do ta diskutojmë seriozisht që të vendosen këto hapësira, për më tepër është një marrëveshje edhe me Komisionin Evropian që të ndërtohen këto pikat e reja kufitare si në Merdar, si në Dheun e Bardhë, të cilat do ta kishin adresuar sigurisht në mënyrë më permanente këtë çështje për shkaqe të caktuar të ndryshme jo çdo herë për fajin e Qeverisë të Republikës së Kosovës nuk ka fillua ndërtimi i këtyre pikave kufitare.

**KRYETARI:** Faleminderit, ministër! Jemi në pikën e dytë të rendit të ditës:

## **2. Koha për pyetje parlamentare**

Në bazë të nenit 45, paragrafi 1 i Rregullores së Kuvendit, koha për pyetje parlamentare zgjatë 60 minuta. Për këtë seancë janë parashtruar 22 pyetje parlamentare. E ftoj deputetin Daut Hardainaj, pyetje për ministrin Skender Hyseni. Ministri nuk është këtu. Daut, urdhëro!

DAUT HARADINAJ: E kam bërë pyetjen edhe herën e kaluar në mungesë të ministrit edhe është e njëjta temë, unë edhe ashtu e tërheq pyetjen. Sa për opinion publik, pyetja ka qenë rreth Ligjit për pensionimin e policisë.

KRYETARI: Faleminderit! Deputetja Salihe Mustafa, po ashtu më duket nuk qenka këtu, pyetje për ministrin Valon Murati, ministri vetëm sa u përgjigj në pjesën më të madhe, por sido që të jetë presim deri në fund. Deputeti Rrustem Berisha, pyetje për ministrin Arsim Bajrami.

RRUSTEM BERISHA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritarë,

I nderuar kryeministër,

Republika e Kosovës synon të ndërtoj një sistem funksional dhe modern të sigurisë. Arsimi dhe aftësimi i studentëve universitar në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë është e një rëndësie të veçantë dhe ka për qëllim që të ndihmoj në zhvillimin e liderëve të ardhshme të Ministrisë së Mbrojtjes, ose të Ushtrisë së Kosovës.

Prandaj, pyetja ime për ju zoti ministër është: Universiteti i Prishtinës a ka themeluar ndonjë program të veçantë në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë dhe nëse jo kur do ta themelojë një program të tillë?

*(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)*

KRYESUESI: Zoti ministër Bajrami, e keni fjalën.

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: Ju falënderoj, i nderuar deputet Berisha për pyetje, Pyetja është e karakterit akademik, është çështje e universitetit, por unë jam i interesuar për pyetjen e juaj dhe më lejoni të ju japë përgjigje për mundësitë.

Aktualisht studimet për sektorin e sigurisë janë shumë të rëndësishme duke qenë që Kosova ndodhet në një fazë të pritjes së Ushtrisë së Kosovës dhe pa dyshim se udhëheqja e mirë dhe profesionale e ushtrisë së Kosovës kërkon njerëz profesionistë të shkolluar që duhet të shkollohen në Kosovë por edhe jashtë Kosovës.

Për momentin brenda programeve të akredituara nuk kemi një program as në ciklin bachelor as në ciklin master të sigurisë dhe ne duhet të punojmë në dy drejtime. E para t'i shohim cilat janë mundësitë tona kadrovike që të kemi profesor të mirë dhe e dyta të punojmë një kurrikulë, të përgatitim një kurrikulë të mirë për ciklin bachelor dhe master dhe e treta këtë program të akreditojmë pranë Agjencisë së Akreditimit në mënyrë që të fillojmë.

Në bazë të analizave mendojmë se ky program do të mund të instalohet brenda Fakultetit të Shkencave Sociale, Fakultetit Filozofik dhe ministria do ta ndihmoj këtë proces, do ta ndihmojë universitetin duke shpejtuar një proces të akreditimit të Agjencia Kosovare e Akreditimit, por gjithmonë duke pasur parasysh standardet e cilësisë dhe kriteret profesionale.

Kështu që kjo ide e juaj është një ide shumë e mirë e cila do t'i përcillet rektorit të Universitetit të Prishtinës dhe nga ai do të kërkojmë që për vitin e ardhshëm akademik të shqyrtoj mundësitë eventuale të pilotimit të këtij projekti fillimisht me një numër të kufizuar studentëve dhe pastaj po shpresoj edhe të ngritjes nga Departamenti tek një fakultet plotësisht i pavarur brenda Universitetit të Prishtinës.

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zoti Berisha?

RRUSTEM BERISHA: Faleminderit ministër për përgjigjen!

Unë mendoj se sipas edhe analizës të rishikimit të sektorit strategjik është edhe rekomandimi i Ministrisë së FSK-së për themelimin e një programi të tillë, edhe përgjigjja juaj ishte adekuate. Faleminderit!

KRYESUESI: Deputeti Berisha përsëri pyetje për ministrin Zharku.

RRUSTEM BERISHA: Faleminderit, kryesues!

Pyetja ime për ministrin e Infrastrukturës ka të bëjë me kthimin e kontrollit të hapësirës ajrore të Republikës së Kosovës që parashihet të bëhet pas vitit 2019, domethënë pas pesë viteve edhe sipas vlerësimeve pas këtij viti parashihet se diku 1 000 aeroplanë në ditë të qarkullojnë mbi hapësirën ajrore të Kosovës dhe mbi një tarifë diku 50 euro për një aeroplanë fluturues edhe nëse këto statistika i llogaritim del se ka përfitime të jashtëzakonshme domethënë për buxhetin e Kosovës.

Pyetja ime për ju, zoti ministër, është: A është duke punuar ministria e juaj që t'i ngritë kapacitetet e veta që pas përfundimit ose pas vitit 2019 të jetë e gatshme që ta marrë menaxhimin e kontrollit të hapësirës ajrore të Republikës së Kosovës.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI LUTFI ZHARKU: Zoti nënkryetar,

Zoti kryeministër,

Ministra,

Të nderuar deputetë,

I nderuar deputet Berisha,

Ministria e Infrastrukturës është duke punuar me kontrollin ajror të aeroportit dhe autoritetin e aviacionit civil për ngritjen e vazhdueshme të kapaciteteve njerëzore dhe teknologjike me qëllim të marrjes së plotë të përgjegjësive të kontrollit të trafikut ajror në tërë hapësirën ajrore të Republikës së Kosovës që presim të bëhet në prill të vitit 2019.

Në kuadër të politikave zhvillimore të Ministrisë së Infrastrukturës, për sektorin e aviacionit civil është paraparë dhe ngritja e kapaciteteve infrastrukturore dhe burimeve njerëzore të ofruesit të shërbimeve të navigacionit ajror për të dhënë shërbime në hapësirën e lartë ajrore pas vitit 2019 veprime që do të ndikonin në zhvillimin e transportit ajror të Republikës së Kosovës.

Për realizimin e këtij qëllimi Ministria e Infrastrukturës ka kërkuar që Agjencia për Shërbime të Navigimit Ajror të përfshihet me rishikimin e buxhetit për vitin 2015 dhe në planifikimet

buxhetore për vitet e mëtejme, por për shkak të kufizimeve buxhetore nuk ka mund të kryhet me rishikim.

Ne presim që kjo çështje të rregullohet me Ligjin e buxhetit për vitin 2016 me të cilin akt ndërmarrja publike, kontrolli ajror në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës do të shndërrohet në agjenci të shtetit në përputhje me Ligjin për shërbimet e navigimit ajror.

Pas shndërrimit të kontrollit ajrorë në agjenci të shtetit do të sigurohet edhe qëndrueshmëria financiare e agjencisë dhe investimet e nevojshme për marrjen e plotë të ofrimit të shërbimeve në hapësirën tonë të lartë ajrore pas përfundimit të marrëveshjes midis NATO-s dhe Hungarisë në prill të vitit 2019. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Pyetje shtesë, zoti Berisha?

**RRUSTEM BERISHA:** Faleminderit, ministër për përgjigjen!

Unë e kam edhe një pyetje, deri në vitin 2019 kur thatë edhe ju që do të bëhet rikthimi i kontrollit të hapësirës ajrore, a mendoni që t'i ngrini shërbimet të cilat do të jenë në bashkëpunim me kontrollin që bëhet nga Kompania hungareze domethënë të keni një bashkëpunim edhe të rriten shërbimet në raport me këtë kompani sepse dihet që ata prej Hungarisë është problem të bëjnë edhe kontrollin e hapësirës ajrore.

**KRYESUESI:** Zoti ministër Zharku, e keni fjalën.

**MINISTRI LUTFI ZHARKU:** I nderuar deputet,

Ne kemi informacion se Agjencia për Shërbime të Navigacionit Ajror mund t'i kryejë edhe tash ato shërbime, por për shkak të marrëveshjes së KFOR-it me hungaro-kontrollin nuk e kemi atë të drejtë të themi, nuk mund t'i kontrollojmë, përndryshe pa kurrfarë problemi me kërkesë të hungaro-kontrollit ne mund ta kryejmë edhe atë shërbim.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Deputetja Teuta Haxhiu, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa.

**TEUTA HAXHIU:** Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Zoti kryeministër,

Pse ju si Qeveri e Republikës së Kosovës nuk e krijoni një aviokompani shtetërore e cila do të merrte përgjegjësinë e transportit të bashkatdhetarëve tanë të cilët dita e ditës po maltretohen nga kompanitë që operojnë.

**KRYESUESI:** Kryeministër, e keni fjalën

**KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA:** I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritarë,

Sa i përket pyetjes lidhur me hapjen e një kompanie shtetërore ashtu siç është shtruar aviokompanie, unë mund të them këtë Qeveria nuk e ka në agjendë, sepse ne në procesin e derregullimit ekonomik që nënkupton se gjithë ajo që ka qenë pronësi shtetërore përkatësisht në

pronësi shoqërore e që nuk është e lidhur me shërbimet publike ose me nocionin e shërbimeve publike që ofrojnë qytetarëve t'i takojë sektorit privat.

Ne jemi të vetëdijshëm lidhur me problemet me të cilat po ballafaqohen qytetarët tanë dhe deputetja ka plotësisht të drejtë që të adresoj zgjidhjen e këtij problemi për shkak të papërgjegjësisë së agjencive private të fluturimit qoftë ato që janë të regjistruar në Kosovë ose në vende të tjera, por konsideroj se kjo çështje nuk mund të rregullohet përmes themelimit të një aviokompanie shtetërore ose publike, sepse te ne nuk kemi nocionin e pronës shtetërore si nocion që kemi rregulluar me ligj, kemi nocionin e pronës private, pronës publike dhe mbeturinave të pronës shoqërore që kemi në AKP që dëshirojmë ta shndërrojmë në pronë private, përkatësisht në pronë publike aty ku Kuvendi konsideron se ajo mund të bëhet.

Unë konsideroj se këtë çështje ne duhet ta zgjidhim përmes masave që ju do t'i marrim si masa ligjore ndaj kompanive private që merren me këtë çështje, të masave përmes forcimit, ekzekutimit, garancive që lëshohen përmes ministrisë së Transportit tek ne dhe masave përmes konkurrencës që ne duhet të bëjmë përmes tërheqjes së agjencive dhe aviokompanive, të cilat ofrojnë çmime më të ulëta, sepse çmimet e fluturimeve janë tepër të larta për qytetarët tanë në krahasim me ato që janë në regjion. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zonja Haxhiu, dëshironi pyetje shtesë? Po!

**TEUTA HAXHIU:** Kryeministër, e di që nuk e keni në agjendë, mirëpo ju keni kërkuar vazhdimisht nga bashkatdhetarët tanë që jetojnë në Diasporë për t'u përfshirë aktivisht në zhvillimin ekonomik të vendit.

Shteti i Zvicrës dhe shteti gjermanë shumë shpejtë kanë reagu duke arrestuar edhe pjesëtarë të këtyre kompanive që i mashtrojnë bashkatdhetarët tanë, kjo është edhe një përgjegjësi shtesë që duhet ta keni ju si Qeveri.

Disa nga këto kompani Aeroporti i Prishtinës i licencon për të operuar. Andaj, ne ju sugjerojmë që të merrni hapa konkretë dhe ta futni në agjendën tuaj themelimin e një kompanie të përbashkët, pse jo ndërmjet dy shteteve, shtetit tonë dhe shtetit të Republikës së Shqipërisë. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Deputetja Teuta Haxhiu, pyetje për ministrin Arsim Bajrami.

**TEUTA HAXHIU:** Faleminderit, nënkryetar!

Zoti ministër, pyetja ime për ju është a jeni të informuar ju si ministër i Ministrisë së Arsimit që në komunën e Dragashit 200 nxënës shqiptarë të Gjymnazit "Ruzhdi Berisha" ka vite.....

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYESUESI:** Ministër, e ke fjalën.

**MINISTRI ARSIM BAJRAMI:** E nderuara deputete Haxhiu,

Në komunën e Dragashit ekziston vetëm një shkollë e mesme Ruzhdi Berisha” kurse së shpejti do të promovohet edhe shkolla e parë profesionale.

Numri i nxënësve që vijojnë nga Dragashi në Prizren nuk është 200 por është 50 dhe këta shkojnë në Prizren për shkak se Shkolla e Mesme në Dragash nuk ofron mësim për drejtimet teknike dhe mjekësore dhe është e natyrshme që këta duhet të shkojnë në Prizren në qytetin më të afërt ata që dëshirojnë të shkojnë në mjekësi dhe në teknikë.

Përndryshe, kjo shkollë e mesme ofron mësim për të gjitha drejtimet tjera dhe në bazë të udhëzimeve administrative nxënësit e një komune nuk mund të shkojnë në qytetin tjetër në qoftë se ajo komunë ofron mësim në ato drejtime. Kështu që kjo është një çështje krejt normale që këta nxënës që janë 50 kanë zgjedh Shkollën e Mesme të Mjekësisë në Prizren apo shkollën profesionale teknike për shkak se këto dy programe nuk ofrohen në komunën e Dragashit.

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë?

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, ministër!

Megjithatë unë kështu i kam informatat nga njerëz përgjegjës në atë komunë, ndoshta edhe mund të mos jenë 200 saktësisht më është thënë. Por, megjithatë, pyetja ime prapë. A mendoni që duhet të jenë programe më atraktive që të ndalin këta edhe 50 në qoftë se janë që ata të vijojnë mësimet në komunën e tyre, çfarë ju do të bëni si ministri që në të ardhmen të mos kenë probleme me udhëtim dhe me financim familjet e tyre? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër!

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: E nderuara deputete,

Planet e ministrisë janë që edhe në komunë të ndërtojnë shkolla profesionale dhe shkolla profesionale të degëzohen në të gjitha drejtimet që janë me interes për tregun e punës dhe që janë zgjedhje e maturantëve. Në komunën e Dragashit shpejt do të përrurohet shkolla profesionale dhe ne do të punojmë që të ofrojmë drejtime teknike dhe mjekësore, në mënyrë që këta 50 nxënës, shifra është e saktë, sepse ka ardhur nga Drejtoria Komunale e Arsimit, këta 50 nxënës të kenë mundësi në Dragash të kryejnë shkollën profesionale, e jo të udhëtojnë në Prizren.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Slavko Simiq, pyetje për ministrin Skënder Hyseni. Dëshironi ta bëni pyetjen, ministri s’është këtu?

SLAVKO SIMIĆ: Hvala, predsedajući!

Poštovani predsedniče Vlade,

Poštovani ministri,

Dame i gospodo, narodni poslanici,

U prvih pet meseci ove godine zabeleženo oko 180 etničkih motivisanih napada, posebno u oblasti opština Peč i Klina.

Svedoci smo da je zadnjih meseci došlo do porasta incidenata koja uključuju srpsku zajednicu. Na primer, u Goraždevac dogodilo se nekoliko incidenata, uključujući i napad na vozilo koja imala Beogradske tablice, kao i podmetanja požara na spomeniku o deci ubijenoj 2003. godine.

Na istom tom spomeniku, koji je zapaljen, ispisan je grafit sa natpisom "Osveta". U Klini se dešavaju gotovo svakoga dana pljačkaški napadi na Srbe povratnike, kao i verbalnima napadi na...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Ju lus për qetësi, të nderuar deputetë!

SLAVKO SIMIĆ: ...u Klini se dešavaju gotovo svakoga dana pljačkaški napadi na Srbe povratnike, kao i verbalnima napadi na njih. U Kišnici, opština Gračanica, u toku jedne nedelje tri puta je kamenovana imovina porodice Krstić. I to su samo neki od primera od skorašnjih incidenata koji su se dogodili samo u ovoj godini.

Ovaj trend napada na pripadnike srpske zajednice na Kosovo ne mogu se više tretirati kao izolovani slučajevi, već Kosovske institucija trebaju preduzeti ozbiljne mere na pružanju bezbednosti za srpsku zajednicu kao celinu, a posebno za povratnike.

U vezu ove teme imam pitanje za ministra Skendera Hyseni kojeg vidim da danas nije ovde, ali ja sam hteo da predstavim ovaj problem i takodje ču pročitati i pitanje u nadi da ministar na nekoj od narednih sednica dati odgovor. Pitanje glasi: Kako je došlo do ovog rasta nasilja nad Srpskom stanovništvom na Kosovu, i šta rade Policija i bezbednosne strukture u privodjenju odgovornih klica za ova krivična dela? Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Luljeta Veselaj-Gutaj, pyetje për ministrin Arsim Bajrami.

LULJETA VESELAJ-GUTAJ: Faleminderit, kryesues!

Përshëndetje Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

I nderuari ministër, nevojat e qytetarëve të Prizrenit për kopshte publike të fëmijëve janë të shumta dhe janë të mëdha.

Përveç familjes me rëndësi të madhe janë edhe institucionet jashtë familjare. Qasja në çerdhe dhe shkollimin e edukimin e hershëm është me rëndësi për dhënie të shanseve të barabarta të fëmijëve. Duke pasur parasysh që fëmijët e moshës së re mësojnë shpejt dhe i formojnë kompetencat e tyre themelore, siç janë perceptimi, fantazia, të menduarit, afërsia sociale, si dhe shkathtësia trupore, rëndësi të veçantë ka komunikimi në zhvillimin e inteligjencës së fëmijëve dhe socializmin e tyre si domosdoshmëri.

Pra, çerdhja dhe grupi i lojës janë faktorë vendimtarë për fazat e mëvonshme të të mësuarit qoftë dhe në përgjithësi. Prizreni ka pasur një kopsht publik i cili quhej "Yllka" i hapur në vitin 1977 me kapacitet prej 240 fëmijë të moshës nga 6 muaj deri në 6 vjeç. Ky institucion ka qenë publik deri në vitin 2011, mirëpo nga viti 2011 funksionon si institucion privat i udhëhequr nga Kolegji "Mehmet Akif". Nga viti 2011 Prizreni si qytet i dytë nga numri i banorëve në Kosovë mbetet pa kopsht publik të fëmijëve. Kërkesat dhe nevojat e qytetarëve të Prizrenit janë të shumta.

Pyetja ime, i nderuari zoti ministër, është kjo: a do të keni si prioritet në zhvillimin e projekteve të juaja edukativo-arsimore hapjen e një kopshti publik në qytetin e Prizrenit? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër e keni fjalën!

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: E nderuar deputete Veseli-Gutaj të falënderoj shumë për pyetjen, më lejoni të jap përgjigjen.

E para, Qeveria dhe Ministria e Arsimit kanë tri prioritete të arsimit para fillor, pra të kopshtet. Prioriteti i parë është gjithë përfshirja, sa më shumë fëmijë në kopshte apo politika asnjë fëmijë të mos mbetet pa kujdesen në kopshte. E dyta, ne kemi nevojë për të përgatitur kurrikula të mira për fëmijët e moshave para fillorë dhe jemi në proces të dizajnit të kurrikulave për fëmijët prej 0 deri në moshën 6 vjeçare. Dhe, e treta, prioriteti i tretë neve na duhen mësimdhënës të përgatitur apo edukatorë të përgatitur për kopshte, sepse këta janë edukatorë specifik apo special dhe bashkë me Qeverinë Zvicerane jemi duke zhvilluar një proces të trajnimit që të krijojmë 150 kopshte publike, të mira dhe të krijojmë 150 mësimdhënës të mirë që pastaj do të përhapet në tërë Republikën e Kosovës.

Tek pyetja juaj konkrete, mua më vjen keq që Komuna e Prizrenit nuk ka punuar më shumë për të hapur më shumë kopshte publike, sepse politikat e ministrisë kërkojnë një qasje shumë proaktive të komunave ndaj kopshteve publike, sepse kemi mjaftë kopshte private por ne jemi të interesuar për të krijuar kopshte publike.

Duhet ta kuptoni që në bazë të ligjit për arsimin në komuna, kompetenca për të hapur kopshte dhe për të menaxhuar kopshte është te drejtoritë komunale, por meqenëse Ministria e Arsimit bën planifikimin hapësinor ne do të lutemi që këto kërkesa të vijnë me kohë dhe të përfshihen në grandin specifik me kohë. Nuk mundemi kërkesa ad hoc të përfshijmë në buxhet, sepse do ta debalancojmë buxhetin.

Një planifikim i mirë buxhetor kërkon që këto kërkesa për kopshte të vijnë nga komunat, nga Komuna e Prizrenit me kohë në mënyrë që ministria bashkë me Ministrinë e Financave ta përfshijë brenda grandit specifik dhe të krijojnë mundësi buxhetore, sepse nuk kemi mundësi të marrim kërkesa ad hoc që nuk planifikohen me kohë. Kështu që kërkesa juaj do t'i dërgohet komunës së Prizrenit dhe ne do të kërkojmë nga komuna e Prizrenit që në planin për vitin 2016 ta përfshijë ndërtimin e këtij kopshti publik.

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë Luljeta? Jo! Në rregull! Deputeti Visar Ymeri, pyetje për ministrin Blerand Stavileci. Ministri s'qenka këtu.

VISAR YMERI: Faleminderit! Kjo pyetje është dorëzuar për javën e kaluar por nuk i erdh rendi javën e kaluar, por edhe atëherë s'ishte ministri, s'është as sot edhe në fakt ka një kohë të gjatë që s'e kam pa shpresoj të jetë ende ministër.

Sidoqoftë unë po e lexoj çështjen, sepse mendoj që është edhe aktuale edhe e rëndësishme. Pyetja e parë ka të bëjë me rindërtimin ose dekomisionimin e Kosovës A, e cila është temë aktuale edhe sot e kësaj dite edhe ka qenë për një kohë të gjatë siç e dinë të gjithë për një kohët të

caktuar Kosova ka hyrë në një zotim me sekretariatit për energji për rajonin që Kosova ose termocentral të dekomisionohet më së voni në vitin 2017 gjë që është edhe jo realiste dhe aspak në interes të Kosovës sot duke pasur parasysh se çfarë gjendje kemi me furnizimin me energji elektrike.

Natyrisht situata energjike në vend as për së afërmi nuk na e krijon komoditetin që ta neglizhojmë këtë çështje, pra edhe siç ndodh te termocentralin Kosova A. Dekomisionimi i A-së do ta fillonte edhe më tutje krizën energjetike edhe varësinë nga eksporti që po e shohim të ndodh viteve të fundit veçanërisht. Në këtë drejtim kompania gjermane “Bil Finger” ka kohë që ka paraqitur një propozim për rindërtimin e termocentralit Kosova A. Ky propozim do t’ia ngriste ndjeshëm kapacitetet gjeneruese KEK-ut dhe po aq me rëndësi do ta mbante këtë tërësisht në pronësi publike.

Pra, përkundër asaj që shpeshherë është spekuluar në media ose është keqinterpretuar në media se do të jetë investim gjerman, nuk është investim gjerman ky do të jetë investim publik i Kosovës edhe natyrisht teknologjia do të jetë e “Bill Finger” po çka është shumë me rëndësi një termocentral plotësisht i rindërtuar, i rivitalizuar do të mbetet në pronësi publike të Kosovës dhe gjendja me furnizimin me energji elektrike do të ishte e përmirësuar ndjeshëm për një kohë shumë më të shkurtër se sa do të merrte termocentrali Kosova e Re ose propozimi tjetër.

Pra, pyetja për ministrin është se çka do të ndodh me Kosovën A? Pra, cili është vendimi ose qëndrimi i Qeverisë karshi kësaj çështje, a do të rindërtohet, apo do të dekomisionohet ajo?

**KRYESUESI:** Faleminderit! Deputeti Salih Salihu, pyetje për ministrin Ferid Agani.

**SALIH SALIHU:** Faleminderit, kryesues!

Faleminderit, ministër që je prezent!

Pyetja ka të bëjë rreth lumit Morava që është bërë problem permanent në Komunën e Vitisë duke u shkaktuar dëme të konsiderueshme fermerëve dhe ekonominë familjare nga vërshimet të cilat bëhen për shkak të dëmtimit dhe ngushtimit të shtratit të lumit Morava.

Pyetja është kështu: zoti ministër çka keni ndërmarrë deri më tash rreth zgjidhjes së këtij problemi? Faleminderit!

**KRYESUESI:** Zoti ministër e keni fjalën!

**MINISTRI FERID AGANI:** Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuari zoti kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

I nderuari zoti deputet,

Kjo çështje është njëra prej çështjeve e cila ka qenë prioritet në punën e ministrisë, veçanërisht në muajt e pranverës kur lumi Morava e dimë që s’ka vërshuar dhe ka vërshuar dhjetëra mijëra hektarë duke shkaktuar dëme të konsiderueshme. Atë që Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor e ka bërë është se me kohë e ka identifikuar si një prioritet në strategjinë shtetërore të

ujërave mbi bazën e kësaj strategjie është punuar studimi i fizibilitetit për tërë rrjedhën e lumit në gjatësi prej 48 km. Është vlerësuar se ky projekt i rregullimit të shtratit të lumit do të kushtojë 8.4 milionë euro duke pasur parasysh se nuk i kemi të parashikuara brenda kornizës afatmesme të shpenzimeve.

Jemi duke bërë përpjekje që të sigurojmë mbështetje financiare ose nga komisioni evropian ku kemi konkurrim së bashku me ministrinë e lindjes, ose brenda kornizës investive të Ballkanit perëndimor, e cila tani është aktuale dhe ku ky projekt është njëri prej projekteve më prioritare i paraqitur për financim.

Në ndërkohë përveç këtyre masave afatmesme për vitin 2016 Ministria e Mjedisit e ka kërkuar në qarkoren e dy buxhetore ka kërkuar gjithsesi që të ndahen 300 mijë euro si ndihmë emergjente për rregullimin e shtratit të lumit, në mënyrë që të fillojmë punën në vitin tjetër, por edhe këtë vit pas dështimit tonë që të sigurojmë këto mjete në rishikimin e buxhetit atëherë do të sigurojmë një shumë prej rreth 20 mijë euro që t'i japim komunës së Vitisë e cila do të merret me rregullimin e një pjese të shtratit të lumit që është më kritik në mënyrë që të bëjmë një urëzim të situatës deri në vitin 2016.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Pyetje shtesë, zoti Salihu?

**SALIH SALIHU:** Faleminderit, ministër!

Unë qëllimisht e shtova pyetjen këtë kohë duke pas parasysh që tash është verë dhe moti është relativisht i thatë dhe ka mundësi të punohet, mos të pritët vjeshta. Në qoftë se domethënë ka buxhet të limituar dhe nuk ka fare mundësi të intervenohet këtë vit, do të thotë shihet që edhe këtë vit do të kemi probleme do të vërshohen do të thotë mijëra hektarë të kësaj toke unë mendoj që dëmi ka për të qenë mjaftë i madh por mendoj që duhet të bëni përpjekje maksimale që së paku vitin e ardhshme thjeshtë të intervenohet duke filluar nga pranvera deri në shtator që të kryhet kjo, se përndryshe në qoftë se vazhdoni edhe një vit atëherë me të vërtetë më shumë do të bëhen dëme se sa do të investohet me at kapital që ju pritni me fitu. Faleminderit!

**KRYEUESI:** Faleminderit! Në rregull. Zoti Visar Ymeri, pyetje për ministrin Blerand Stavileci.

**VISAR YMERI:** Faleminderit! Prapë pyetje për të njëjtin ministër dhe për të njëjtën fushë, për energjetikën.

Në një intervistë dhënë të përditshëm “Zëri”, më 24 qershor të këtij viti, zëvendës-presidenti i Fondit investiv “Konto Global” ofertuesi i vetëm për tenderin për ndërtimin e e termocentralit Kosova e Re deklaroi se për sa i përket energjisë elektrike të gjeneruar nëse ajo do të shitet në tregun e brendshëm apo do të eksportohet do të varen nga operatori i sistemit të transmisionit. Pra, po e citoj ai ka thënë në intervistë kështu: “ne do t’ia shesim energjinë një kompanie në pronësi Qeverisë e cila do të vendos ku do të shitet ajo energji”.

Pra, si duket ose nga ky deklaram kuptohet që dizajni i tregut do të jetë i tillë që transaksionet mes Kosovës së Re në pronësi private dhe KEDS-it po ashtu në pronësi private do të ndërmjetësohen nga ... me pronësi publike ose nga operatori i transmisionit i cili është në pronësi publike. Dhe pyetja për ministrin është kështu: a mund të na tregoni se kush e mbulon dallimin

në mes çmimit të shitjes së megabajtit nga Kosova e Re dhe çmimit të blerjes nga KEDS-i. Duke pasur parasysh që çmimi i cili është përlogaritur nga Banka Botërore që do të rezultojë nga gjeneruesi i ri, pra termocentrali Kosova e Re nuk do ta ketë të mundur të jetë më pak se 80 euro por vetëm për mbi 80 euro, ndërkohë që deri tash KEDS-i pra nga KEK-u, pra nga operatori publik megabajti për energji elektrike e paguajnë jo më shumë se 27 euro.

Pra, është një dallim jashtëzakonisht i madh çmimit të energjisë ndërkohë që sipas raporteve të KEDS-it edhe importin mesatarisht e paguajnë 55 euro. Ky dallim në çmimi kush do ta mbulojë këtë? A Kosti pra prej parave të buxhetit të Republikës së Kosovës drejtpërdrejt apo qytetari që në mënyrë indirekte do ta mbulojë këtë përmes çmimit të energjisë elektrike?

**KRYESUESI:** Faleminderit! Kemi dy pyetje të zonjës Demaku një për kryeministrin Isa Mustafa, një për zëvendëskryeministrin Thaçi. Puhia nuk është këtu. Vazhdojmë me zonjën Ganimete Musliu pyetje për ministrin Skënder Hyseni, zonja Musliu dëshironi?

**GANIMETE MUSLIU:** Faleminderit, zoti kryesues!

Meqë ministri nuk është i pranishëm unë do të kërkoj që pyetjet parlamentare t'i barti në seancën tjetër. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Edhe pyetjen tjetër që i ke dy një pas një. Në rregull. Deputeti Ismajl Kurteshi pyetje për ministrin Imet Rrahmani. Zoti Kurteshi e keni fjalën.

**ISMAJL KURTESHI:** Faleminderit! Zoti ministër, mjekët e QKUK-së të cilët kishin referuar pacientë të vdekur për fondin për trajtim jashtë vendit përmes Ministrisë së Shëndetësisë kanë kërkuar të holla nga Ministria e Shëndetësisë për spitalet private "International Hospital Medicine" nga Turqia në Kosovë me arsyetimin se kishin trajtuar dy pacientë që kishin vdekur muaj më parë.

Klinika e Kardiologjisë për të dyja rastet kishte lëshuar fletë referencë se kinse këta pacientë i plotësonin kriteret për trajtim jashtë vendit. Inspektorati shëndetësor i Ministrisë së Shëndetësisë i ka vërtetuar këto dyshime por nuk ka ndërmarrë asnjë masë. Zoti ministër, a jeni njoftuar me rastin nëse jeni çka do të ndërmerrni ndaj mjekësve të QKUK-së, klinikës kardiologjisë, inspektoratit shëndetësor të Ministrisë së Shëndetësisë dhe bordit etik. A do të inicioni mbylljen e spitalit turk për shkak të skandaleve të njëpasnjëshme?

**KRYESUESI:** Ministri nuk është këtu, siç po e shihni dhe një pyetje zoti Kurteshi e keni për ministrin Arsim Bajrami.

**ISMAJL KURTESHI:** Po, faleminderit! Zoti ministër maturantët e Kosovës gjatë 10 -15 vjetëve të fundit po shkojnë në ekskursionë në fillim të vitit shkollor. Kështu që në vend se të koncentrohen në mësim, ata po koncentrohen një herë në ekskursionë më vonë në ahengje të tjera si mbrëmjet e maturës, të paramaturës e kështu me radhë dhe po e humbin koncentrimin për angazhim në mësim.

Ekskursionet nuk po shfrytëzohen ashtu siç janë planifikuar për t'i vizituar vise të ndryshme me rëndësi historike të trojeve shqiptare. Ekskursion, ekzistojnë fakte se në ekskursionet shumë

nxënës kohën kryesisht e kalojnë nëpër kafiteri duke konsumuar duhan, pije alkoolike, madje edhe substanca narkotike dhe merren edhe me çështje tjera që nuk iu përkasin nxënësve.

Po ashtu dihet se nga tenderët për ekskursionë në shumë raste përfitojnë ata që po merren me organizmin e këtyre tenderëve, e këto janë autoritetet e shkollave. Nga këto ekskursionë nuk po përfitojnë pothuajse asgjë të mirë nxënësit përkundrazi ata po humbin në çdo aspekt, prandaj zoti ministër është e domosdoshme që ministria që e drejtoni të ndërmerr veprime konkrete që e rregullojnë këtë çështje sa më parë. Së pari në ekskursion mund të dërgohen vetëm nxënësit me sjellje dhe sukses shumë të mirë dhe të shkëlqyeshëm. Ekskursionet patjetër mendoj që duhet të organizohen në fund të vitit, pra në pranverë e jo në vjeshtë kur fillon mësimi MASHT-i duhet ta hartojë një plan edukativo arsimor që do të realizohet gjatë ekskursionit, tenderet për ekskursionë do të duhej t'i menaxhojnë përfaqësuesit e nxënësve, prindërve dhe mësimdhënësve.

Nëse nuk ndërmerren këto masa ekskursionet është më mirë të ndërpriten se sa të shkojnë kështu qysh kanë shkuar deri tash. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti ministër, e keni fjalën.

**MINISTRI ARSIM BAJRAMI:** I nderuar deputet Kurteshi, Faleminderit për pyetjen edhe pse ju bëtë përpjekje me dhënë edhe përgjigjen. Fillimisht, aktivitetet jashtë mësimore janë të rregulluara në Ministrinë e Arsimit me udhëzimin administrativ për aktivitete të jashtë mësimore.

Bëhet fjalë për dy aktivitete jashtë mësimore: mbrëmjet e maturës dhe ekskursionet. Çdo aktivitet tjetër që merret në shkollë është i paligjshëm dhe nuk mund të bëhet pa lejen e drejtorisë komunale të arsimit dhe të Ministrisë së Arsimit. Tek mbrëmjet e maturës dispozitat e udhëzimit janë shumë të qarta, ky është një aktivitet që duhet të fillojë të përgatitet 7 ditë para se të mbahet dhe duhet të arrihet marrëveshja me këshillin e prindërve, me nxënësit, me shkollën në mënyrë që mbrëmja e maturës të jetë një aktivitet tipik shkollor.

Udhëzimi plotësisht ndalon përdorimin e pijeve alkoolike dhe substancave narkotike, si dhe përdorimin e cilido mjet të rrezikshëm për ambientin dhe për nxënësit. Sa u përket ekskursioneve udhëzimi administrativ parasheh dy terminë kur mund nxënësit të shfrytëzojnë ekskursionet, pra maturantët është fillimi i vitit shkollor muaji shtator dhe tetor, apo fundi i vitit të shkollor pra muaji maj dhe qershor dhe çështja e ekskursioneve është e rregulluar mirë, sepse përgjegjësinë për një ekskursion e merr shkolla, drejtori i shkollës, këshilli i prindërve dhe drejtoria komunale e arsimit.

Me rastin e vendosjes për cilindo ekskursion secili prind duhet ta marrë përgjegjësinë për orarin e ekskursionit, në çdo ekskursion duhet të shkojë drejtori i shkollës dhe kujdestarët e klasës dhe është e detyrueshme që në çdo ekskursion të ketë përfaqësues të këshillit të prindërve. Është e vërtetë që në ekskursionë ka nganjëherë edhe abuzime, ka nganjëherë edhe shmangie nga agjenda, por këto janë çështje që duhet të adresohen tek drejtori i shkollës, sepse Ministria e Arsimit po ndërton një sistem të vlerësimit të performancës së drejtorëve të shkollës dhe brenda performancës është edhe kjo komponentë. Sa drejtorë të shkollës janë nikoqirë të mirë, sa ata administrojnë mirë me nxënësit, sa ata menaxhojnë mirë edhe proceset jashtë mësimore.

Pra, nuk na duhet vetëm një drejtor që merr përgjegjësinë për shkollën, por edhe një drejtor që merr përgjegjësitë për nxënësit kur nuk janë brenda shkollës. Kështu që kjo materie është relativisht mirë e rregulluar, është e vërtetë se drejtoritë komunale nganjëherë bëjnë probleme sa i përket përzgjedhjes së kompanive ajo nuk është kompetencë e ministrisë për të ndryshuar në këto çështje, por si materie ligjore ministria e ka rregulluar mirë me këtë udhëzim administrativ.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Pyetje shtesë, zoti Kurteshi?

**ISMAJL KURTESHI:** Po, zoti ministër, si në çdo fushë të jetës në këtë shtet praktika dhe teoria janë në disproporcion shumë të madh.

Krejt këto që i shpjeguat shumë faleminderit dhe besoni se të gjitha i di, dhe po ashtu e di çka po ndodh në praktikë që besoj që nuk jeni edhe ju të painformuar në këtë drejtim. Kjo që është e përshkruar në praktikë kur shkohet në Shqipëri pothuajse 99% nuk zbatohen dhe veprime jashtëzakonisht të dëmshme atje ndodhin edhe në pyetjet tjera që kam fol për rastet abuzive, ministër përherë më keni drejtuar te drejtoritë e shkollave, te drejtoritë komunale, ju po pritni që ne si deputetë të shkojmë atje të intervenojmë dhe disi ministrinë po e amnistoni nga këto çështje.

Ministria është organi më i lartë i fushës, prandaj është detyrë e juaja që në të gjitha raste ju të veproni mos më tregoni mua ose deputetëve tjerë se kujt duhet t'i drejtohem se nuk është as detyrë e jona, as kompetencë që t'u drejtohem drejtorive. Prandaj, ndërmerri diçka ju drejtpërdrejt.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti ministër!

**MINISTRI ARSIM BAJRAMI:** I nderuari deputet, Ministria është përgjegjëse në bazë të ligjit për krijimin e politikave publike në tërë sektorin e arsimit, duke përfshirë edhe kopshtet dhe unë thash që ne e kemi kryer me këtë udhëzim dhe mund të bëjmë inspektive sipas kërkesave.

Ju vetë keni qenë drejtor i arsimit në komunë, ju lutem na tregoni sa raste ju keni ndërhyrë në këto ekskursione, në sa raste ju keni penalizuar drejtorët në ekskursione, në sa raste ju keni kërkuar llogaridhënie për nxënësit, sepse ju e dini shumë mirë se përgjegjësia për ekskursione nuk është e ministrit, por është e drejtorit të arsimit duke qenë se vetë keni qenë drejtor për një kohë të gjatë do të ishte mirë me shifra konkrete të na tregoni se në sa ekskursione apo mbrëmje të maturës keni kërkuar përgjegjësi prej drejtorëve apo nxënësve për shkelje të udhëzimit administrativ, të cilin e ka sjellë ministria.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Jo, s'ka nevojë. Zonja Izmaqu, pyetje për ministrin Imet Rrahmani.

**XHEVAHIRE IZMAKU:** Faleminderit, kryesues!

Edhe pse nuk është ministri unë do ta shfrytëzoj rastin që të flas, sepse është çështje sensibilizimi. Pyetja ime ka të bëjë me çështjen që ne viteve të fundit, pra kemi një perceptim apo kemi një mendim se është shtuar numri i madh i femrave me diagnozë të kancerit në mitër dhe në gji dhe këto ditë kam pasur rastin të marrë një informacion të rëndësishëm së paku për

mua që s'jam pjesë e këtij dikasteri një përvojë gjermane dhe norvegjeze ku vajzat e reja në adoleshencën e parë marrin pra një vaksinë e cila është preventivë për jetën e tyre në të ardhmen ndaj rrezikut të kancerit në mitër dhe në gji.

Pra, Norvegjia e paska si aktivitet të planifikuar që nxënëset t'i marrin vaksinat në tri pjesë në një periudhë 1-vjeçare, po ashtu kjo bëhet gjatë procesit mësimor, ndërsa Gjermania e ka të organizuar me iniciativë vullnetare. Pyetja ime ka qenë kjo: A do të ketë mundësi që shteti ynë në vend të shërimit të bëjë një preventiv, pra të kemi një fond i cili do të sigurojë një të tillë vaksine që për mua ishte informacion shumë i ri dhe të mos merremi pastaj aq shumë me shërimin dhe në këto raste të kemi preventiv. Këtë pyetje do ta pres që të ketë përgjigje dhe do ta shtroj përsëri. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Deputetja Albulena Haxhiu, pyetje për ministrin Kuçi.

**ALBULENA HAXHIU:** Faleminderit!

Edhe ministri Kuçi, u bë kohë e gjatë që nuk po vjen në seancën plenare, sidomos në kohën e pyetjeve parlamentare. Nuk e di se a po e dinë këta ministra që kanë përgjegjësi kushtetuese që të përgjigjen para deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Megjithatë, unë po e parashtroj pyetjen. Shpresoj që të kem përgjigje në seancën e ardhshme.

Më 18 qershor, në Kuvendin e Republikës së Kosovës, u votua raporti me rekomandime, që doli pas monitorimit të Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale të bërë nga Komisioni për Legjislacion.

Të paktën shtatë nga rekomandimet e atij raporti bien në fushëveprimtarinë e Ministrisë së Drejtësisë dhe duke marrë parasysh që ato rekomandime kanë qenë shumë të rëndësishme për të burgosurit, sepse për vite me radhë ministri i Drejtësisë i ka mashtruar që do ta sjellë në Kuvend Projektligjin për amnisti, ende nuk jemi në dijeni nëse Ministria e Drejtësisë ka ndërmarrë ndonjë veprim, sa u përket këtyre rekomandimeve.

Pra, pyetja parlamentare është nëse ka filluar Ministria e Drejtësisë të ndërmarrë ndonjë veprim për zbatimin e atyre rekomandimeve dhe, nëse po, çfarë saktësisht? Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Deputeti Ilir Deda, pyetje për zëvendëskryeministrin Hashim Thaçi.

**ILIR DEDA:** Faleminderit!

Para dy javësh ministri i Punëve të Jashtme ka deklaruar, që Kosova ka aplikuar për anëtarësim në UNESKO. Një javë më vonë, rrjedhimisht javën e kaluar, UNESKO thotë - ne nuk e kemi marrë aplikacionin nga Kosova.

Është praktikë ndërkombëtare që aplikacionin e shtetit në organizata universale ndërkombëtare e bën presidenti i shtetit. Ka pasur shumë raporte në medie të ndryshme dhe unë do ta filloj me pyetjen më të thjeshtë, kush e ka nënshkruar aplikimin e Republikës së Kosovës në UNESKO?

**KRYESUESI:** Zoti zëvendëskryeministër Hashim Thaçi e keni fjalën.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Një nga prioritetet kryesore të Qeverisë së Kosovës për këtë vit, është anëtarësimi i Kosovës si shtet në organizata të ndryshme regjionale, evropiane dhe ato ndërkombëtare dhe në kuadër të kësaj është edhe përkushtimi dhe zotimi ynë që të anëtarësohemi sa më shpejt në UNESKO, si një organizatë që do të mund të hapë perspektivë edhe për anëtarësimin në shumë organizata tjera të OKB-së. Prandaj, mendoj që është një situatë e përshtatshme dhe një rrethanë e përshtatshme për Kosovën që të aplikojë dhe të anëtarësohet.

Natyrisht, se është bërë një lobim i fuqishëm nga ana e Kosovës, së bashku me miq dhe partnerë ndërkombëtarë dhe të njëjtën kohë, jemi dëshmitarë edhe të reaguesve shqetësues të Qeverisë së Serbisë, por ajo që është shumë me rëndësi, mund të konfirmoj se tërë procesi është duke shkuar në një rrethanë të favorshme për anëtarësimin e Kosovës në UNESKO dhe mendoj se përfitimet do të jenë të shumanshme për shtetin tonë. Ndërsa, natyrisht se këtë proces e ka udhëhequr Ministria e Jashtme, me mbështetje të plotë dhe koordinim të plotë edhe me kryeministrin, Qeverinë e Kosovës, Presidencën dhe të gjitha institucionet e vendit, Parlamentin, Komisionin për Politikë të Jashtme, të gjithë mekanizmat e shtetit të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ke pyetje shtesë, zoti Deda?

ILIR DEDA: Po, po, faleminderit!

Zoti ministër, ju vazhdoni me përgjigjet e juaja, unë vazhdoj me pyetjet e mija.

A ka të bëjë konflikti juaj me Presidencën për shkak të aplikimit nëpërmjet UNMIK-ut dhe në UNESKO dhe, rrjedhimisht si e shpjegoni ju që aplikacioni i Kosovës në UNESKO nëpërmjet UNMIK-ut, sa është në përputhje ky lloj aplikacioni me deklaratat e juaja disavjeçare në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, se UNMIK-u është mision i tejkualuar dhe se nuk ka më vend në Kosovë?

KRYESUESI: Urdhëro, zoti zëvendëskryeministër Hashim Thaçi.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI THAÇI: E para, zoti Deda, nuk duhet harruar se edhe në Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës, që e kemi shpallur si shtet të pavarur dhe sovran, e kemi Rezolutën 1244 edhe dokumentin e presidentit Ahtisaari. Prandaj, edhe kërkesa për anëtarësim në UNESKO është bërë plotësisht në përputhshmëri me Kushtetutën e Kosovës, me ligjet e Kosovës dhe përputhshmëri edhe me prezencën e mekanizmave ndërkombëtare në Kosovë.

Por, unë të kisha ftuar që të koncentrohesh më shumë në mbështetje për anëtarësim të Kosovës, se sa të humbësh kohë në aspektet procedurale. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Mytaher Haskuka, pyetje për ministrin Abdullah Hoti.

MYTAHER HASKUKA: Sipas ligjit nr. 03/L-179 për Kryqin e Kuq të Republikës së Kosovës, sipas nenit 14, burimet financiare, pika 1, po citoj Ligjin për realizimin e detyrave dhe obligimeve të përcaktuara me këtë ligj: Kryqi i Kuq i Kosovës siguron mjete financiare nga, ndër të tjera thotë, pika 1.7 sigurimi i obligueshëm i automjeteve 1% nga bruto-primi i vlerës së sigurimit të automjetit. Cilat janë veprimet që i ka ndërmarrë Qeveria për vënien në zbatim të

kësaj dispozite, duke ditur se kompanitë e sigurimit që pesë vjet nuk i kryejnë obligimet e tyre ndaj Kryqit të Kuq të Kosovës, nga ministri i Financave?

KRYESUESI: Zoti ministër Hoti, e keni fjalën.

MINISTRI ABDULLAH HOTI: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

I nderuar deputet,

Po ju informoj fillimisht se kjo është jashtë fushës së Ministrisë së Financave dhe komplet e Qeverisë, është Banka Qendrore ajo që rregullon dhe mbikëqyrë funksionimin e kompanive të sigurimeve. Unë jam konsultuar në dy ditët e fundit për këtë çështje dhe informatat që kam marrë prej Bankës Qendrore janë këto, që me primin që Banka Qendrore u lejon kompanive të sigurimit përfshihet tatimi që është 5%, është 1,5% që i shkon Bankës Qendrore për mbikëqyrje të kompanive të sigurimeve, janë rezervat për dëme, që u lejon Banka Qendrore këtyre kompanive, është kostoja që kanë kompanitë e sigurimeve për punëtorë dhe kosto të tjera dhe është profiti i lejuar i kompanive të sigurimeve. Normalisht, mbi këtë shtohet edhe TVSH-ja. Kjo është struktura e primit që BQK-ja u lejon kompanive të sigurimit, të cilën e ka aprovuar, varësisht prej kërkesave që kanë bërë kompanitë e sigurimit në dy vjetët e fundit.

Prandaj, unë ju ftoj, me gjithë këto shpjegime jo të plota, që drejtorin në Bankën Qendrore ose në komisionet përkatëse të Kuvendit të ftoni Bankën Qendrore, që t'u raportojë se çka po ndodh me aplikimin në praktikë të këtij ligji. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! A ke pyetje shtesë, zoti Haskuka?

MYTAHER HASKUKA: Faleminderit! Por, unë e di që kjo është diçka ndërministrore, por edhe Qeveria duhet të jetë ndërministrore. Ju duhet të flisni ndërmjet, pasi që Ministria e Shëndetësisë është mbikëqyrëse e këtij ligji për implementim, por në të njëjtën kohë edhe me Ligjin mbi BQK-në, neni nr. 32 thotë, që Ministria ka të drejtë të kërkojë nga BQK-ja përshkrimin e rrjedhave financiare dhe në atë aspekt, domethënë duhet, besoj që edhe Ministria e Financave duhet të kërkojë që BQK-ja, faktikisht t'i kushtëzojë kompanitë e sigurimeve, që të implementojnë ligjin, apo të ndajnë 1% të bruto- primit për sigurimin e automjeteve. Përndryshe, gjendja e Kryqit të Kuq të Kosovës është alarmante, domethënë, në 26 komuna ata kanë probleme t' i paguajnë 65 punëtorë që i kanë. Kryqi i Kuq i Kosovës ka bërë një punë të mirë në këto vitet e kaluara, duke u ndihmuar skamnorëve dhe besoj që është e drejtë e tyre, që të implementohet ligji. Normalisht, unë do të kërkoj edhe në aspektet tjera, por besoj që edhe roli i Qeverisë këtu, duhet të jetë më i madh.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Aida Dërguti, pyetje për ministrin Lutfi Zharku.

AIDA DËRGUTI: Faleminderit, kryesues!

Kam pasur pyetje edhe në seancën e kaluar e që ka të bëjë me të njëjtën çështje, pra me aksin rrugor të magjistrales Prishtinë – Mitrovicë.

Herën e kaluar i kam përmendur dy nga çështjet, të cilat janë preokupim i qytetarëve të asaj zone, konkretisht të fshatit Lumëmadh dhe Stanoc, ndërkohë që çështje tjetër që i preokupon banorët e kësaj pjese është hyrja- dalja, e cila aktualisht është e paraparë vetëm për dy familje,

konkretisht familjen Hasani dhe Cakaj, dhe për banorët tjerë të këtyre fshatrave, hyrja e dalja u është mundësuar vetëm në distancë prej tre kilometrash prej fshatrave ku ata banojnë.

Banorëve të fshatit Lumëmadh u është dhënë një premtim, se do t'u mundësohet hyrja-dalja në afërsi të fshatit, ndërkohë që në fshatin Stanoc, konkretisht lagja e Gumnishtave, Shalajve dhe Brahimajve, si dhe disa shtëpi tjera të këtij fshati, të cilët kanë nevojë që të kenë qasje më të shpejtë, më të afërt dhe një hyrje-dalje në rrugën magjistrale, domethënë, nuk u është dhënë ndonjë premtim.

Ndërkohë që ne po flasim, inspektorët tuaj kanë qenë sot atje dhe qytetarët e asaj pjese po kërkojnë që të marrin nga ju përgjigje, se cilat do të jenë zgjidhjet për çështje që ata i kanë kërkuar lidhur me këtë rrugë, domethënë, që ka të bëjë me Stacionin e Autobusëve, nënkalimin, që i kam përmendur në seancën e kaluar dhe çështja që ka të bëjë me pyetjen time konkrete, është hyrja-dalja për banorët e këtyre fshatrave.

**KRYESUESI:** Faleminderit! E ka fjalën ministri Lutfi Zharku.

**MINISTRI LUTFI ZHARKU:** I nderuar nënkryetar!

Zoti kryeministër,

Zëvendëskryeministër,

Ministra,

Të nderuar deputetë,

Deputete Dërguti,

Unë do të mundohem të përgjigjem sipas pyetjes që ma keni bërë, jo ato që i thatë.

Ministria e Infrastrukturës në vitin në vitin 2009, ka kontraktuar kompaninë projektuese A-design- Prishtinë, për hartimin e projektit kryesor për zgjerimin e rrugës nacionale M-2 pjesa Milloshevë – Vushtrri në gjatësi prej 20 km.

Projekti ka përfunduar në vitin 2011 dhe vlera e kontratës ka qenë 290371 euro, projekti është realizuar në bazë të detyrës projektuese, kriterëve teknike dhe shpejtësisë së caktuar projektuese, elementet teknike të rrugës dhe traseja janë përgatitur dhe arsyetuar nga ana e kompanisë projektuese, ndërsa ekipi profesional i Ministrisë së Infrastrukturës, vetëm i ka aprovuar ato.

Kontraktuesi sipas detyrës projektuese lidhur me shtrirjen e trasesë ka pasur këto obligime: zgjerimi i rrugës kryesisht është bërë në dy anët e rrugës ekzistuese, ndërsa pjesa Vushtrri e Vushtrrisë, të punohet si trase e re. Gjatë të gjitha fazave të projektimit janë marrë parasysh edhe kërkesat e komunitetit, duke i përfshirë ato në projektin zbatues, varësisht nga mundësitë teknike, në mënyrë që të mos dëmtohet projekti apo dëmtohet kualiteti i projektit.

Më lejoni, që edhe njëherë të theksoj se projekti tanimë është në përfundim e sipër dhe në këtë fazë nuk mund të bëhen kurrfarë ndryshimesh të fundit, por ju siguroj, se pas përfundimit të projektit do t'i adresojmë të gjitha brengat e qytetarëve për atë pjesë.

Drejtimin e seancës e merr kryetari i Kuvendit, zoti Kadri Veseli.

KRYETARI: Aidë, urdhëro!

AIDA DËRGUTI: Zoti ministër,

Është më e lehtë tash derisa ende nuk ka përfunduar, të bëhen këto ndryshime të vogla, se sa të rihapen edhe njëherë punë prej fillimit, ndërkohë që po ju informoj që qytetarët e asaj zone, me një peticion prej mbi 800 nënshkrimesh, tashmë kanë dorëzuar edhe një padi në Gjykatën Themelore lidhur me këtë çështje.

KRYETARI: Ministër, adëshironi ende?

MINISTRI LUTFI ZHARKU: Zonja deputete,

Në parim, për shkak të kufizimeve ligjore, nuk mund të hyjmë në këtë fazë në revidim të projektit, për shkak se projekti tanimë është përfunduar, kurse çdo ndryshim i projektit kap kosto 3, e cila nuk mund të arsyetohet.

Për atë që e thashë jam shumë i interesuar, që gjithë ato brenga të tyre t'i adresojmë me projekte shtesë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë e kemi përfunduar edhe këtë pikë të rendit të ditës. Urdhëro, Valon. Ka edhe diçka shtesë ministri i Diasporës.

MINISTRI VALON MURATI: Të nderuar deputetë,

Pak më parë u lajmërova që si Policia ashtu Zyra e Kryeministrit dhe unë si ministër i Diasporës, i kemi dërguar letër Byrosë Kosovare të Sigurimit për çështjen e punëtorëve shtesë dhe sapo mora përgjigje që ata në bashkëpunim me Bankën Qendrore të Kosovës, i kanë shtuar edhe 15 punëtorë nëpër tre pikat që janë të Vërmicës, të Dheut të Bardhë dhe të Mërdarës, për shkak se e diskutuam bashkërisht, ato kanë krijuar radhë të gjata të bashkatdhetarëve që kanë pritur.

Gjithsesi, janë çështje të organizimit të brendshëm, që besoj se duhet të trajtohen edhe me Ligjin e ri për sigurime, që ndoshta duhet të trajtohet brenda Kuvendit dhe të cilën deputeti Osmani e ka përmendur disa herë, çështja e Byrosë Kosovare të Sigurimit. Ata kanë pasur një problem të brendshëm, që nuk kanë mundur deri tash, për shkak se nuk është aprovuar përmes Asamblesë së Përgjithshme shtimi i punëtorëve shtesë dhe Këshillit Organizativ, po me ndërhyrjen dhe bashkëpunimin e Bankës Qendrore, janë shtuar këta punëtorë.

Kjo ishte vetëm sa për ta plotësuar atë diskutim që e bëmë më herët dhe përgjigjen që e kemi marrë nga ky institucion.

KRYETARI: Faleminderit! Urdhëro, profesor!

MUHAMET MUSTAFA: Për rend dite unë e kam.

KRYETARI: Tash do të kalojmë rend dite.

Bazuar në nenin 44, pika 2 lidhur me plotësimin e rendit të ditës të seancës, kemi pranuar propozimin me shkrim nga kryetari i Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe

Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe nga kryetari i Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti e Industri, që në rend dite të seancës së sotme të përfshihen edhe këto pika.

Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për letërnjoftimin;

Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-029 për patenta; dhe

Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-026 për markat tregtare.

Kërkohej deklarimi formal, me ngritje dore, për aprovimin e këtyre kërkesave. A po e ngremë dorën për t'i futur sot në rend dite? Nait, më fal, profesori Muhamet e ka tërhequr, Nait, urdhëro.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për Kabinetin!

Kemi dy kërkesa nga Komisioni për Arsim. Kërkesa e parë është Rekomandimi lidhur me vendimin e Qeverisë për emërimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Shkencës që të hyjë pikë e rendit të ditës dhe kemi Ligjin për kinematografinë, po ashtu që të hyjë në rend të ditës.

Komisioni ka shqyrtuar dhe kërkojmë që në parim t'i kalojmë, që të kemi hapësirë kohore pastaj për amendamente. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit Nait! Do të votojmë pastaj këto tri propozime. Propozimin tënd veçantë. Shkojmë më tutje. Xhevahire Izmaku, po ashtu për rend dite, ka kërkuar fjalën. Pastaj, kemi ende.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryetar!

Unë e kam çështjen e kërkesës, nëse është e mundur, që votimi për Bordin e Radiotelevizionit të Kosovës, të jetë pak më herët, për arsye se shumë herë e kemi parë që votimet në orët e vonshme të pasdites po ka mungesë të deputetëve. Dhe, në këtë drejtim kemi nevojë që të kemi një numër të caktuar të deputetëve. Nëse është e mundur që të vihet, qoftë para debatit, apo të jetë diku... jo në pasditen e vonshme, domethënë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Albulena Haxhiu, po ashtu ka kërkuar fjalën për rend dite.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Unë po ndalem vetëm te një propozim, ka të bëjë me Projektligjin për markat tregtare.

Dje, Komisioni për Legjislacion, në rend dite ka pasur vetëm Projektligjin për patenta dhe në këtë drejtim, ne e kemi shqyrtuar si Komision i kemi dhënë përkrahje, mirëpo nuk e kemi pasur në rendin e ditës Projektligjin për markat tregtare, kjo ndoshta, për shkak të ndonjë problemi që ka qenë në administratë, jo te komisionet përkatëse.

Ndonëse, kam propozuar si kryetare e Komisionit, që të futet si pikë e rendit të ditës, kjo nuk është përkrahur, pra kanë qenë katër vota për, katër kundër dhe sipas Rregullores propozimi nuk ka kaluar, që të futet kjo pikë në rendin e ditës. Sot kam diskutuar pak me anëtarët e Komisionit për Legjislacionin, ata janë dakord që të futet në rend dite, mirëpo proceduralisht nuk e di sa është e mundshme që pa e votuar Komisioni për Legjislacionin, këtë raport të futet si pikë në rendin e ditës. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Ismail Kurteshi e ka fjalën.

**ISMAIL KURTESHI:** Po, faleminderit!

Raporti i punës për vitin 2014 për Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturor ka ardhur në Komisionin për Arsim dhe Kulturë, që në fillim të vitit. Por, para se ky komision ta shqyrtojë raportin nga administrata e Kuvendit të Kosovës, Komisionit i ka ardhur një shkresë, me të cilën administrata kërkon që Komisioni, të mos e shqyrtojë raportin, por atë ta trajtojë si raport njoftues, ndërsa pas kompletimit të bordit, të japë mendimin e saj.

Këtë ndërhyrje të administratës në punët e Komisionit e konsideroj si tejkalim të skajshëm të kompetencave të administratës. Përkundër kërkesës së administratës, Komisioni ka shqyrtuar raportin, por natyrisht me vonesë dhe ia ka përcjell Kryesisë së Kuvendit, që ta fusë në rend dite për shqyrtim në seancën e Kuvendit.

Siç po shihet, ky raport nuk është paraparë të futet në rend të ditës, edhe pse seanca e sotme nuk është shumë e ngarkuar. Prandaj, kërkoj nga kryetari i Kuvendit, që t'ua mundësojë deputetëve të deklarohen në lidhje me propozimin, që në rend të ditës së seancës së sotme të shqyrtohet edhe raporti i Këshillit të Kosovës për Trashëgiminë Kulturorë, i cili po zvarritet gjatë koluareve të Kuvendit e në Komisionin për Arsim e Kulturë, nuk e ka marrë përkrahjen e asnjë anëtar. Faleminderit!

**KRYETARI:** Profesori Muhamet Mustafa e ka fjalën.

**MUHAMET MUSTAFA:** Unë e kuptoj arsyetimin që e dha kolegja Albulena Haxhiu. Natyrisht, që ne këto dy ligje i kemi trajtuar gjithmonë bashkë, sepse janë materie të ngjashme dhe amendamentet që janë lidhur me këto dy ligje janë thujse të ngjashme. Arsyeja pse ne kemi kërkuar që të hyjnë në rend dite, është për arsye se këto lidhen me agjendën e integriteteve evropiane dhe stabilizim- asociimit dhe shtyrja e këtyre për vjeshtë na është dukur e paarsyeshme, aq më par kur kemi pak amendamente dhe jo aq shumë probleme përmbajtësore me ato amendamente.

Kështu që, në qoftë se është problem që patjetër duhet të ekzistojë një raport i Komisionit, unë e kisha lutur Komisionin për Legjislacionin, që eventualisht gjatë pauzës të tubohet dhe ta formulojë edhe një mendim për këtë ligj, ose të konsultohen dhe ta formulojnë një mendim për këtë ligj, por ju kisha lutur që këto dy ligje, pra edhe Ligji për patenta edhe Ligji për marka tregtare, mundësisht të jenë në agjendë.

**KRYETARI:** Atëherë, e kemi një situatë për pika të reja të rendit të ditës, unë do të shkoj një nga një, më mirë. Shkojmë me votim formal tuajin. Vetëm kush është kundër, ne e konfirmojmë

praninë njëherë, se a kemi kuorum dhe sa e kemi numrin e deputetëve në sallë. Janë 69 deputetë në sallë. Unë do të mundohem këtu çka i kam të shkruara t' i lexoj. Do të shkojmë një nga një për çdo pikë të rendit të ditës a e fusim për sot. Ato që i kanë propozuar deputetët, ku kam nevojë për ndihmë pastaj i referohem deputetit.

Kërkohet deklarimi formal me ngritje dore, për aprovimin e këtyre kërkesave. Unë do të shkoj vetëm kush është kundër. Në qoftë se, janë më pak kundër, atëherë aprovohet. 69 deputetë janë në sallë.

Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për letërnjoftimin, a ka dikush kundër, a e fusim sot? Atëherë, futet sot si pikë e rendit të ditës, e shohim, me numër nuk po e thërras.

Jemi në pikën tjetër - Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-029 për patenta. A ka kundër? S'ka kundër. Edhe kjo futet pikë e rendit të ditës.

Jemi në pikën e tretë të rendit të ditës, ku Komisioni ka qenë, sipas Albulenës, 4 = 4. Urdhëro, Albulenë, para se ta vë në votim.

ALBULENA HAXHIU: Atëherë, me një dakordim edhe të anëtarëve të Komisionit për Legjislacion, ne do të mblidhemi gjatë pauzës dhe do ta shqyrtojmë raportin e Projektligjit për marka tregtare. Domethënë, i bie që seanca le ta votojë për t'u futur në rend dite dhe më pas Komisioni i shqyrton amendamentet.

KRYETARI: Atëherë, unë po e fus në procedurë, ju gjatë pauzës pastaj si Komision funksional, e rregulloni.

Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-026 për markat tregtare. Kush është kundër? Atëherë, aprovohet. E fusim pikë të rendit të ditës, presim edhe rekomandimet e Komisionit, pas pauzës.

Propozimin e Naitit e dëgjoni, pastaj e fusim në votim formal.

NAIT HASANI: Zoti kryetar, Komisioni ka mbajtur mbledhje dhe ka kërkuar që në pikë të rendit të ditës sot të futet vendimi i Qeverisë për anëtarët e Këshillit Kombëtar për Shkencë, prandaj ne kemi marrë qëndrimin dhe kërkojmë sot të futet si pikë e rendit të ditës.

KRYETARI: Nait, në qoftë se e fusim si rekomandim, atëherë Kuvendi e kryen punën, se e kemi... i rekomandohet Kuvendit që të mos bëjë emërimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Shkencës ta marrë këtë vendim për të hyrë si pikë e rendit të ditës. Atëherë, e përkrahim propozimin e Naitit që të futet në pikë të rendit të ditës ky rekomandim.

A ka kundër? Salih, nëse ke diçka, urdhëro.

SALIH MORINA: Faleminderit, kryetar!

Është e vërtet që dje në Komision, anëtarët e Komisionit për Arsim e kemi diskutuar këtë çështje, mirëpo ne kemi kërkuar që ministri i Arsimit, zoti Bajrami të jetë këtu i pranishëm dhe të na interpretojë çështjen e ligjit.

E meqë ministri nuk është dhe nuk e di a është njoftuar, unë kërkoj që kjo pikë të shtyhet për një mbledhje tjetër dhe të vjen si pikë e rendit të ditës dhe të diskutohet bashkërisht edhe një herë, me ministrin në këtë rast, sepse këtë emërim të këtij vendimi e ka bërë ministri dhe është e nënshkruar nga kryeministri. Prandaj, mendoj se duhen edhe disa sqarime rreth kësaj pike, kështu që e lëmë për seancën e radhës. Faleminderit!

**KRYETARI:** I kemi dy propozime. Nait, votojmë për propozimin tënd, në bazë të procedurave e pastaj edhe për propozimin e Salihut. Propozimet janë shumë të qarta.

Kush është kundër propozimit të Naitit, në rend të parë, për të futur rekomandimin si pikë të rendit të ditës.

Lus sekretarinë, t'i numërojë votat.

A ka abstenim? Janë tri abstenime.

Kush është për rekomandimin e Naitit?  
Krejt opozita është me Naitin.

Pra, ta kemi edhe përfundimin e votimit, për, kundër dhe abstenim.  
15 janë kundër, 49 për dhe 3 abstenime.

Votojmë për propozimin e Salih Morinës, tash. Salih, urdhëro!

**SALIH MORINA:** Faleminderit, kryetar!

Meqë edhe ministri ka ardhur këtu, do të ishte mirë të na sqarojë lidhur me këtë vendim dhe të marrim një informatë pak më të saktë dhe të shkohet më tutje.

**KRYETARI:** Salih, a ka mundësi t'i sqarohet ministrit, se nuk ishte i pranishëm?

**SALIH MORINA:** Ministër, të lutem nëse ka mundësi të na sqarosh për anëtarët të Këshillit Kombëtar të Shkencës, sepse dje në Komisionin për Arsim, ka pasur disa vërejtje, sepse nuk është në përputhshmëri me ligjin, kështu që do të ishte mirë ta procedoni rekomandimin dhe ta na njoftoni se a është në rregull në bazë të Ligjit për shkencën, vendimi që e keni marrë ju për anëtarët e këtij Këshilli. Prandaj, do të ishte mirë nga ju që të na sqaroni dhe pastaj të vazhdohet më tutje, sepse i kemi dy opsione, në këtë rast.

**KRYETARI:** Salih, këta po më thonë që në bazë të procedurës është votuar, dhe është futur si pikë e rendit të ditës. Ministër, për korrektësi, bëje sqarimin, edhe pse është futur në rend të ditës propozimi i Naitit.

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: Pra, vendimi për themelimin e Këshillit Kombëtar të Shkencës, është miratuar në Qeveri dhe Kuvendi vetëm e ratifikon. Ky është një vendim i cili i ka respektuar plotësisht procedurat ligjore të emërimit. Është një vendim që qe dy-tri vjet është vonuar në Kuvend.

Ministria është e gatshme në çdo kohë kur Komisioni parlamentar për Arsim kërkon sqarime shtesë, të shkojë e t'i sqarojë këto çështje. Pra, jemi të interesuar që kjo çështje të ketë sukses, sepse ka 3 vjet që ky organ i rëndësishëm nuk është bërë funksional.

Prandaj, unë e lus Komisionin që në qoftë se kanë nevojë për sqarime shtesë apo kanë dilema për procedura, le të thërrasin Ministrinë apo përfaqësuesit e Ministrisë që t'i zgjedhin, në mënyrë që kur të vjen në Kuvend, të miratohet.

Dëshiroj të jap edhe një sqarim, kompetencat e Kuvendit këtu janë pak të limituara, pra ai nuk mund të ndërrojë përbërjen. Mund të rikthejë çështjen përsëri në Ministri, por do të ishte mirë, për shkak të komunikimit zyrtar, që Ministrisë t'i jepet mundësia brenda Komisionit dhe t'i sqarojë dilemat që mund t'i kenë anëtarët e Komisionit.

Përzgjedhja e anëtarëve të Komisionit është bërë vetëm me kritere profesionale, me kritere të performancës shkencore dhe ne jemi të gatshëm për të ofruar arsyttime për secilin kandidat që kërkohet.

KRYETARI: Faleminderit! Jo. E kryem një herë dhe të mos votojmë prapë. Kërkoj falje në qoftë se ju kam futur në konfuzion. Shkojmë më tutje. Naiti dhe Smajli e kanë edhe nga një propozim. Po vazhdojmë me Naitin, se ai e ka edhe propozim-rekomandimin. Nait, na qartëso lidhur me Projektligjin për kinematografinë.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Komisionit i ka ardhur Projektligji për kinematografinë të cilin e ka shqyrtuar dhe në parim i ka kërkuar seancës ta miratojë. Prandaj, nëse e kemi një seancë më vonë, apo deri në shtator, neve na kërkohet që të kemi mundësinë të punojmë në këtë projektligj dhe kërkojmë që të kalojë si pikë e rendit të ditës, dhe në parim ta miratojmë. Faleminderit!

KRYETARI: Atëherë, prapë e vëmë në votim propozimin e Nait Hasanit. Është një rekomandim që të miratohet në parim Projektligji për kinematografinë dhe të futet si pikë e rendit të ditës.

Kush është kundër? Administrata, i numëroni votat.

Kush abstenon?

Kush është për?

79 ishin të pranishëm në sallë, shumica ishte për, vetëm 3 kundër.

Konstatohet se u aprovua me shumicë.

Tani është propozimi i Ismajl Kurteshit, për ta futur në rend të ditës raportin e Komisionit për Trashëgimi Kulturorë.

Nuk është shqyrtuar nga Komisioni për Buxhet.

Ismajl, a po e qartëson edhe një herë, për deputetët?

ISMAJL KURTESHI: Unë thashë se raporti i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, i cili ka ardhur në fillim të vitit, është shqyrtuar me vonesë në Komision dhe nuk ka hyrë në rend të ditës në Kuvend. Pra, kërkoj që kjo të futet në rendin e ditës së Kuvendit dhe ta shqyrtojë këtë raport, i cili nuk e ka marrë mbështetjen e Komisionit.

Unë nuk e di arsyen pse, por e di që kjo çështje është shtyrë vazhdimisht, pa dhënë ndonjë arsye pse po zvarritet kjo çështje. Faleminderit!

KRYETARI: Ismajl, i kemi dy mundësi. Kriteret nuk i plotëson të futet sot, me një përjashtim në qoftë se Komisioni funksional për Buxhet, na e sjell ndonjë rekomandim në pauzë, atëherë e fusim. Por, Komisioni është duke reaguar, atje dhe po thotë- jo për sot.

Pra, do ta lëmë për seancën e ardhës. Urdhëro, Ismajl.

ISMAJL KURTESHI: Ky është raport për vitin 2014 dhe nuk ka implikime buxhetore. Këtë ne vetëm do ta dëgjojmë se çka kanë punuar ata në vitin 2014. Çka ka këtu Komisioni për Buxhet të ndërhyjë, apo nëse e ka vetëm ndonjë qëllim, për ta shtyrë.

KRYETARI: Shpejtim Bulliqi e ka kërkuar fjalën.

SHPEJTIM BULLIQI: Faleminderit, kryetar!

Shikoni, unë mendoj se ky raport është mirë të vijë si pikë e veçantë e rendit të ditës, por po mendoj jo në këtë seancë të sotme, por po e lëmë për seancën e ardhshme, meqë ne në Komision e kemi shqyrtuar dhe asnjë s'e kemi përkrahur. Dhe, meqë do të diskutohet bukur gjatë dhe u bë një numër relativisht i madh i pikave të rendit të ditës, unë mendoj që në seancën e ardhshme është mirë ta shtimë si pikë të veçantë në rendin e ditës. Faleminderit, kryetar!

KRYETARI: Bekim, a ke diçka të shtosh?

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Pothuaj se atë çka pata të them e tha edhe deputeti Bulliqi. Me gjithë respektin dhe propozimin e deputetit Kurteshi, mendoj se ky raport do ta donte një diskutim më detal të deputetëve dhe një përgatitje më të mirë për diskutim, sepse kemi të bëjmë me një punë shumëvjeçare apo me një neglizhencë të madhe të punës në Këshillin për Trashëgiminë Kulturore, për shkak të mungesës së bordit dhe mendoj që do të ishte mirë ky raport të trajtohet në njërin nga seancat e ardhshme, por mendoj që sot nuk jemi të përgatitur as ne si anëtarë të Komisionit për të debatuar për këtë raport, po as edhe deputetët tjerë.

Prandaj, mendoj se propozimi i Ismajlit, për t'u futur në seancën e radhës, është me vend.

KRYETARI: Ali Sadriu e ka fjalën.

ALI SADRIU: Faleminderit, zoti kryetar!

Përafërsisht edhe mendimi im është i njëjtë me kolegët. Pikat e rendit të ditës, ad hoc kështu si këto që ndodhën, mendoj se duhet të jenë të jashtëzakonshme dhe të ndodhin rrallë, sepse në një

mënyrë po e anashkalojmë edhe Kryesinë e Kuvendit, e cila e ka bërë një parapërgatitje së rrjedhës së seancës. Mund të ndodhë që këto pika të mos i shqyrtojmë dhe të shkojmë në vazhdimësi duke i shtyrë pikat që del si neglizhencë, por e ka edhe anën tjetër negative që mund të hyjë ndonjë pikë e pashoshitur deri në skajshmëri në kuadër të kapaciteteve që i ka Kuvendi.

Prandaj, unë preferoj që në rastet e tilla, për të hyrë në rend të ditës, realisht duhet të jemi më të kujdesshëm dhe të mos tentojmë në këtë mënyrë t'i fusim të gjitha pikat. Unë nuk jam kundër atyre, dhe votova në njërin kundër, por realisht jam kundër, jo të gjithave, por të trajtohen në radhën dhe procedurën si duhet. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Nuredin, urdhëro.

**NUREDIN IBISHI:** Faleminderit, zoti kryetar!

Pa dashur të shtoj diçka, sepse atë që desha të them e thanë edhe parafolësit e mi dhe mendoj që vetëm nëse është diçka urgjente, sikur që e tha edhe profesori Mustafa, nëse është e rastit sikur që është çështja e Marrëveshja për Stabilizim- Asociim apo diçka tjetër, ndonjë urgjencë, përndryshe në raste tjera, ato që i cakton Kryesia për rend të ditës, dhe mos të bëjmë përjashtime kështu për çdo seancë. Faleminderit!

**KRYETARI:** Atëherë, Smajl po e lëmë për seancën e radhës.

Atëherë, vetëm të konstatoj se Kuvendi me shumicë votash vendosi që në rend të ditës të seancës së sotme të radhiten edhe ato pika të cilat u përmendën.

Xhevahire, urdhëro, se po e shoh je kah reagon.

**XHEVAHIRE IZMAKU:** Zoti kryetar!

Unë e bëra një kërkesë, nëse ka mundësi të futet menjëherë në votim, çështja e bordit, për arsye që të mund të kalojmë nëpër dy runde, dhe nëse s'kemi numër të mjaftueshëm të deputetëve, pastaj na ndërpritet procesi.

Pra, këtë e kemi dhënë si premtim edhe në raportin për MSA që ne duhet ta kompletojmë bordin para se të shkojmë në pushim, dhe nëse ka mundësi, tani ta vëmë, menjëherë. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Paraprakisht dëshiroj të futem në procedurën në të cilën jam, e pastaj për korrektësi edhe ju reflektoni, meqë një letër na ka ardhur nga OSBE-ja, unë e konsiderova të vlefshme, sepse mu ka drejtuar mua, ta shikoni edhe ju. Vërejtjet janë shumë të mëdha, qoftë për digjitalizimin, qoftë për bordin, dhe ju e vendosni në fund.

Pra, pika e tretë:

### **3. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme**

Të nderuar deputetë, a keni vërejtje në procesverbalet e seancave plenare të mbajtura me 16, 22, 23 korrik dhe prapë me 23 korrik.

Nuk ka vërejtje. Atëherë, konstatojmë se Kuvendi i miratoi procesverbalet e seancave plenare të mbajtura me 16, 22, 23 dhe më 23 korrik 2015.

Para pauze, do të futemi në pikën e katërt të rendit të ditës, meqë na duhet qartësim.

#### **4. Interpelanca e ministrit të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, zotit Memli Krasniqi**

Deputetja Donika Kadaj-Bujupi, nga Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, e përkrahur edhe nga 6 deputetë tjerë nënshkrues, në bazë të nenit 44 të Rregullores së Kuvendit, ka parashtruar kërkesë për të ftuar në interpelancë, zotin Memli Krasniqi, ministër i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural lidhur me situatën e rëndë në industrinë e prodhimit të qumështit dhe produkteve të tij.

Ju njoftoj se kryetari i Kuvendit, më 14 korrik 2015, kërkesën e deputetes Donika Kadaj-Bujupi, ia ka adresuar kryeministrit të Kosovës, zotit Isa Mustafa.

Qeveria e Kosovës nuk i është përgjigjur kërkesës për interpelancë në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit.

Ministri, zoti Memli Krasniqi, me 23.7.2015 e ka informuar Kuvendin se pikat e adresuara në kërkesën e parashtruar për interpelancë, veçanërisht te pjesa e rekomandimeve, nuk kanë të bëjnë me fushën e përgjegjësive të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, por ato lidhen me fushat e përgjegjësive të institucioneve tjera, përkatësisht të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë dhe Agjencisë të Ushqimit dhe Veterinarisë së Kosovës.

Urdhëro, Donika!

**DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit, kryetar!**

Të nderuar kolegë deputetë,

Dua të shpreh respekt për ministren që ka ardhur, edhe pse kjo nuk është ftuar nga Parlamenti. Ne, sot e kemi ftuar ministrin e Bujqësisë dhe kjo ftesë ka dalur pas një takimi me qumështarët, gjendjen e të cilëve, besoj e dimë të gjithë se e kemi parë dhe është kjo, ata kanë më shumë se tri vjet që nëpër rrugët e Prishtinës dhe para Qeverisë së Republikës së Kosovës, po e derdhin qumështin dhe po kërkojnë zgjidhje.

Prej ditës kur ne kemi kërkuar dhe e kemi ftuar në interpelancë ministrin e Bujqësisë e deri me sot, ka pasur reagime të ndryshme dhe komunikim joformal nëpërmjet mediave, sepse një komunikim zyrtar i ministrit dhe deputetëve ndodh në këtë seancë dhe në Parlament, aty ku e kemi thirrur, dhe në bazë të nenit 4 të Kushtetutës së Kosovës, Qeveria duhet t'i japë llogari Kuvendit dhe ai si një ndër anëtarët e Qeverisë së Republikës së Kosovës, duhet që në ftesën tonë të vjen dhe të përgjigjet, qoftë edhe nëse rekomandimet e dhëna ka implikime edhe të dikastereve tjerë. Pra, baza e prodhimit të qumështit dhe politikave bujqësore dhe të blegtorisë është pikërisht në Ministrinë e Bujqësisë.

Këtë unë po e dëshmoj edhe me një organogram të cilin e kam këtu, e kam nxjerr nga ueb faqja

zyrtare të Ministrisë së Bujqësisë dhe besoj që e ka parë ministri, e cila thotë: Departamenti për Politika Bujqësore dhe Tregje. Sigurisht nuk bëhet fjalë për tregjet e naftës. Dhe, e dyta, thotë: Divizioni i Blegtorisë është eksplicit nën kompetencat e Ministrisë së Bujqësisë.

Po e pyes sot ministrin, ndoshta është duke na parë në televizion se këtu në seancë iu ka dukur papërshtatshëm të vjen. Nëse ai si ministër i Bujqësisë ka dhënë mbi 5 milionë euro subvencione, sivjet, ka subvencionuar lopët, i ka subvencionuar delet dhe dhitë, rrjedhimisht e ka subvencionuar prodhimin e qumështit, qysh mund të dalë në opinion e të thotë- mua nuk më intereson- a ka treg për qumësht dhe s'më intereson, sepse nuk është në domenin tim- a shitet a jo qumështi?

5 milionë euro janë para të qytetarëve, nuk janë para të ministrit dhe ai duhet të vjen dhe ta arsyetojë subvencionimin prej 5 milionë eurove të cilin e ka bërë në sektorin e blegtorisë, rrjedhimisht industrinë e qumështit.

Unë po dua ta përkujtoj ministrin se pikërisht industria e qumështit është sektor i cili mund të jetë promotor i zhvillimit ekonomik të vendit tonë, gjeneron mbi 40 mijë vende pune, të cilat neglizhenca e Qeverisë në vazhdimësi po i rrezikon. Janë mbi 500 milionë euro investime të cilat po rrezikohen të shkatërrohen, sepse ministrat përkatës thonë- nuk është punë e imja.

Ju lutem, punë e kujt është blegtoria nëse jo e ministrit të Bujqësisë? Punë e kujt është, le të na shpjegojë. Është dashur të vjen sot dhe ta shpjegojë këtë.

Po ashtu, në misionin dhe historikun e Ministrisë së tij thotë- Ministria e Bujqësisë është përgjegjëse, krijon politikën dhe zbaton ligjet për zhvillimin e bujqësisë duke përfshirë blegtorinë. Dhe, ai nuk ka ardhur sot këtu t'i shpjegojë përgjegjësitë e veta dhe për veprimet e veta. Domethënë, nëse nuk është domen i tij, qysh mundet të jetë domen i tij ndarja e 5 milionë eurove?

A ka kërkuar ndonjëherë ministri i Bujqësisë nga kolegja e tij, që është këtu, t'i përkrahë kërkesat e qumështarëve, duke ndërmarrë masa të duhura, qoftë nëpërmjet legjislacionit ose veprimeve tjera administrative. Pra, a ka kërkuar ai? Duhet të vjen, të na jep llogari dhe të thotë - tri pikat e para, tri rekomandimet e para lidhen eksplicit dhe drejtpërdrejt me Ministrinë e Bujqësisë, 3 të tjera lidhen me Ministrinë e Tregtisë, për të na treguar a komunikon?

Ekziston njëfarë Këshilli, në mesin e shumë këshillave që janë formuar këtu, e të cilave u prinë edhe presidentja, edhe bëhet çdoherë një takim megaloman, e thirren krejt ministrat dhe thonë - Këshilli për zhvillim ekonomik. Çka bën ai Këshill? A komunikoni ju ndërmjet veti t'i harmonizoni politikat dhe të sillni rezultate?

Domethënë, për çka ekzistoni? Tash- a duhet deputeti për çdo ditë të vjen dhe t'u adresohet një nga një ministrave dhe t'u thotë: jo kjo pikë bash s'po më duket imja, pyeteni tjetrin.

Po, mos ju lutem se Qeveria funksionon si një trupë. Ju funksiononi si një trup e përbashkët dhe jepni llogari dhe përgjegjësi si një trupë. Nuk keni llogari dhe përgjegjësi individualisht veç e veç

për çdo çështje, por jepni llogari si Qeveri e Republikës së Kosovës, qoftë kur veproni mirë, qoftë kur veproni keq.

Tash, a koordinoheni me kryeministrin dhe ministrat ndërmjet veti, ne nuk jemi këtu trupë për koordinimin e ministrive, por jemi Parlament që ju kemi thirrur të vini të raportoni, sepse prej neve, të cilët jemi votuar prej qytetarëve të Kosovës, është kërkuar të ofrohen zgjidhje për një problem, që po pajtohemi të gjithë, pavarësisht a jemi pozitë a opozitë, është problem i cili po bartet prej viti në vit.

Çka duhet për t'u thënë qumështarëve? Tash mos prodhoni, sepse kjo nuk është në domenin e Ministrisë, mos aplikoni për subvencione, sepse kjo nuk është në domenin e blegtorisë, merruni vesh me tregti, importoni pluhur, e nxëni djathin qysh po e nxëni tash me atë vajin e palmave që është kancerogjen, sepse nuk keni vënë kuota as standardizim.

Çka t'u themi? T'u themi - qumështin e freskët, prodhimin vendor po e derdhim, ndërkohë që po importojmë vajra bimore dhe po prodhojmë djathë dhe po e rrisim kancerin në vend e po e dëmtojmë prodhuesin vendor, sepse ministrat s'kanë mund të darkodohen, të harmonizohen dhe të merren vesh ndërmjet veti.

Na është thënë që grandet janë rritur dhe ne nuk e kemi pasur vetëm një pyetje për ministrin, kemi pasur për shumë çështje ta pyesim dhe t'i trajtojmë e diskutojmë.

Është thënë në vazhdimësi se janë rritur grandet, pra ne i përshëndesim. Kemi kërkuar vetë që buxheti për bujqësi e për blegtori të rritet. Dihen kapacitetet që i ka Kosova, por qysh është e mundshme të rriten grandet dhe të keqësohet gjendja në terren, te keqësohet gjendja e blegtorit, e fermerit dhe e bujkut. Qysh mundemi ne të jemi në një gjendje më të keqe se në të kaluarën, për derisa kemi shtirë më shumë para në sektorin përkatës?

E tash, nëse e shohim raportin e grandeve, që prapë është një dokument nga Ministria e Bujqësisë, për shembull, Rahoveci është cilësuar shumë herë edhe nga partia që udhëheq me dikasterin- si kryeqytet i bujqësisë.

Edhe është, dhe po pajtohem që është. Atëherë, te grandet, te përpunimi i qumështit, numri i aplikuesve gjithsej ka qenë 13, ndërsa numri i përgjithshëm i përfituesve në nivel Kosove, ka qenë 6, ndërkaq komuna e Rahovecit, kryeqyteti i bujqësisë, 0 përfitues.

Te përpunimi i mishit, thotë: numri i aplikuesve, në përgjithësi, 26, numri i përgjithshëm i përfituesve, 9, Komuna e Rahovecit, asnjë përfitues.

Shiheni, te lista e vlerësimit për vitin 2015, masa 101.2, sektori për sera dhe depo për ruajtje të perimeve, thotë: Në komunën e Rahovecit përfitues janë 4. Në këtë masë është pritur që të ketë më shumë përfitues. Për shembull, në Krushën e Madhe kanë aplikuar 15 bujq dhe vetëm 1 është përfitues, ndërsa në komunën e Skenderajt, janë përfitues 9 qytetarë, 9 bujq dhe përfitues të serave.

E tash, a po i bie kjo që kryeqytet i bujqësisë- a është Skenderaj apo është Rahoveci dhe cilat janë kapacitetet dhe ekspertiza në Skenderaj kundruall Rahovecit? Cila është toka bujqësore që shfrytëzohet në Skenderaj kundruall Rahovecit? Cilët janë parametrat me të cilët bujqit në Skenderaj, në raport me bujqit në Rahovec kanë përfituar 10 me 1.

Këto përgjigje është dashur sot të vijë të na i jap ministri i nderuar, e jo të thotë s'është punë imja dhe s'është në domenin tim, domethënë, është absurde.

Pastaj, e kam pasur edhe një pyetje shtesë për ministrin e nderuar. Pse, fermerëve nga komuna e Istogut, në tremujorin e fundit të vitit 2014, u janë fshehur aplikacionet për grande dhe subvencione për qumësht? Do të thotë, është në tre muajt e fundit, njerëzit kanë ardhur, kanë aplikuar, e kjo nuk po u ndodh veç fermerëve të Istogut, vijnë në Ministrinë e Bujqësisë aplikojnë, e dorëzojnë aplikacionin, u pranohet aplikacioni, e dy orë para se të mbyllet afati për aplikim i thërrasin në telefon, është në Istog, i duhet të vijë, i duhet të përgatitet, i thotë më fal, por një dokument ka humbur, po pse...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYETARI:** Mos ia ndal, veç je duke e përfunduar interpelancën, Donikë!

**DONIKA KADAJ-BUJUPI:** Atëherë pse fillimisht e pranoje dokumentin, pse e pranoje aplikacionin. E ke pranua aplikacionin, e ke maltretua fermerin që ndoshta nuk ka pasur para ta paguajë rrugën dhe i ke thanë eja apliko. Ka ardhur, ka aplikuar, e dy orë para mbylljes së afatit e ke thirr i ke thanë të ka humbur një dokument. Për këtë kam dashur ta pyes ministrin. Në rastin konkret, fermerët e Istogut e kanë ridëshmuar pas tre muajve që kanë aplikuar dhe nuk kanë marrë asnjë përgjigje.

Besoni ata deri më sot të nderuar kolegë deputetë nuk i kanë marrë paratë që u takojnë, edhe nuk e kanë marrë asnjë përgjigje nga ministri i Bujqësisë për çështjen në fjalë. Dhe, sigurisht që ministri është dashur sot të vijë dhe të japë përgjigje në këtë Kuvend për problemet për të cilat e kemi thirrur. Kjo nuk do të thotë që ne në të ardhmen nuk e ftojmë edhe ministren e Tregtisë, edhe kryeministrin, edhe Agjencinë për Ushqim dhe Veterinë, në të cilën shefi i ministrit në vitin 2008 e pati bartur në Kryeministri, gjë që ka qenë e paligjshme. Kemi reaguar asokohe më kujtohet se kam qenë deputete në këtë Parlament, por e ka marrë, e ka bërë një centralizim, ka dështuar tash komplet ajo agjenci, tash thonë prapë nuk është përgjegjësi jona, është përgjegjësi e një agjencie. Po kush e formoj atë agjenci, njerëzit e kujt punojnë aty. Kush e mori e çoi në Kryeministri prej Ministrisë së Bujqësisë?

Ju lutem, janë disa çështje në Republikën e Kosovës që i tejkalojnë interesat e ngushta partiake dhe politike.

Dhe ne si deputetë kur e shohim që qumështi po derdhet para Qeverisë ishte dashur ta thërrasim një seancë të jashtëzakonshme, pavarësisht kush është në pushtet, e kush është në opozitë. Nuk lejohet çdo vit me temperatura të tilla, kur qumështi priset edhe kur e dimë që nuk kanë këta njerëz zgjidhje tjetër, përveç nëse ne ofrojmë politika lehtësuese dhe nuk lejojmë të importohet pluhuri me kuota tepër të larta dhe të zëvendësohet qumështi i freskët për produktet ushqimore

që është kancerogjene po që reagojnë, janë pesë vite që në vazhdimësi po përsëritet e njëjta dhe askush s'po reagon dhe një herë e thërrasim ministrin e Bujqësisë dhe ai thotë nuk vijë se pika 1, pika 2, pika 3 s'qenkan në domenin temë, po mbrojtja e prodhimeve vendore të jetë një nga prioritetet kryesore të Qeverisë së Kosovës, ky ka qenë rekomandimi. Dhe djali thotë ky nuk është në domenin tim, po ti a e përfaqëson Ministrinë e Bujqësisë, a je ministër, të lutem!

Të mbrohet industria e qumështit nga konkurrenca jolojale dhe të hiqen nga tregu produktet e dyshimta.

Një ministër i cili i ka dhënë 5 milionë euro për subvencion të qumështit ishte dashur të vijë në këtë seancë, dhe të vijë i përgatitur pas harmonizimit të qëndrimeve me ministren përkatëse edhe të na njoftojë se cilat janë masat e marra. Kjo po kërkohet.

Unë kërkoj dhe insisto që ministri i Bujqësisë të jetë këtu, nëse është në pushim dhe nuk është sot në Prishtinë, e nuk vjen sot, le të vijë në seancën e radhës, por nuk e pranoj faktin që një ministër i Bujqësisë të thotë nuk është në domenin tim qumështi dhe prodhimi i qumështit, e ndërkohë paratë e mia, taksat që unë i paguaj, që qytetarët e Kosovës i paguajnë, që janë 5 milionë, i jep subvencion për qumësht.

**KRYETARI:** Donikë, faleminderit! Tema është shumë e ndjeshme, por vetëm pak, po s'na jep asnjë qëndrim. Donikë pothuajse e mbarove si interpelancë, po s'na e dhe një qëndrim, do ta tërheqësh, apo do ta mbash? Donikë, edhe një herë, reagimi yt pothuajse... Ministre, nëse dëshiron. Por, s'po di Profesor, edhe unë e pyeta. Urdhëro! Politikisht, shumë korrekt e ke realizuar, mesazhin e ke dërgua, por çka do të bëjmë me interpelancën?

**DONIKA KADAJ-BUJUPI:** Kryetar!

Koncepti im dhe juaji dallon se unë këtë çështje nuk e trajtoj politikisht, po e trajtoj me zemër dhe bashkëndiej me këta njerëz të cilët qe 5 vjet janë duke vuajtur për shkak të politikave që ju dhe partia juaj po i zbatoni.

Nëse ministri nuk vjen, ne sot e tërheqim interpelancën, sepse s'kemi me kë të diskutojmë dhe s'kemi me kë të debatojmë. Mirëpo, unë po thërras që kjo interpelancë të vihet pikë e rendit të ditës në seancën e radhës dhe ministri të jetë këtu, t'u përgjigjet pyetjeve, të cilat ne i ngrehëm. Faleminderit!

**KRYETARI:** Të mos ishte partia ime, nuk do të ishte diskutuar fare, sepse nuk është dhënë asnjë cent këtyre herë. Atëherë, e tërhoqe Donikë, prapë politikisht e ke përçuar mesazhin, po qumështorët nuk e derdhin në tokë. Më mirë është t'ua sjellin deputetëve këtu edhe t'i sensibilizojnë se ta derdhin. Megjithatë, u tërhoq kjo pikë e rendit të ditës, e tani e kemi një situatë reale. Por dëgjo, Donika, nuk e dinë që "kracilat" në Skenderaj, ose "mbretëreshat" me mijëra hektarë, për atë arsye reagoi, se ka ditur fare gjendjen e bujqësisë në Skenderaj, prandaj reagoi unë mjaft për ju.

Bekim dhe Ganimete, nga një minutë, dy. Hajde për Skenderaj, Shaip ti je i Drenasit.

**BEKIM HAXHIU:** Faleminderit, i nderuar kryetar!

Vetëm desha ta saktësoj një manipulim që e nderuara kolege deputete bëri me statistikat. Nuk mund të merren statistikat të një viti të abuzohet me to, me serrat e Skenderajt pa i krahasuar edhe vreshtat e Rahovecit. Unë besoj që deputetja këtë e ka bërë qëllimisht, prandaj, mendoj që kur të flasim për statistikat dhe për investime në total për komunat dhe subvencionin, ne duhet ta falënderojmë Ministrinë e Bujqësisë për këto subvencione, të cilat është duke i bërë. Por, edhe përkushtimin e ministrisë që të investojë në krejt Kosovën në zhvillimin e bujqësisë.

Unë besoj që deputetja nuk është kundër zhvillimit të bujqësisë në komunën e Skenderajt, por nuk ka të drejtë të abuzojë me statistika për arsye se do të nxirren ato në nivelin e investimeve dhe subvencioneve në bujqësi, në blegtori dhe vreshtari. Nuk besoj që Donika këtë e ka bërë qëllimisht, mirëpo ndoshta e ka bërë si rastësisht për ta zgjuar vëmendjen e opinionit.

**KRYETARI:** Ganimete, urdhëro!

**GANIMETE MUSLIU:** Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuara kolege dhe ju kolegë deputetë,

Fillimisht Donikë, nën një, e mbështes fuqishëm shqetësimin tënd për qumështin, do të thotë se është shqetësim edhe yni dhe i gjithë kolegëve deputetë që janë sot këtu në sallë, jo vetëm juaji, e para.

E dyta, më vjen shumë keq, por duhet ta pranosh që ia ke huq me kërkesën, me kërkesën ia keni huq, nuk është asgjë tragjike ajo të thuhet e kemi huq me kërkesën se është dashur t'i bëhet ministres së Tregtisë që është sot këtu dhe kemi pranuar dhe kemi për të debatuar pa asnjë problem, e dyta.

E treta, kur dalim te investimet në bujqësi, e more shembull shumë të mirë Rahovecin. Respekt për të gjithë rahovecianët të cilët e kanë bërë kulturë zhvillimin e bujqësisë në atë pjesë dhe unë mburrem me Rahovecin dhe me zhvillimin e kulturave bujqësore atje. Por, të lutem, është mirë kur merr shembuj të tillë t'u referohesh viteve ose ndryshimeve në vite, dhe nëse e merr këtë, unë veç një fjalë dua të ta them. Po ta bëj me dije ty dhe gjithë deputetëve tjerë dhe gjithë atyre që mendojnë si ti që ju ka vdekur koha e izolimit të Skenderajt. Në vitin 2007, ajo periudhë ka vdekur, prandaj zoti ju lashtë shëndosh, sepse Skenderaj do të ketë investime, do të ketë përparim dhe do të ketë zhvillim, deshët apo nuk deshët ta pranoni. Ka kaluar koha kur Skenderaj është izoluar nga pushtetet e caktuara.

Prandaj, sot kërkoj nga të gjithë ministrat që të mos hezitojnë, të investojnë në Skenderaj, sepse Skenderaj ka nevojë ende të balancohet me komunat tjera. Asgjë më shumë, as më pak nuk kërkohet.

Deri në vitin 2007, në Skenderaj kemi pasur vetëm 2 kilometra të asfaltuar, e kemi pasur vetëm një shkollë e gjysmë investime. Prandaj, sot ju pengon zhvillimi në Skenderaj. Faleminderit!

**KRYETARI:** Dëgjo se po futemi në debat, po e lëmë këtë pikë të rendit të ditës, përfundoj si Skenderaj si Istogu, njëjtë është edhe Rahoveci, siç janë me duar të arta.

**MUHAMET MUSTAFA:** Faleminderit!

Duhet ta informoj opinionin për pikat e rendit të ditës, në emër të komisionit profesori Muhamet po të përgatitemi a po e lëmë pas pauze, e kemi një qëndrim të OSBE-së ju e vendosni në fund. Urdhëro, profesor edhe përgatitemi gradualisht pikat e reja.

MUHAMET MUSTAFA: Ju faleminderit, po kërkoj falje por duhet të informoj deputetët dhe opinionin që çështja e qumështit me të vërtetë është një çështje aktuale dhe tu u nis nga kjo, faleminderit vetëm të diskutojmë, duke u nisur nga kjo Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Tregti dhe Industri e ka marr këtë çështje në trajtim dhe është duke e trajtuar me kujdes dhe kemi vizituar bashkë me Palin kemi qenë te shoqatat dhe Pali e di këtë punë që jemi duke e bërë, por unë... kur të ulemi që të bisedojmë për këtë çështje të dalim sa më të përgatitur, sepse ne mund të diskutojmë kurdo që të diskutojmë dhe të kemi diskutime akuzuese një grup parlamentar ndaj tjetrit ose parti politike, por duhet të flasim me argumente dhe më në fund ta sqarojmë deri në fund çështjen dhe të ndryshojmë këtë gjendje.

Sepse, një hall është këtu që disa vjet, një hall është dhe meqenëse është ai hall unë e kisha kërkuar dhe nga deputetët e AAK-së meqenëse kemi hy një proces që të prodhojmë një material të mirë me rekomandime të mira kur te trajtojmë këtë çështje ta trajtojmë në mënyrë të argumentuar dhe pa e politizuar. Dhe, mos të tentojmë që dikush po kujdeset më shumë se dikush.

Gjithë kjo çështje meriton kujdesin e duhur, mendoj se edhe ministria ka bërë diçka ka bërë do analiza, ka probleme me ligje por në qoftë se duhet ato ligje duhet t'i ndryshojmë sepse nuk mund të mbajmë ligje, të cilat janë të dëmshme për prodhimet vendore ne duhet t'i shohim ato ligje ku janë edhe a janë të dëmshme më së pari, ende s'kemi konstatuar por në qoftë konstatojmë që ligjet të caktuara janë të dëmshme dhe i sjellin në pozitë të pabarabartë konkurruese prodhimet vendore gjëja e parë që duhet të bëjmë duhet t'i ndryshojmë ato ligje ose t'i adaptojmë, por ende nuk jemi me këto argumente.

Prandaj, unë po kërkoj që çështja e qumështit të vijë në debat në mënyrë shumë më të organizuar, pa emocione, pa politizuar dhe ne te krijojmë një atmosferë ku punojmë bashkë edhe Qeveria edhe Kuvendi edhe opozita t'i gjejë zgjidhjet. Por, në qoftë se kërkojmë konfrontim na mbetemi në çështjet deklarative. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Kryetari i komisionit e pati një propozim shumë të mirë, propozuesi i interpelancës në qoftë se ka mundësi me Komisionin për Buxhet dhe Financa debatojmë seriozisht si Kuvend. Urdhëro, ministrja e Tregtisë dhe Industrisë e ka fjalën, profesor edhe pak se gati e kemi.

MINISTRJA HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,  
Kolegë ministra,  
Të nderuar qytetarë,

Në fakt ua apostrofova disa herë edhe dola të them këtu se ndjej obligim Ministria e Tregtisë dhe Industrisë është kompetente për zbatimin e Ligjit për masat mbrojtëse dhe zbatimin e Ligjit antidamping. Ne si Ministri e Tregtisë dhe Industrisë nuk kemi ndenjur duarkryq që nga marrja e

kërkesës nga shoqata e përpunuesve dhe prodhuesve të qumështit. Kemi formuar grupin ndërministror, janë mbajtur disa takime deri më tani jemi duke bërë verifikimin e statistikave, një komision tjetër po punon edhe në analizimin e të dy ligjeve për të parë se ku janë pengesat për implementim të këtyre ligjeve.

Unë nuk kam marrë kërkesë për interpelancë andaj edhe nuk kam ardhur për t'ju adresuar interpelancës mirëpo ju bëj me dije që në momentin kur marr një kërkesë ose një ftesë nga ju deputetë të nderuar, unë jam e gatshme që të vijë dhe të përgjigje. Ju faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Atëherë, po e lëmë Salih, Shaipi e kam që një orë atëherë, pra Shaipi dhe Salihu shpejt.

**SHAIPI MUJA:** Faleminderit, zoti kryetar!

Tërheqja e ministres nga interpelanca mendoj që tregon se i mungon informacioni i mjaftueshëm për ta menaxhuar at ministri.

Dhe, paraqitja e ministres tregon gabimin e dytë që paraqitet që s'po rrinë duarkryq por nuk është përgjegjëses për këtë problem dhe tregon që në mënyrë jo cilësore janë duke e menaxhuar Qeverinë. Ministri është dashur të vijë në interpelancë nuk flitet këtu për problemin kyç në Ligjet mbrojtëse të anti dampingut, por janë sërë problemesh në zhvillimin e produktit vendor që është qumështi.

Dhe ne është dashur që të analizojmë si deputetë faktorët pse qumështi ynë nuk është konkurrentë në tregun e jashtëm i cili sot neve na konkurren dhe ne nuk mund ta konkurrojmë me këtë standardë. Qumështarët tonë duhet t'i udhëzojnë ose t'i rishikojnë ligjet dhe jo të bëhet gabimi edhe nga profesor Mustafa që nga Ligjet për zhvillim ekonomik do t'i analizojmë ne, këto janë çështje psikologjike për adresime politike, por duhet t'i gjejmë faktorët të cilët ne po arrijmë mos të stimulojmë prodhimin vendor. Prodhimi vendor qumështi ka filluar të rëndohet për shkak sepse bujku jonë është futur në rend të parë pa pjesën e asaj strategjisë që e ka Ministria e Bujqësisë edukimin e bujkut.

E dyta, kur ka filluar të blerjen e teknologjisë për procesimin e qumështit ai ka paguar doganë, duhet të emërohen faktorët të cilët e kanë rënduar. E treta është në tregun e kontrollit të cilësisë dhe parashtruesja e cila parashtron këtë debat është politikisht e frustruar, sepse ka edhe elemente të cilat përdoren edhe shkencërisht të gabuara. Ne jemi deputetë, ne duhet të kemi përgjegjësi dhe të themi nëse yndyrat bimore qenkan kancerogjene është konkludim shumë i dëmshëm publik, sepse nuk është e tillë nuk është e qëndrueshme, po ashtu për arritje politike thuhet AVUK-u është futur nën ombrellën e Qeverisë sepse ka dashur të bëhet një centralizim edhe kjo është politikisht e paqëlluar dhe strategjikisht është jashtë standardeve të Bashkimit Evropian.

Sepse, Bashkimi Evropian edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës këto agjenci radhitin tok në zyrat e presidentëve të vetë. Dhe, janë zyre më të rëndësishme se sa ndoshta edhe ushtria, prandaj ne nuk duhet,... unë e kam dëgjuar që Qeveria e ka strategjinë për ta kthyer në Ministrinë e Bujqësisë. Është gabimi tjetër i cili mendon që ta kthejë në Ministrinë e Bujqësisë AVUK-un,

por AVUK-u duhet të rritë cilësitë dhe të emërohen problemet të cilat e rëndojnë at që nuk funksionon ndoshta në standardet dhe mendoj që arrihet mjaftë.

Për përfundim ne kur thash se duhet që ministri i Bujqësisë nuk ka faj se s'e njej bujqësinë, mirëpo ia ka huq se një lopë në Bashkimin Evropian si standard prodhon 40 litra qumësht në ditë, ndërsa në Republikën e Kosovës mesataren e ka nga 10 në 15. Tash mundeni ta merrni me mend se si mundet me sasi mund të konkurrojë me çmim, prandaj ne për këta faktorë duhet të bisedojmë edhe për çështjen e grandeve, edhe për çështjen e teknologjisë edhe për çështjen e procesimit teknologjik të prodhimeve bujqësore. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Salih Salihu e ka fjalën.

**SALIH SALIHU:** Faleminderit, kryetar!

Me keqardhje po i shoh intencat që po duan bujqësinë në njëfarë mënyre t'ia atribuojnë vetëm një sektori.

Nga vetë fakti që bujqësia është një sektor dhe ka një rol multidimensional nuk mund të thuhet që pengesë për zhvillimin e këtij sektori është një ministri apo ministria tjetër dhe në këtë rast po dua të them që ne kemi është thirr në interpelancë ministri i Bujqësisë dhe në qoftë se ministri i Bujqësisë na shpjegon në interpelancë se përgjegjës për këtë problem që është paraqitur kohëve të fundit në sektorin e qumështit, si një nga sektorët kryesor fitimprurës në bujqësinë e Kosovës dhe në ekonominë e vendit atëherë ne sigurisht që do ta thërrasim në interpelancë edhe ministren. Mirëpo, ikja e përgjegjësisë në këtë mënyrë ndërkaq në anën tjetër vazhdimisht nëpër debate publike, po edhe në Kuvend flet se po investohen miliona euro në këtë sektor dhe thotë nuk është përgjegjësia e imja, kjo në fakt është një përparësi shumë e madhe e tij.

Një fakt dua ta them që shtetet e BE-së, të cilat janë në BE dhe të cilat eksportojnë produkte ushqimore në Kosovë shpeshherë të dyshimta ata kanë arritur që t'i ndërtojnë fabrikat në Bosnje dhe Hercegovinë vetëm për t'i krijuar favore vetvetes thjesht për t'i ikur TVSH-së në Kosovë dhe Bosnja është në marrëveshje tregtare dhe CEFTA-së dhe importon pa TVSH në Kosovë, ndërkaq ne këtu si njerëz me ministrinë që i kemi nuk jemi në gjendje ta bëjmë asnjë hap për ta mbrojtur prodhimin tonë vendor.

Kjo mendoj se është e turpshme, kemi të bëjmë me një sektor që diku janë rreth 20 mijë vetë të lidhur me këtë sektor në mënyra të ndryshme direkte dhe indirekte dhe ne i humbim rreth 40 milionë euro në vjet për qumësht që importojmë nga vendet tjera dhe qumësht të dyshimtë, i cili mund të jetë edhe kancerogjen sepse kolegët deputetë po thonë nuk është kancerogjenë. Ne e dimë këtë s'mund të themi as që është as që nuk është, por kush është ai njeri që bën statistika në fakt se pse vdesin 26 mijë prej kancerit brenda një muaji.

Sa analiza bën ministri i Shëndetësisë? Askush nuk merret me këtë problem, prandaj ne njëherë e përgjithmonë duhet të ndalemi ta shikojmë statistikën e Kosovës sa fëmijë po vdesin në muaj dhe a ka raste të vdekjeve edhe në Serbi, edhe në Maqedoni, edhe në Shqipëri dhe në qoftë se është rasti vetëm në Kosovë atëherë ju lutem duhet të merremi seriozisht me këtë problematikë, sepse sigurisht problemi kryesor është te produktet e importuara që janë të dyshimta që pa dyshim mund të kenë edhe efekte kancerogjene në organizmin e njeriut. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Realisht, është mirë me e marrë një përfundim. Donika nuk është këtu si parashtruese e interpelancës, por tash... e ka tërhequr profesor, por po flasim për çështjen e njerëzve të cilët jetojnë prej saj, se ajo mund të bëjë edhe dy ministrive, tri ministrive t'ua drejtojë si shkresë. Në qoftë se, dëshiron, le ta bëjë. Shqyrtohet, kështu mbeti.

Tani jemi në situatë, një letër e keni marrë, që ndërlidhet me pikat e rendit të ditës. A dëshironi tani, për shkak të prezencës së deputetëve, në votim. Xhevahirja po thotë disa herë me bisedua, Muhamet profesor, po ashtu ju e keni kërkuar fjalën, apo dëshironi të bëjmë pauzë dhe... por çështja... votim, por profesori derisa ta marrë fjalën, pastaj kam edhe një gjysmë fjalë edhe unë.

**MUHAMET MUSTAFA:** Unë mendoj një arsytim më të gjerë sigurisht kur të vijmë te amendamentet, por problemi që ka ngritur OSBE-ja është i adresuar në amendamente dhe një plotësim i vogël, që bëhet sot. Prandaj, informatat si duket nuk kanë qenë të duhura te OSBE-ja.

Kështu që, problemi sa i përket digjitalizimit është i adresuar në amendamente dhe në plotësimin, që sot e ka bërë komisioni. Faleminderit!

**KRYETARI:** Atëherë, shefat e grupeve parlamentare, ose përfaqësuesit e tyre le të përgatiten për të dhënë një deklaram. Ne do të shkojmë, në qoftë se i shqyrtojmë në vazhdimësi si pikë të rendit të ditës zgjedhjen e pesë anëtarëve të Bordit të Radio-Televizionit të Kosovës pastaj futemi në pikën pasuese shqyrtimi i dytë i Projektligjit për digjitalizimin e transmetimeve radio-difuzive tokësore.

Koncentrohemi te grupet parlamentare, ta marrim qëndrimin. Nga Partia Demokratike e Kosovës kush do të flasë? Xhevahire Izmaku, urdhëro!

**XHEVAHIRE IZMAKU:** Faleminderit, kryetar!

Grupi Parlamentar i PDK-së mendon që është koha të shkojmë tani në votim, për arsye se na duhet një numër i caktuar dhe mund të ketë dy raunde votimi, mendoj se duhet tani të fillojmë me votim. Faleminderit!

**KRYETARI:** Vetëm, Xhevahire, shqetësimet e OSBE-së, si i konsideron, që ta kemi për hir të transparencës.

**XHEVAHIRE IZMAKU:** Faleminderit, kryetar!

Unë mendova që kur ta marr fjalën si kryetare e komisionit edhe të flas për këtë shqetësim.

Fillimisht, e tha profesori, është e vërtetë pra që pak e vonshme është interferenca në çështjen e digjitalizimit, sepse këto vetëm janë ndërlidhë gjatë hartimit të projektligjit. E dyta, lidhur me bordin, lidhur me ankesat për kualitetin e listës së prodhuar nga votimi, konsideroj që edhe OSBE-ja i ka ikur mandatit të vet. pra, nuk mund të ndërhyhet. Pikërisht, kjo që bënë OSBE-ja është ndërhyrje, sepse votimi është i fshehtë. Me ligj të RTK-së deputetët kanë me vendos për anëtarët e Bordit të RTK-së me votim të fshehtë. Kjo ka ndodhur. Të gjitha grupet politike kanë pasur anëtarët e vet. të gjithë anëtarët që kanë qenë në Komision ad hoc e kanë nënshkruar procesin si të rregullt. Këtu, pra kanë nënshkruar edhe përfaqësuesit e opozitës.

Po ashtu, shfrytëzoj rastin që nuk e mora fjalën sot një javë, sepse kryesuesi nuk ma dha fjalën, që të deklaroj lidhur me çështjen e akuzës edhe të koleges sime nga “Vetëvendosja”. Edhe kolegja nga “Vetëvendosja” e ka nënshkruar këtë proces, pra procesi është i rregullt, mirëpo se çka ka prodhuar ai votim i fshehtë unë nuk mund të flas tani, mirëpo do të flasë vota. Në mesin e këtyre kandidatëve kemi njerëz të cilët meritojnë të jenë në Bordin e RTK-së.

Nuk them, se nuk ka pasur hapësirë edhe për të tjerë, mirëpo po të ishte një numër prej 20 anëtarëve, atëherë do të kishte hapësirë edhe për të tjerë. Pra, ne mund të hyjmë në votim. Në listë ka emra të cilët meritojnë të jenë në Bordin e RTK-së.

Ndërsa, çështja e OSBE-së konsideroj se është relative. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Teuta Sahatqija nga Lidhja Demokratike e Kosovës.

**TEUTA SAHATQIJA:** Kryetar!

E morëm këtë letër nga OSBE-ja sa ishim të ulur në bankat e Parlamentit. Mendoj që OSBE-ja është dashur të jetë pjesë, edhe qëndrimet pozitive, ma merr mendja që qëndrimet të cilat i ka dhënë në këtë letër janë qëndrime, të cilat kanë të bëjnë me kualitetin e Bordit. Por, që “timing”-un mendoj që nuk e ka zgjedhur si duhet. Është dashur që të dërgojë këtë shkresë shumë më herët. Bordi këto emrat nuk kanë ardhur sot për sot, por kanë kaluar në disa procedura dhe mendoj që edhe OSBE-ja do të duhej që këtë intervenim, në fakt, ta sjellë më herët, në mënyrë që të vijmë deri te një rezultat.

Tash jemi në një fazë ku këto ndryshime nuk mund të bëhen. Ne mund vetëm të kërkojmë që të anulohet, ose të hyjmë në fazën e votimit. Përndryshe, me këtë letër nuk mendoj që jemi në atë pikë, ku mund ta shtyjmë. Mendoj që duhet të hyjmë në votim dhe votimi të tregojë se si do të procedohet.

Ndërsa, prej OSBE-së me të vërtetë kërkoj që të jetë pak më vigjilente, në qoftë se sjell rekomandime, të sjellë rekomandime me kohë, kur ka mundësi të intervenimit e jo tash, që na qet në një pozitë me të vërtetë të keqe. Ndërsa, për këtë pjesën tjetër të digjitalizimit, mendoj se veç folën, këto janë rregulluar dhe pjesa e dytë që ka të bëjë me digjitalizim, është pjesë e cila është “outdated”, është tejkaluar por si duket nga OSBE-ja nuk e kanë kuptuar ende. Faleminderit!

**KRYETARI:** Për korrektësi, para se të vazhdojmë te Shqipe Pantina, letra ka ardhur me 29 korrik edhe pse shkruan më 28 korrik, ka ardhur në mbrëmje pas dite. Urdhëro, Shqipe Pantina nga Lëvizja “Vetëvendosje”

**SHQIPE PANTINA:** Po më habit i gjithë serioziteti me të cilin po trajtohet letra që ka ardhur nga OSBE-ja, kur të njëjtën çështje, të njëjtat shqetësime unë i kam ngritur javën e kaluar këtu në Kuvend dhe nuk pati asnjë reagim nga asnjë deputet i Kuvendit. kështu që, prapë kjo po e vërteton, se për të dashur të vihet rend dhe ligj deputetët, sidomos të shumicës, më shumë janë lojalë dhe të dëgjueshëm ndaj organizatave ndërkombëtare, se sa shqetësimeve që ngrenë anëtarët e Kuvendit.

Në fakt, ato që janë ngritur në letër të OSBE-së janë të qëndrueshme. Procesi po, unë e kam nënshkruar në fund procesverbalin, sepse procesi, përveç faktit që nuk janë lejuar vëzhguesit e të cilën gjë unë e kam kuptuar se ka pasur kërkesa për vëzhgues, sidomos nga mediat vetëm të nesërmen dhe prandaj e kam ngritur si shqetësim, pjesa tjetër e intervistimit ka shkuar në rregull.

Ajo çka ka ndodhur në fund është që votimi është bërë duke anashkaluar plotësisht kriteret që kërkohen me ligj. do të thotë, janë vlerësuar njerëzit të cilët nuk i kanë plotësuar, madje kriteret, njëri prej të cilëve që unë prapë e kam ngritur, duke qenë edhe kandidat për deputet, duke qenë njeri politik, gjë të cilën nuk e lejon as Ligji për RTK-në.

Kështu që, në mesin e njerëzve të cilët kanë ardhur sot, më vjen keq, por nuk ka njerëz që i plotësojnë kriteret dhe janë kridibil për të qenë anëtarë të bordit. Po ashtu, duke pasur parasysh faktin se në çfarë gjendjeje ndodhet Radiotelevizioni i Kosovës. Po, e kuptoj se nëse ne do ta zgjerim bordin për 50 veta do të kishte mundësi ndoshta me i futë këta njerëz, por Bordi i ka 11 anëtarë dhe ne sot votojmë për 5 prej tyre dhe nga lista prej 10 kandidatësh nuk ka njerëz të cilët do ta ngrisnin apo edhe do ta sillnin në gjendje normale RTK-në. Dhe po ashtu, ne kërkojmë që në fakt i gjithë procesi të anulohet dhe të fillohet prej fillimit zgjedhja e anëtarëve të rinj të bordit.

**KRYETARI:** Faleminderit! Pal Lekaj nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, qëndrimin.

**PAL LEKAJ:** Faleminderit, kryetar!

Sa i përket procesit të votimit, mendoj se çdo deputet e ka dhënë votën Komisioni ad hoc dhe ajo që bie në... potencohet më së shumti është politizimi i Bordit të RTK-së. Ka hapësirë dhe mendoj që këtu kanë të drejtë edhe OSBE-ja mirëpo kemi të drejtë edhe ne si deputetë.

Është mjaft i politizuar Bordi i RTK-së. Janë njerëz që kanë qenë anëtarë të partive politike dhe që nuk bën që të jenë të përfshirë. Mirëpo, si proces, është e vërtetë që e kemi nënshkruar procesin, është e vërtetë që kemi votuar, por ajo që po më bën përshtypje, koalicioni qeverisës kur merr kritika nga organizmat ndërkombëtarë që nuk përputhen me interesat e grupeve të caktuara, fare nuk i shqyrton.

Ndërsa, me çështje kur merr atë që duhet, që ndoshta është kundër interesit të vendit menjëherë votojnë dhe atë pa hezitim.

Prandaj, kjo më bën shumë përshtypje dhe ne nuk guxojmë që të biem në këto lajthitje dhe mendoj që çdo shqyrtim i një çështje të caktuar, që është për të udhëhequr një medium publik, është dashur të jemi më rigoroz. Por, prapë po e them, ne dhe unë për veti e kam nënshkruar procesin, kam votuar dhe Parlamenti është ai që vendos. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Kujtim Paçaku, nga "6+!"

**KUJTIM PAÇAKU:** Faleminderit kryetar!

Pas analizës së Grupit Parlamentar "6+", ne kemi vendosur që sot në seancë të hyjmë në votim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nisma! Urdhëro, Shukrije! Regjia, Shukrije Bytyqi e ka fjalën!

SHUKRIJE BYTYQI: Faleminderit kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar Nisma për Kosovën e ka pas përfaqësuesin e saj në Komisionin ad hoc për media dhe e kanë bërë punën e vet.

E sa i përket listës apo fletës së OSBE-së, mendoj që e kanë pasur kohën t'i sjellin rekomandimet e tyre dhe të mësohen që edhe organizatat e huaja të jenë në komisionet përkatëse dhe me sugjerimet e tyre me kohë, prandaj besoj që sot duhet të shkojmë në votim, e Kuvendi është ai që vendos për anëtarët e Bordit të RTK-së.

KRYETARI: Faleminderit! Tash kemi diskutimet e deputetëve. Xhevahire Izmaqu!

XHEVAHIRE IZMAKU: Kryetar, faleminderit!

Kërkoj që të kemi edhe një sqarim shtesë. Nuk mund të diskutojmë sot ne për ndërprerje të procesit. Një është që na e kemi vetëm një ligj që e mundëson një metodë të tillë për të votuar për anëtarë të Bordit dhe transmetuesit publik. Pra, ligji thotë se Kuvendi duhet t'i zgjedhë.

Nëse e kishim pasur modelin e Maqedonisë ose Shqipërisë, Kuvendi nuk ishte marrë me këtë punë, mirëpo institucionet e ndryshme relevante në vend kishin për t'i çua përfaqësuesit e vet. Pra, ne sot nuk mund të diskutojmë se a duhet ndërprerë ose mos të ndërpresim, për arsye se shtatori nuk guxon ta zë transmetuesin publik pa bord, sepse ka shumë procese në gjysmë.

E dyta, ne kemi dhënë një premtim dhe një siguri se nuk do të shkojmë në pushim pa e përfunduar këtë edhe me raportin e MSA-s. Pra, jemi në gjysmë të rregës.

E treta, po flasim realisht edhe pse është çështje interne, votimin qysh e përcakton Komisioni, është me votim maksimal 100 poenë.

Tre kandidatë e parë i kanë marrë poenët prej të gjithë anëtarëve të Komisionit. Pra, këtu nuk është e vërtet se s'ka pasur kandidatë që s'i ka vlerësuar Vetëvendosja. 3 kandidatët e parë kanë marrë maksimumin, që do të thotë se edhe opozita i ka vendosur votat maksimale për këta kandidatë.

Ne duhet të shkojmë në votim, por nëse ju vendosni pas pauze, atëherë është diçka tjetër, mirëpo votimi duhet të kryhet sot. S'ka asnjë argument që ndërprejë këtë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka Ali Sadriu, le të përgatitet Salih Morina.

ALI SADRIU: Faleminderit zoti kryetar! Unë po habitem se nganjëherë disa veprime po i marrim me standarde të dyfishta.

Në këtë Kuvend, në raport me RTK-në kemi pasur shumë diskutime. I kemi pasur edhe dy raporte, të cilat nuk janë miratuar dhe në thelb, në rrethana të tilla, Bordi është dashur të shkarkohet. Komplet Bordi është dashur të shkarkohet!

Si dhe pse ka shkuar në riemërime të pjesërishme, unë nuk e di, por ironia më e madhe është se në këtë listë që na e keni ofruar mundësinë për votim, ka njerëz po të njëjtit bord.

Prandaj ku mbesin rekomandimet tona, ku mbesin vendimet tona, cilat janë rezultatet që i paskan ndërmarrë të kalojmë procesin, e shumë e shumë çka tjerë.

Po, të shkojmë në proces çfarë po insistohet dhe unë e kuptoj, se urgjenca është e tillë, por e keni futur në një qorrsoak.

Ne e devalvojmë punën tonë dhe reagimin tonë si Kuvend. Çfarë ndërmori Radiotelevizioni në tejkalimin e atyre problemeve që këtu i kemi diskutuar, i kemi nxjerrë rekomandime dhe vendime të caktuara.

Unë them që, pos se i ka kthyer ata dy auditorë në të vërtetë kryetarin e sindikatës dhe atë tjetër, unë nuk e kam pa asnjë veprim pozitiv që ka reaguuar në rekomandimet e Kuvendit.

Prandaj unë edhe më tutje, e pyes Kuvendin, pse nuk kërkon në realizimin e vendimit të vet, në finalizimin e tij?

**KRYETARI:** Faleminderit Ali! Urdhëro Salih!

**SALIH MORINA:** Faleminderit kryetar!

Po mendoj se ne anëtarët e Komisionit duhet të jemi më të përgjegjshëm nga vetë fakti se kemi marrë pjesë në intervistë dhe i kemi intervistuar 57 kandidatë. Procedura se si duhet të votohet, do të thotë ka qenë një procedurë e pavarur nga secili anëtar i Komisionit por nga vetë fakti se ky proces është përmbyllur me nënshkrimin e të gjithë anëtarëve të Komisionit lë të kuptohet se ne duhet të vazhdojmë sot apo duhet të fillojmë me përmbylljen e këtij procesi dhe mbetet në çështjen e deputetëve se si të votojnë për kandidatët.

Unë mendoj se ka kandidatë këtu që janë kredibilë, ka kandidatë që e kanë dëshmuar veten atë ditë në intervistë, kandidatë që kanë edhe përvojë dhe mbetet që deputetët e Parlamentit të Kosovës të vlerësojnë secilin kandidat që të jetë anëtar i Bordit duke marrë për bazë, sikur që e tha edhe kolegja deputete se i kemi do afate që ne në shtator duhet t'i zëmë këto afate dhe njëkohësisht RTK-ja duhet t'i ketë anëtarët e Bordit.

Mendoj se kjo mbetet në çështjen e deputetëve dhe unë kërkoj që votimi të bëhet pas pauze, nëse ka mundësi, se siç po shihet nuk ka as deputetë të mjaftueshëm, por kjo le të vlerësohet nga ana e udhëheqjes së Kuvendit. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Po shihet se shumica e grupeve parlamentare të procedohet sot. Realisht, ndoshta do të ishte mirë me OSBE-në paraprakisht për të qenë të marrë vesh.

*(Ndërhyrje)*

Po, na shkojmë, por kjo është. A doni para pauze apo pas pauze votimin? Tash! Atëherë, të përgatitemi.

## **6. Zgjedhja e 5 anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës**

Komisioni ad hoc e ka shqyrtuar nominimin a kandidatëve për anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës dhe Kuvendit i ka paraqitur rekomandimin për miratim.

E ftoj kryetaren e Komisionit ad hoc zonjën Xhevahire Izmaqu që ta arsyetojë rekomandimin.

**XHEVAHIRE IZMAKU:** Faleminderit kryetar!

Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të RTK-së, në bazë të neneve 67 dhe 71 të Rregullores së Kuvendit si dhe të nenit 26 të Ligjit për Radiotelevizionin e Kosovës, në mbledhje e mbajtur me datën 20.7.2015, pas shqyrtimit të biografive dhe intervistimit të kandidatëve për anëtarë të Bordit, vendosi që Kuvendit t'ia paraqet këtë rekomandim:

I rekomandohet Kuvendit të Republikës së Kosovës të bëjë emërimin e 5 anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës me votim të fshehtë.

Për 4 pozita për anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, nga radhët e komunitetit shumicë shqiptar, propozohen për votim 8 kandidatë si në vijim:

- Hasan Salihu;
- Hisen Berisha,
- Ismet Bexheti,
- Lirim Geci,
- Muharrem Shahini,
- Mimoza Hasani-Pllana,
- Mustaf Halili, dhe
- Fehmi Ajvazi.

Kuvendi pra bën përzgjedhjen e 4 kandidatëve - anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga ky propozim prej 8 anëtarëve.

Për 1 pozitë të anëtarit të Bordit nga radhët e komunitetit serb, propozohen për votim 2 kandidatë si në vijim:

- Ivan Velković, dhe
- Spasoje Cvetković.

Kuvendi po ashtu bën përzgjedhjen e njërit prej këtyre 2 kandidatëve.

Anëtarët e Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës të emërohen me mandat trevjeçar.

Anëtarët e këtij bordi, pra emërohen nga Kuvendi i Kosovës në bazë të nenit 26 të Ligjit për Radiotelevizionin e Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë, me mirëkuptimin tuaj, e patëm pothuaj se qëndrimin e çdo grupi parlamentar. Do të kishim shkuar drejt për ta krijuar komisionin votues, nëse pajtoheni? Urdhëro profesor!

SABRI HAMITI: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Para se të procedohet, unë ndiej nevojë t'i them dy fjalë për shkak se ekziston një histori e bisedimeve rreth bordeve të natyrave të ndryshme po edhe rreth Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës për të cilin në vazhdimësi, sa herë i zgjedhim, bëjnë bisedime të natyrave edhe profesionale edhe politike.

Kjo që misioni i OSBE-së e shkruan një letër, mua as që më shqetëson asnjë fije, as s'më thotë kurrëgjë të re, sepse ata veç se kanë përsëritur të njëjtat gjëra që i përsëritin edhe komisionet tona ad-hoc dhe ne këtu që themi duhen njerëz profesional e kredibël, me integritet. Këto janë formula universale që cilin ta pyesni këtu thotë problemi është kush çka percepton me ato fjalë. Domethënë, nuk i jep rëndësi të veçantë.

E dyta. Duhet të thuhet saktësisht çka po ndodhë. Është dashur të informohet që 5 anëtarëve u kalon mandati. Ata 5 anëtarë janë: Fadil Bajraktari, Ismet Bexheti, Ivan Velkoviç, Majlinda Hajrullahu dhe Rrahman Paçarizi. Kjo i bie që këta e kanë krye një mandat.

E dyta. Kanë mbetur anëtarë Bordi, dhe le të thuhet kush janë. Sepse, këtu po flitet, por harrohet kush është. Në mandat janë zgjedhur me 24 dhe 30 janar të vitit 2013 2 anëtarë, e këta janë: Besa Bytyqi dhe Faton Mehmetaj.

Tutje. Me 2 maj 2013 është emëruar edhe 1 anëtar i Bordit nga radha e komuniteteve jo shumicë, e ky është Elif Tokmak.

Tutje! Kuvendi më 15 nëntor 2013 i ka zgjedhur edhe 2 anëtarë, e këta janë: Naime Beqiraj dhe Afërdita Maliqi.

Shkurt i bie që në funksion tash për tash mbeten: Faton Bytyqi, Besa Bytyqi, Faton Mehmetaj, Elif Tokmak, Naime Beqiraj, Afërdita Maliqi.

Unë nuk kam arsye të vlerësoj Komisionin ad hoc, sepse ata janë përfaqësues të komisioneve dhe të grupeve tona, e është punë e tyre dhe kriteret e tyre çfarë kanë dhënë, dhe ne proceduarlisht jemi në rregull.

Por, unë duhet të bëjë dy vlerime të cilat duhet të thuhet në këtë seancë. Është bërë modë që njerëzit që e kanë gojën plot autenticitet, integritet dhe përfaqësim profesional që biografite në Kuvendin e Republikës së Kosovës t'i bie në anglisht.

Le ta harrojnë! Ky është abuzim! Ne gjuhën zyrtare, që është shqipja në Kosovë, kurrfarë kredibiliteti ose kredie nuk marrin që nuk tregojnë në shqip ku kanë lind dhe unë mendoj që çfarëdo anëtar bordi që konkurron në Kuvend më mos t'i pranohen dokumentet, se janë të pavlefshme nëse nuk shkruhen në gjuhët zyrtare. Le ta mësojnë dhe le ta kenë detyrim. Ai është detyrim ligjor. Nuk janë rregull.

E dyta, humbesh nëpër dokumentacion duke lexuar gjithfarë dëshmish për treningje njëditore, dyditore, fleta dhe njeriu e humbë një gjysmë ore deri sa ta gjejë shkollimin, që po quhet profesional fundamental, që është themelor dhe substancial për çfarëdo njeriu që pretendon të jetë profesionist.

Këta njerëz i fshehin diplomat për t'i treguar trajnimet. Kjo është një sëmundje e keqe. E di qysh ka ardhur, është një decenie që mbushamendja publike ushtrohet me këto far dëftesash të treningjeve dhe për mua s'thonë bash kurrigjë hiq,po ne i kemi këtu.

Dhe e fundit, nga kjo që unë kam lexuar si një njeri që i njeh pak problemet e zanatit e të komunikimeve te ne dhe situatën tonë, po është e vërtet se brenda kësaj liste prej 8 vetësh, dhe unë po flas për 8 shqiptarë sepse kandidatët, përfaqësuesit serbë që konkurrojnë nuk i njoh, ka anëtarë konkurrent shumë të mirë, pakicë e vogël janë, por emra s'po përmendi, dhe kush i lexon duhet ta dijë, ka që janë shumë të mirë për këtë punë, ka që janë edhe në këtë listë që janë boll të ligisht për këtë punë.

Ky është mendimi im, dhe emrat nuk i thashë, për të mos sugjeruar asgjë. Deputetët e kanë në dorë, vota është e fshehtë, le të votojnë. Po unë, nuk munda, zotëri kryetar edhe kolegë deputetë për pa i nënvizuar këto dy-tri çështje, dhe po përsëris edhe një herë:

Kërkoj, dhe e kemi edhe sekretarin këtu, që janë detyrim ligjor dokumentet, e tani le t'i shkruajnë këta edhe japonisht nëse duan, është problem i tyre, por shqip është detyrim ligjor që të shkruhen dokumentet kur konkurrojnë, në gjuhën zyrtare. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit, Profesor!

Ma nuk do të vijmë kaq letra kur vijmë, vijmë më pak në qoftë se i kërkon pastaj ne ja bashkangjesim edhe po harxhojmë shumë letra të njëjtën kohë. Shqipe Pantina, e ka fjalën para se të shkojmë në procedim. Urdhëro!

**SHQIPE PANTINA:** Unë po dua me mbështetë fillimisht atë që tha deputeti Sabriu, qëndron komplet, prapë po them ne e kemi ngritë disa herë, RTK-ja nuk është hera e parë që po diskutojmë edhe jemi bindë duke i votua unanimisht pa asnjë votë kundër rekomandimet se si të nxirret ky institucion nga kriza. Ajo çka po bëjmë është po o qojmë hala më thellë në krizë.

Prandaj Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” nuk do të marrë pjesë fare në votim për të legjitimua këtë proces i cili e theksoj e thellon hala më shumë institucionin e RTK-së në krizë, kështu që ne as nuk nominojmë kandidatë për Komision.

**KRYETARI:** A patëm qëndrim më të prerë të Lëvizjes “Vetëvendosje”? Ne mund të shkojmë në procesin votues drejtpërdrejt për krijimin e Komisionit e për votim në qoftë se e vendosim të votojmë duhet të qëndrojmë pastaj rreth një orë e gjysmë deputetë.

Atëherë, shkojmë për zbatimin e procedurës të votimit të fshehtë kërkohet krijimi i një Komisioni votues me përbërje nga një deputet prej secilit grup parlamentar me mbështetje të zyrtarëve të Administratës.

Ftoj përfaqësuesit e grupeve parlamentare që të propozojnë nga një anëtarë për komisionin votues. PDK-ja, Adem.

ADEM GRABOVCI; Ne propozojmë anëtar të Komisionit Nezir Çoçajn.

TEUTA SAHATQIJA: LDK-ja propozon, deputetin Salih Morina, për anëtarë të Komisionit ad hoc.

KRYETARI: Slavko Simiq, nga Lista serbe, urdhëro!

SLAVKO SIMIĆ: Mi predlažemo Adema Hodžu.

KRYETARI: Atëherë, Nisma.

SHUKRIJE BYTYQI: Anëtare e Komisionit do të jem unë Shkukrije jBytyqi.

KRYETARI: Faleminderit! “6+”. Myfera Serbica Shinik.

MÛFERA ŞINIK: “6+” parlamentar grubu Kujtim Paqaku.

KRYETARI: Faleminderit! Lus deputetët që me ngritje dore të deklarohen për Komisionin votues. Sa deputetë i kemi në sall.

Kemi numër të mjaftueshëm të deputetëve, 64 deputetë. Me ngritje formale të dorës deklarohemi për Komisionin votues. A ka kush kundër veç, s’ka nevojë për hiq, veç kundër a është dikush. Askush, aprovohet Komisioni votues.

Emërohen. Lus Komisioni që të filloj me procedim, ndërsa deputetët do të votohen të votojnë sipas listës. Anëtarët e Komisionit të marrin vendet edhe i thërras më së pari të Komisionit funksional të cilët do të na sjellin rekomandimin për Legjislacion. Vijnë me votua. Zëni vendet, anëtarët e Komisionit, t’i thërras menjëherë deputetët.

Selvije Halimi, Danush Ademi, Doruntinë Maloku, Donika Kada Bujupi, Agim Aliu, Agim Ademaj, Milena Miliqeviq, Nezir Çoçaj, Armend Zemaj. Janë anëtarët e Komisionit Funksional për Legjislacion se kanë punë i thirrëm të parët, pastaj vazhdojmë me të tjerët.

Adem, Nezir Çoçaj duhet të shkoj në Komision, a ka mundësi PDK-ja me zëvendësua Nezirin, anëtar të Komisionit. Adem a na propozon një tjetër, Bekim Haxhiu, në vend të Nezir Çoçaj. Deklarim duhet, a ka kundër dikush? Nuk ka. Propozohet Nezir Çoçaj për anëtar të komisionit.

Adem Grabovci, Adem Hoxha, Adem Salihaj, Agim Ademaj, Agim Aliu, Agim Çeku, Agim Kikaj, Aida Dërguti, Albin Kurti, Albulena Haxhiu, Ali Sadriu, Alma Lama, Anton Quni, Arben Gashi, Armend Zemaj, Azem Sylja, Bali Muharremaj, Bardhyl Meta, Elmi Reqica, Bekim Haxhiu, Besa Baftiu, Besa Gaxherri, Besim Beqaj, Besnik Bislimi, Muhamet Mustafëa, Blerim Grainca, Blerim Shala, Blerta Deliu-Kodra, Bojan Mitiq, Qerim Bajrami, Danush Ademi, Daut Haradinaj, Donika Kadaj Bujupi, Doruntinë Maloku, Duda Blaje, Elmi Reçica, Emilija Rexhepi,

Enver Hoti, Ethem Arifi, Fadil Beka, Fadil Demaku, Fatmir Limaj, Fatmir Rexhepi, Faton Topalli, Fikrim Damka, Fisnik Ismajli, Flora Brovina, Ganimete Musliu, Gezim Kelmendi, Glauk Konjufca, Hajdar Beqa, Hatim Baxhaku, Haxhi Shala, Ilir Deda, Ismajl Kurteshi, Ismet Beqiri, Jasmina Zhivković, Jelena Bontiq, Kadri Veseli, Kujtim Paçaku, Labinotë Demi-Murtezi, Lahi Brahimaj, Latif Gashi, Lirije Kajtazi, Luljeta Veselaj, Margarita Kadriu, Melihate Tërmkollu, Mexhide Mjaku, Milazim Haliti, Milena Miliçević, Millka Vuletiq, Mufera Shinik, Muhamet Mustafëa, Murat Hoxha, Mytahir Haskuka, Naim Fetahu, Nait Hasani, Naser Osmani, Nenad Rashiq, Nezir Çoçaj, Njomza Emiri, Nuredin Ibishi, Nuredin Lushtaku, Pal Lekaj, Puhije Demaku, Rafet Rama, Raif Qela, Ramiz Kelmendi, Ramush Haradinaj, Rexhep Selimi, Rrustem Berisha, Rrustem Mustafëa, Sabri Hamiti, Sadri Ferati, Safete Hadërgjonaj, Sala Shala-Berisha, Salih Morina, Salih Salihu, Salihe Mustafëa, Sasha Milosavleviq, Selvije Halimi, Shaip Muja, Shpejtim Bulliqi, Shqipe Pantina, Shukrije Bytyqi, Slavko Simiq, Slobodan Petroviq, Synavere Rysa, Teuta haxhiu, Teuta Rugova, Teuta Sahatqija, Time Kadrijaj, Valdete Bajrami, Veton Berisha, Visar Ymeri, Vjosa Osmani, Xhavit Haliti, Xhevahire Izmaku, Zafir Berisha, Zenun Pajaziti.

KRYESUESI: Regjia, fjalën edhe mikrofonin!

BEKIM HAXHIU: Fillojmë me procesin e numërimit të votave të votimit.

Hysen Berisha, Lirim Geci, Muharrem Shahini, Mustafë Halili.

Hysen Berisha, Ismet Bexheti, Lirim Geci. Ivan Veljković, ndërsa kjo për komunitetin serb nuk e ka votua fare këtë tjetrin.

Hasan Salihu, Ismet Bexheti, Muharrem Shahini, Fehmi Ajazi dhe Ivan Veljković.

Hasan Salihu, Hysen Berisha, Ismet Bexheti, Fehmi Ajazi, te komuniteti serb nuk ka votuar fare.

Hasan Salihu, Ismet Bexheti, Mimoza Hasani-Pllana, Spasoje Cvetković.

Hysen Berisha, Lirim Geci, Mimoza Hasani – Pllana, Mustafë Halili, te komuniteti serb s'ka votuar fare.

Hysen Berisha, Ismet Bexheti, Lirim Geci, Mimoza Hasani, te komuniteti serb nuk ka votuar.

Muharrem Shahini, Ivan Veljković,

Hysen Berisha, Mimoza Hasani-Pllana, Mustafë Halili, Ivan Veljković.

Ismet Bexheti, Lirim Geci, Mimoza Hasani-Pllana, Fehmi Ajazi, Ivan Veljković.

Hysen Berisha, Ismet Behxheti, Muharrem Shahini, Mimoza Hasani-Pllana, te komuniteti serb s'ka votuar.

Lirim Geci, Muharrem Shahini, Mimoza Hasani-Pllana, Fehmi Ajvazi, Ivan Veljković.

Hysen Berisha, Ismet Behxheti, Lirim Geci, Mimoza Hasani-Pllana, Ivan Veljković.

Hysen Berisha, Ismet Behxheti, Lirim Geci, Mimoza Hasani-Pllana, Ivan Veljković.

Hysen Berisha, Muharrem Shahini, Mimoza Hasani-Pllana, Mustafë Halili, Ivan Veljković.

Ismet Behxheti, Lirim Geci, Muharrem Shahani, Mimoza Hasani-Pllana, te komuniteti nuk ka votuar.

Hysen Berisha, Ismet Behxheti, Lirim Geci, Ivan Veljković.

Ismet Behxheti, Lirim Geci, Mimoza Hasani-Pllana, Fehmi Ajvazi, te komuniteti serb nuk ka votuar.

Hysen Berisha, Muharrem Shahini, Mustafë Halili, te komuniteti serb nuk ka votuar.

Hysen Berisha, Ismet Behxheti, Mimoza Hasani – Pllana, Mustafë Halili, te komuniteti serb nuk ka votuar.

Hysen Berisha, Ismet Behxheti, Muharrem Shahinni, Mustafë Halili, te komuniteti serb nuk ka votuar.

Hasan Salihu, Lirim Geci, Muharrem Shahini, Mimoza Hasani-Pllana, Ivan Veljković.

Ismet Behxheti, Lirim Geci, Mimoza Hasani-Pllana, Fehmi Ajvazi, Ivan Veljković.

Hysen Berisha, Lirim Geci, Muharrem Shahini, Mimoza Hasani Pllana, te komuniteti serb nuk ka votuar.

Hysen Berisha, Ismet Behxheti, Lirim Geci, Mimoza Hasani – Pllana, te komuniteti serb nuk ka votuar.

Hasan Salihu, Hysen Berisha, Lirim Geci, Mimoza Hasani-Pllana, te komuniteti serb nuk ka votuar.

Hasan Salihu, Hysen Berisha, Muharrem Shahini, Mimoza Hasani-Pllana, Ivan Veljković.

Hasan Salihu, Ismet Behxheti, Muharrem Shahini, Mimoza Hasani-Pllana, te komuniteti serb nuk ka votuar.

Hysen Berisha, Mimoza Hasani-Pllana, Fehmi Ajvazi, Ivan Veljković.

Ismet Behxheti, Lirim Geci, Mimoza Hasani-Pllana, Fehmi Ajvazi, Ivan Veljković.

Hysen Berisha, Mustafë Halili, të tjerët s'i ka votuar.

Ismet Behxheti, Lirim Geci, Mimoza Hasani-Pllana, Fehmi Ajvazi, te komuniteti nuk ka votuar.

Hysen Berisha, Ismet Behxheti, Lirim Geci, Mimoza Hasani-Pllana, Ivan Veljkoviq.

Hysen Berisha, Ismet Behxheti, Lirim Geci, Ivan Veljkoviq.

Hysen Berisha.

Lirim Geci, Ivan Veljkoviq.

Hysen Berisha, Lirim Geci, Muharrem Shahini, Mimoza Hasani-Pllana, te komuniteti serb nuk ka votuar.

Hasan Salihu, Ismet Behxheti, Muharrem Shahini, Mimoza Hasani-Pllana, Ivan Veljkoviq.

Hysen Berisha, Ismet Behxheti, Lirim Geci, Mustafë Halili, te komuniteti serb nuk ka votuar.

Hasan Salihu, Ismet Behxheti, Mimoza Hasani-Pllana, Fehmi Ajvazi, Ivan Veljkoviq.

Asllan Salihu, Ismet Behxheti, Lirim Geci, Fehmi Ajvazi, Ivana Velkoviq.

Hysen Berisha, Ismet Behxheti, Mimoza Hasani-Pllana, të komuniteti serb, nuk ka votuar.

Hasan Salihu, Hysen Berisha.

Hysen Berisha, Ismet Behxheti, Lirim Geci, Mimoza Hasani-Pllana, Ivan Velkoviq.

Hysen Berisha, Muharrem Shahini, Mimoza Hasani-Pllana, Mustafë Halili, Ivan Velkoviq.

Ismet Behxheti, Lirim Geci, Mimoza Hasani-Pllana, këto tjerat, s'i ka votuar.

Ismet Behxheti, Lirim Geci, Mimoza Hasani-Pllana, Fehmi Ajvazi, Ivan Velkoviq.

Hysen Berisha, Ismet Behxheti, Lirim Geci, Mustafë Halili, te komuniteti nuk ka votuar.

KRYESUESI: Regjia, kyçeni mikrofonin, se gabimisht e fikët!

BEKIM HAXHIU: Hasan Salihi, Hysen Berisha, Ismet Behxheti, Lirim Geci, te komuniteti serb nuk ka votuar.

Hysen Berisha, Ismet Behxheti, Lirim Geci, Fehmi Ajvazi, Ivan Velkoviq.

Hysen Berisha, Ismet Behxheti, Muharrem Shahini, Mimoza Hasani-Pllana, Ivan Velkoviq.

Ismet Behxheti, Lirim Geci, Muharrem Shahini, Mimoza Hasani-Pllana, te komuniteti serb nuk ka votuar.

Hysen Berisha, Ismet Behxheti, Lirim Geci, Mimoza Hasani-Pllana, te komuniteti serb nuk ka votuar.

Hysen Berisha, Ismet Behxheti, Lirim Geci, Fehmi Ajvazi, te komuniteti serb nuk ka votuar.

Hasan Salihu, Hysen Berisha, Lirim Geci, Mimoza Hasani-Pllana, Ivan Velkoviç.

Hysen Berisha, Lirim Geci, Mimoza Hasani-Pllana, Mustafë Halili, te komuniteti serb nuk ka votuar.

Këtu, është votuar Hysen Berisha dhe Mustafë Halili, jo tjerët.

Hasan Salihu, Hysen Berisha, Ismet Behxheti, Lirim Geci, te komuniteti serb nuk ka votuar.

Ismet Behxheti, Lirim Geci, Mimoza Hasani-Pllana, Fehmi Ajvazi, te komuniteti serb nuk ka votuar.

Këtu ka votuar vetëm Hysen Berishën.

Hasan Salihu, Ismet Behxheti, Muharrem Shahini, Fehmi Ajvazi, Ivan Velkoviç.

Hasan Salihu, Hysen Berisha, Mimoza Hasani-Pllana, Fehmi Ajvazi, Ivan Velkoviç.

Ismet Behxheti, Lirim Geci, Muharrem Shahini, Fehmi Ajvazi, Ivan Velkoviç.

Hysen Berisha, Ismet Behxheti, Lirim Geci, Mimoza Hasani-Pllana, Ivan Velkoviç.

Hasan Salihu, Hysen Berisha, Muharrem Shahini, Mustafë Halili, Ivan Velkoviç.

Hasan Salihu, Lirim Geci, Muharrem Shahini, Mimoza Hasani-Pllana, Ivan Velkoviç.

Hysen Berisha, Ismet Behxheti, Fehmi Ajvazi, Ivan Velkoviç.

Hysen Berisha, Ismet Behxheti, Lirim Geci, Mustafë Halili, te komuniteti serb nuk ka votuar.

Ismet Behxheti, Mimoza Hasani-Pllana, Ivan Velkoviç.

Hysen Berisha, Ismet Behxheti, Lirim Geci, Muharrem Shahini, te komuniteti serb nuk ka votuar.

Hysen Berisha, Lirim Geci, Muharrem Shahini, këtu, si duket janë 1, 2, 3, 4, 5.

Pesë i ka, katër ka pas të drejtë t'i votojë. Është e pavlefshme sepse ka votuar më shumë kandidatë. Pra, ka më shumë kandidatë, kurse te komuniteti serb, nuk ka votuar fare.

Hasan Salihu, Hysen Berisha, Lirim Geci, Mustafë Halili, te komuniteti serb nuk ka votuar.

Hysen Berisha, Lirim Geci, Muharrem Shahini, Mimoza Hasani-Pllana, te komuniteti serb nuk ka votuar.

Hasan Salihu, Hysen Berisha, Ismet Behxheti, Mimoza Hasani-Pllana, te komuniteti serb nuk ka votuar.

Hysen Berisha, Ismet Behxheti, Lirim Geci, Fehmi Ajvazi, Ivan Velkoviç.

Ka votuar vetëm Mimoza Hasani-Pllana.

Hysen Berisha, Lirim Geci, Muharrem Shahini, Mimoza Hasani-Pllana, Ivan Velkoviç.

Mimoza Hasani-Pllana, Ivan Velkoviç.

Hysen Berisha, Ismet Behxheti, Lirim Geci, Ivan Velkoviç.

Hasan Salihu, Ismet Behxheti, Mimoza Hasani-Pllana, Ivan Velkoviç.

*(Ndërprerje e incizimit)*

**KRYESUESI:** Urdhëro, zoti Haxhiu!

**BEKIM HAXHIU:** I nderuar nënkryetar i Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni votues, pas procedurës së votimit të fshehtë dhe numërimit të votave të deputetëve të Kuvendit për zgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, në mbledhjen plenare të mbajtur me 30 korrik 2015, konstaton sa vijon:

Në votim kanë marrë pjesë 80 deputetë. Të pavlefshme është 1 votë.

Votat e fituara për kandidatët e propozuar nga radhët e komunitetit shqiptar, janë si vijon:

Hasan Salihu, ka fituar 22 vota;

Hysen Berisha i ka fituar 55 vota;

Ismet Behxheti i ka fituar 47 vota;

Lirim Geci i ka fituar 42 vota;

Muharrem Shahini i ka fituar 25 vota;

Mimoza Hasani-Pllana i ka fituar 48 vota;

Mustafë Halili i ka fituar 16 vota;

Fehmi Ajvazi i ka fituar 18 vota.

Votat e fituara për kandidatët e propozuar nga radhët e komunitetit serb, janë si në vijim:

Ivan Velkoviç i ka fituar 39 vota;

Spasoje Cvetkoviç e ka fituar 1 votë.

Prandaj, në bazë të rezultateve të votimit, në pajtim me nenin 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 26 të Ligjit Numër 04/L-46 për Radiotelevizionin e Kosovës dhe nenin 51 të Rregullores së Kuvendit, konstatohet se:

Hysen Berisha, Mimoza Hasani-Pllana, Ismet Behxheti dhe Lirim Geci, nga komuniteti shumicë shqiptar - janë zgjedhur anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.

Ndërsa nga komuniteti serb nuk ka fituar asnjëri.

Zgjedhja e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës është me mandat trevjeçar, ndërsa për komunitetin serb duhet të përsëritet konkursi.

Prishtinë, 30 korrik 2015. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Shkojmë në pauzë deri në orën 16:00.

\* \* \*

*Vazhdimi i mbledhjes plenare, pas pauzës*  
*Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli*

KRYETARI: Të nderuar deputetë,  
Duke ju falënderuar Qeverisë, mund të vazhdon punimet seanca plenare.

Vazhdojmë me pikat e radhës:

**- Shqyrtimi i parë i Projektligjit numër 05/1-050 për kinematografinë**

Komisioni Funkcional në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ja ka rekomanduar miratimin e tij.

Ftoj ministrin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit zoti Kujtim Shala që para deputetëve të Kuvendit ta prezantoj dhe arsyetoj projektligjin. Urdhëro, zoti zëvendëskryeministër!

MINISTRI KUJTIM SHALA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Me qëllim të krijimit të kushteve më të mira për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e kinematografisë, krijimin dhe mbrojtjen e trashëgimisë kinematografike si dhe me qëllim të avancimit të legjislacionit të kësaj fushe Ministra e Kulturës, Rinisë dhe sportit mbetet e përkushtuar që të punoj në këtë drejtim.

Me këtë projektligj trajtohen kushtet e veprimtarisë, organizimi, financimi, prodhimi, pastaj distribuimi dhe shfaqja e veprave kinematografike si dhe bashkëpunimi ndërkombëtarë, mbështetja e krijimtarisë dhe promovimi i kinematografisë, mbrojtja e trashëgimisë kinematografike të Kosovës si dhe fuqizimi e përkrahja e aktiviteteve kinematografike përmes subvencionimit.

Ky projektligj përcakton që përmes subvencionimit të mbështetet zhvillimi i krijimtarisë kinematografike, krijimi i kushteve për prodhimin e filmave vendorë dhe bashkëprodhimi ndërkombëtarë.

Po ashtu me këtë projektligj përcaktohen bazat dhe parimet e zhvillimit të kinematografisë, formës të shprehurit artistik duke udhëhequr nga parimi i mbrojtjes së të drejtave të shprehjes së lirë, mbrojtjes së të drejtave dhe interesave të publikut, mbrojtjes së fëmijëve dhe të rinjve si dhe mbrojtjes së të drejtave të pronësisë intelektuale në fushën e kinematografisë.

I njëjti ligj rregullon veprimtarinë kinematografike dhe në veçanti merr parasysh promovimin e identitetit kulturorë të Kosovës në kontestin evropian dhe më gjerë në përputhje me parimet e diversitetit në të gjitha rrafshet.

Dispozitat e këtij projektligji janë të ndërlidhura me objektivat dhe prioritetet e Qeverisë, për përkrahjen dhe zhvillimin afatgjatë të fushës së kinematografisë.

Konkretisht nëpërmjet këtij projektligji synojmë të rregullojmë kornizën ligjore e cila është e domosdoshme për krijimin e një bashkëpunimi të qëndrueshëm ndërmjet .. dhe institucioneve relevante.

Ky projektligj përmban në masë të konsiderueshme praktikatat më të mira të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian dhe është harmonizuar me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Projektligji në fazën e hartimit të tij është konsultuar me producent, regjisor, aktor dhe grupe tjera të interesit të fushës së kinematografisë të cilët kanë ndihmuar gjatë gjitha fazave të hartimit.

Dhe, unë dua që edhe një herë t'i falënderoj të gjithë këtu.

Të nderuar deputetë,

Më lejoni të theksoj se ky projektligj krijon kosto financiare për vitet 2016-2018 në shumën prej 2 milionë e 600 mijë euro, të cilën .. ministria e ka planifikuar në kornizën buxhetore 2016-2018.

Sipas Departamentit të Buxhetit kjo kosto e paraqitur në vlerësim është e përbalueshme dhe nuk pritet të krijoj pengesa gjatë zbatimit.

Duke pasur parasysh rënduesin që ka ky Projektligj për fushën e kinematografisë unë ju ftoj që ta votoni sot atë në parim. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Pas këtij prezantimi të këtij projektligji.

Të nderuar deputetë,

E hapim diskutim në parim. E ftoj në rend të parë kryetarin e Komisionit FunkSIONAL për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport, zoti Nait Hasani, ta marrë fjalën.

**NAIT HASANI:** Faleminderit, kryetar!

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport ka analizuar Projektligjin për kinematografinë, ka shqyrtuar dhe Kuvendit i prezantohen në bazë të Rregullores të nenit 56, paragrafi 2, Komisioni FunkSIONAL para shqyrtimit të parë të projektligjit në mbledhjet plenare shqyrton në parim.

Komisioni pas shqyrtimit në parim të Projektligjit për kinematografisë vlerëson se projektligji i plotëson kushtet e parapara në nenin 54 të Rregullores dhe i rekomandon Kuvendit për miratimin në parim.

Neve na kanë ardhur edhe vërejtje tjera të cilët i kemi marrë dhe gjatë amendamentimit të projektligjit do t'i plotësojmë dhe do ta përcjellim më tutje. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Tani radhën e kanë përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Bekim Haxhiu, nga Partia Demokratike e Kosovës.

**BEKIM HAXHIU:** Faleminderit, i nderuar kryetar!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës i jep mbështetje të fuqishëm në parim Ligjit për kinematografinë, duke vlerësuar se një ligj me rëndësi i cili do të krijoj mundësinë e investimeve edhe të kapitalit privat, por edhe një bashkërendim me mbrojtjen e vlerave të trashëgimisë kulturore nga kinematografia.

Prandaj, ministrin e përgëzojmë për punën dhe besoj që në dëgjimet e ardhshme publike do bashkë rendohemi dhe do të bëjmë një ligj shumë të mirë.

KRYETARI: Faleminderit! Salih Morina, nga Lidhja Demokratike e Kosovës.

SALIH MORINA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar Kabinet qeveritarë, zëvendëskryeministër,

Kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike ka shqyrtuar dhe ka analizuar këtë projektligj dhe në parim ne e mbështesim, është një projektligj i një rëndësie të veçantë edhe për ministrinë por njëkohësisht edhe për Qendrën Kinematografike dhe vetë KINA-ASTET.

Prandaj, ky ligj mund të pësoj ndryshime në ndonjë nen duke u marrë për bazë gjithmonë nga Shoqata e KINA-asve që në këtë rast do të japin kontribut gjatë leximit të dytë, por ligji në parim do të thotë i plotëson të gjitha kriteret dhe japim mbështetje të plotë dhe ftoj deputetët e Parlamentit të Kosovës që ta votojnë këtë projektligji. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ismajl Kurteshi, nga Lëvizja “Vetëvendosje”

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit,!

Edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” e ka shqyrtuar Projektligjin për kinematografinë dhe është pajtuar ta përkrahë në parim në lexim të parë me kusht që brenda dy leximeve të organizohet një debat publik me të gjithë të interesuarit për këtë ligj. Po ashtu të aprovohen propozimet e komunitetit të artistëve të kësaj fushe specifike të cilat përfaqësues të komunitetit të lartpërmendur i kanë prezantuar para Komisionit për Arsim dhe Kulturë e me këto propozime të komunitetit të artistëve të cilat i kemi marrë edhe në formë të shkruar anëtarët e Komisionit janë pajtuar.

Përndryshe projektligji kështu siç është lenë shumë për të ndryshuar dhe nuk i plotëson nevojat që do të duhej t’i plotësonte ky projektligj me gjithat për lexim të parë ne e përkrahim dhe presim përkrahjen e ndryshimeve që na vijnë nga komuniteti i artistëve. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Duda Balje, nga “6+”.

DUDA BALJE: Parlamentarna grupa „6+“ je razmatrala Nacrt zakona o kinematografiji i podržace isti, svoj doprinos dace kroz rad u parlamentarnih komisiji.

KRYETARI: Shukrije Bytyqi, nga “Nisma”.

SHUKRIJE BYTYQI: Faleminderit, kryetar!

Grupi Parlamentar “Nisma për Kosovën” e ka shqyrtuar Projektligjin për kinematografinë dhe e përkrahë në parim. Ndërsa kontributin tonë do ta japim gjatë amendamentimit. Faleminderit!

KRYETARI: Nga grupet parlamentare nuk kemi tjetër deklaram, Lista serbe a ka ndonjë deklaram? Jo! Ok-ej.

Atëherë i kemi dy deputetë të paraqitur për diskutim për çështjen e kinematografisë. Raif Qela dhe të bëhet gati Glauk Konjufca.

RAIF QELA: Të nderuar deputetë,  
I nderuari ministër,

Ky projektligj është në shumicën e çështjeve më i përparuar se ligji pararendës. Prandaj edhe në parim mendoj se duhet përkrahur. Por se në njërin nga fushat është prapakthim. Pavarësisht se ligji i kaluar ishte shumë i kritikuar nga krijuesit e artit kinematografikë nga film bërësit, megjithatë kishte një minimum hapësire për vendimmarrje edhe pse jo të kënaqshme të organizatave të pavarura të film bërësve siç është Unioni i Artistëve të Filmit e të tjera.

Fatkeqësisht ky ligj i propozuar as atë hapësirë të vogël nuk ua ka lejuar duke hequr fare zërin e tyre në vendimmarrje në organizatat siç janë Bordi i Qendrës Kombëtare të Kinematografisë, apo në komisionet përzgjedhëse.

Mendoj se kjo çështje duhet të adresohet me amendament të posaçëm. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Glauk, fjala për ju.

GLAUK KONJUFCA: Deputetë të nderuar të Kuvendit të Kosovës,  
Është mjaftë shqetësuese fakti që lidhur me këtë ligj komuniteti i gjerë i artistëve nga fusha e filmit sidomos pjesë të cilën e rregullon ky ligj dhe me të cilin merret specifikisht, kanë dyshimet e tyre të bazuara se ky ligj nëse nuk përfshihen vërejtjet e tyre shumë themelore dhe substanciale atëherë do të ishte ligj më i keq se ai i vitit 2004. Nëse nuk përfshihen vërejtjet e tyre dhe ne i kemi takuar ata dhe vërejtjet e tyre janë në një tekst që i përmban 11 faqe, janë vërejtje të konsiderueshme të cilat duke filluar prej nga përkufizimi i filmit si produkt vendor, pra vepra kinematografike vendore. Duke kaluar nëpër ushtrimin e veprimtarisë, prodhimin, distribuimin, shfaqjen publike, pastaj vizionimin e veprës kinematografike, kushtet e shfaqjes së filmave, pastaj këshilli drejtues i Qendrës Kinematografike të Kosovës, mënyra qysh përpilohet statuti i kësaj qendre e kështu me radhë, janë dhjetëra e dhjetëra ndërhyrje që i kanë kërkuar ata që të ndodhin dhe ky komunitet mos të harrojmë janë takuar edhe me komisionin përkatës.

Mos të harrojmë në gjë, komuniteti i artistëve nga fusha e filmit është pajtuar që ky ligj të kalohet në këtë mënyrë vetëm me faktin që shumica e deputetëve në Komisionin përkatës janë pajtuar që kushtet e tyre dhe vërejtjet e tyre të përfshihen gjatë shqyrtimit të ligjit.

Pra, ky komunitet është pajtuar vetëm me këtë kusht që t’i japë mbështetje që të kaloj në lexim të parë ky ligj kështu siç është i shkruar. Por nëse ndodhë që ata janë mashtruar dhe vërejtjet e tyre nuk përfshihen së paku 80 apo 90% e vërejtjeve që unë po i shoh të shkruara këtu e kam një tekst 11 faqesh këtu me përplot ndërhyrje që duhet t’i ketë ligji, atëherë mendoj që kjo do të ishte

shumë keq për Kuvendin e Republikës së Kosovës sepse këtij komuniteti, komisioni në fjalë i ka premtua se do t'i përfshijë po thuaj se të gjitha kërkesat që i kanë pasur ata.

Tash një çështje tjetër të cilën dua ta prekë është puna e Kosova-filmit. Ju e dini që Kosova-filmi është trajtua si një ndërmarrje shoqërore e cila i përket AKP-së dhe e cila është pasdefinuar edhe në vitin 2004 me Ligjin e kaluar për kinematografinë, në atë ligj Kosova-filmi përmendet në dy nene mirëpo tash me këtë ligjin këtu në një farë mënyre Kosova-filmi nuk përmendet fare.

Disa prej arsytimeve të Qeverisë kanë qenë që Kosova-filmi tashmë është bërë një farë forme e arkivit, arkivit kinematografik për shkak se ka qenë një farë institucioni që në të kaluarën i ka prodhura gjithë filmat që janë prodhura në Kosovë.

Mirëpo, një shqetësim shumë i madh është që çka do të ndodhë me Kosova-filmin në përgjithësi sepse ajo nuk ka qenë vetëm shtëpi e prodhimit të filmave por në përgjithësi përmban edhe prona edhe asete të cilat me tokë janë diku 3 hektarë e gjysmë në Lagjen Arbëria atje, por edhe objekte ku janë xhiruar filmat në formë të studiove të xhirimit me diku 3000 metra katror. Këto janë asete shumë të çmueshme dhe duhet të konsiderohen asete të kulturës. Nëse tash këto mbi bazën e asaj që tash Kosova-filmi nuk prodhon më filma sepse në botë pakë kanë metë ato shtete që prodhojnë filma, shteti që prodhon filma.

Me këtë arsyetim unë mendoj që do të ishte shumë lajm i keq për Kosovën nëse atyre aseteve po i përgatitet një privatizim siç na ka ndodhë edhe me asete të tjera dhe këto pastaj të përfundojnë në qendra tregtare apo bazena e pishina. Sepse do të ishte mirë që Qeveria e Kosovës të mendonte për ringjalljen e Kosova-filmit në një farë mënyre, ka forma për tu bërë kjo.

Për shembull pse të mos mendohet që pronat e Kosova-Filmit në të vërtetë ku sot ndodhet KFOR-i por me siguri që KFOR-in nuk do ta kemi gjithmonë aty, që këto prona të shfrytëzohen nga Qendra Kinematografike e Kosovës që t'i takojnë asaj dhe që Kosova-filmi në një farë forme të ngjallet si një lloj i kompanisë së subvencionuar me fonde publike e cila bëhet aksionare në prodhimin e filmave, në prodhimin e filmave të ardhshëm.

Këto asete mund të shfrytëzohen edhe për xhirimin e filmave në Kosovë bashkë për këtë kategorinë e veprave kinematografike vendore, ato studio, në ato studio mund të investohet pak, të modernizohen, ka hapësira shumë të mëdha, shumë të përshtatshme, .. xhirime të ndryshme, studio të xhirimit e kështu me radhë dhe pastaj Kosova-filmi të bëhej në një farë mënyre edhe aksionar me përqindje të caktuar në filmat tonë vendor të cilët një ditë mund të bëhen shumë të suksesshëm siç po bëhen shumë filma nga Kroacia, nga Sllovenia të cilët po dalin në arenën ndërkombëtare po fitojnë çmime shumë të rëndësishme ndërkombëtare e kështu me radhë. Pastaj kjo është edhe e leverdishme në industrinë e filmit e cila mund të sjell shumë para nëse filmi është shumë i suksesshëm dhe pastaj këto para t'i shkojnë vetë Kosova-filmit si një ndërmarrje e cila subvencionohet me fonde publike e kështu me radhë.

Pra, ka forma të ndryshme që ky aset shumë i vlefshëm i Kosovës që është i karakterit kulturore të mos përfundoj thjeshtë si parcela të tokës të cilat qiten proces të privatizimit edhe shiten pa kurrfarë dhimbje edhe Qeveria me i pa ato vetëm si një farë lloj burimi të disa pak milionave nëpërmjet të cilave i mbyll tani këto vrimat buxhetore që i kanë mbet.

Kjo do të ishte nëse ndodh një fatkeqësi shumë e madhe për filmin në Kosovë, për kulturën në përgjithësi dhe unë po i bëj thirrje Qeverisë publikisht që kjo të mos ndodhë. Na duhet në një farë mënyre një farë garancie apo le të themi një farë zotimi edhe i ministritë edhe i Qeverisë këtu që kjo nuk do të ndodhë me ato asete, të cilat kanë qenë kulturore, por që do të ruhen edhe që politika e Qeverisë do të jetë që të ringjallë këto në drejtim të prodhimit dhe zhvillimit të industrisë së filmit për ditë më të mira.

**KRYETARI:** Faleminderit! Rustem Berisha e ka fjalën.

**RRUSTEM BERISHA:** Faleminderit, kryetar!

Edhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës e ka shqyrtuar me vëmendje këtë ligj. Ka vërejtje të shumta edhe ne si parti kontributin tonë do ta japim gjatë amendamentimit të këtij ligji, por në parim ne e përkrahim këtë ligj. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Përfaqësuesi i Qeverisë!

**MINISTRI KUJTIM SHALA:** Faleminderit!

Zoti Konjufca, unë kam marrë po të njëjtën letër nga Shoqata e KINO-asve dhe në tekstin përcjellës ka një fjali e cila është tepër domethënëse në të cilën thuhet që në masën më të madhe ky ligj është shumë i mirë.

Ato propozime i kamë edhe unë dhe unë besoj që ne duhet t'i diskutojmë por ky në të vërtetë është 10% i propozimeve të cilat ata i kanë dhënë më herët gjatë debateve publike dhe që deri në këtë fazë nuk janë përfshirë.

Sa i takon çështjes së Kosova-filmit, unë mendoj që ka një avancim me që në ligjin në fuqi thuhet që për të vendos ministri, ndërsa tani duhet të vendos Qeveria. Çështja e tij nuk mund të zgjidhet me këtë ligj sepse është më e ndërlikuar, ju edhe vetë e thatë që ajo është një aset që lidhet jo vetëm me trashëgimin kulturore por edhe me pronat. Kështu që për të duhet të ketë një vendim dhe një procedurë të një niveli tjetër. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Muhamet, urdhëro!

**MUHAMET MUSTAFA:** Vetëm dëshiroj të inkuadrohem në këtë debatin lidhur me Kosova-filmin, Kosova-filmi është një ndërmarrje shoqërore nën administrim të Agjencisë së Privatizimit.

Me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për ndërmarrjet publike është hapë mundësia që qoftë Qeveria, qoftë komunat ndërmarrjet e caktuara që janë në administrim të Agjencisë së Privatizimit t'i vejë nënadministrim të ministrive të caktuara ose nën administrim të komunave. Prandaj, mund të iniciohet një aktivitet qoftë nga Qeveria mesë ministrisë ose nga komunat e caktuara për shembull, para këtij ligji ne kemi pasur shumë vërejtje nga qyteti i Prishtinës lidhur me pallatin e rinisë, tash është ligji në fuqi nuk ka asnjë iniciativë që ky pallat i rinisë të merr statusin që e meriton, vetëm këtë vërejtje desha ta theksoj.

**KRYETARI:** Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për miratimin në parim të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 05/L-050 për kinematografinë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Jemi 65 deputetë në sallë. Votojmë tash!

63 deputetë kanë hedhur votën, 62 janë për, një abstenim. Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin numër 05/L-050 për kinematografinë.

Kërkohet nga Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

KRYETARI: Jemi në pikën tjetër të rendit të ditës:

### **5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për digjitalizimin e transmetimeve radiodifuzive tokësore**

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara. Ftoj kryetarin e komisionit funksional zotin Muhamet Mustafa që para deputetëve ta paraqesë dhe arsyetojë raportin me rekomandime.

MUHAMET MUSTAFA: Faleminderit, zoti kryetar i Kuvendit!

Ministra,  
Deputetë,

Ky ligj tash ka ardhur në leximin e dytë pas një aktiviteti shumë të ngjeshur dhe gjithëpërfshirës që ka zhvilluar grupi punues në krye me zotin Raif Qelën i cili e falënderoj edhe grupin edhe Raifin që kanë bërë një inkuadrim të gjithë aktorëve të interesuar dhe gjithashtu edhe me inkuadrimin e përfaqësuesëve të Komisionit për veprimtari Shërbime Publike dhe Media kështu që është punuar me durim dhe pothuajse është mbërrir një shkallë e lartë e konsensusit për të gjitha zgjidhjet e propozuara.

Mund të them që ka pas shumë interesa të kundërta të aktorëve të ndryshëm, por gjatë diskutimit është ardhur deri te një shkallë e lartë e pajtueshmërisë. Kështu që faktikisht ne sot kemi pak punë me dy amendamente, prandaj me amendamentin 21: për çka ka pasur pak edhe një, ka qenë i ndërlidhur edhe kjo përmbajtja e letrës së OSBE-së sot, komisioni domethënë ka bërë një plotësim të pikës 2 të këtij amendamenti që unë do ta lexoj kur të vjen ky amendament. Është një plotësim i tekstit që nuk është përmbajt në tekst në mënyrë të duhur dhe me këtë domethënë edhe ajo brenga e OSBE-së do të tejkalohet.

Çështja tjetër ka të bëjë me amendamentin 26, ku Komisioni për Integritim Evropian ka pas një brengë, ka një mendim tjetër por komisioni ynë edhe pas trajtimit të kësaj çështje ka mbet në amendamentin që është këtu për arsye se kështu janë zgjedhjet kushtetuese të Kosovës sipas të cilave Komisioni i Pavarur për Media ka një rol të caktuar determinues, i cili nuk mund të zvogëlohet nëpërmjet ligjeve të caktuara.

Këto janë dy vërejtje përndryshe në pjesën shpjeguese keni një sqarim shumë të gjerë të ecurisë që diskutimi të këtij ligji dhe aprovimi të tij. Ju falënderoj për vëmendje dhe ju ftoj që të aprovoni amendamentet që i ka propozuar Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri.

**KRYETARI:** Faleminderit, kryetar i komisioni funksional a bëhet me lexu 21-shin se kur i fusim në pako të votimit këto të cilat janë deri në 26 shkojnë në pako, pastaj 26-shin. Vetëm 21-shin e lexon pasi ka nevojë për qartësim.

**MUHAMET MUSTAFA:** Mbledhjen e djeshme edhe në mbledhjen paraprake e ka pa se në pikën dy pikërisht në amendamentin 21 ka mbet e pa përkufizuar mirë një pjesë e tekstit nuk është në amendament dhe na sot propozojmë që të inkuadrohet pika 2, pas pikës do të shtrohet ky tekst. KPM-ja do t'i përcaktojë procedurat dhe kushtet e dhënie me koncesion të multipleksëve përkatës, lokal, dhe rajonal.

**KRYETARI:** Faleminderit! Raif Qela, urdhëro!

**RAIF QELA:** Të nderuar deputetë,  
Çështja të cilën e ka ngritur si shqetësim OSBE-ja është e zgjidhur pikërisht me amendamentin të cilin e tha kryetari i Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri.

Edhe pa e pasur parasysh fare, pa e ditur fare se do të jap kush vërejtje në këtë çështje e kemi adresuar shumë mirë dhe me këtë nën nuk mbetet zbrazëtirë sa i përket mediave lokale dhe rajonale, sepse janë të rehatuara në mënyrën më të mirë të mundshme. Prandaj, kjo është problem i cili është tejkaluar. Edhe mendoj që është tejkaluar në mënyrën më të mirë të mundshme. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Atëherë, në këtë projektligj janë propozuar gjithsej 32 amendamente. Amendamentet numër 26 dhe 27 të komisionit funksional nuk janë mbështetur nga Komisioni për Integritet Evropian.

Do të vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara sipas radhës së paraqitur në raportin e komisionit funksional. Unë do të bëj një propozim që nga amendamenti 1 pasi kemi unanimitet komisioneve, deri në amendamentin e 25 t'i votojmë në pako. Në qoftë se ka kundër dikush, urdhëro Shqipe e ki fjalën.

**SHQIPE PANTINA:** Unë kam një çështje tek një amendament që është amendamenti 16 e që ka të bëjë me nenin 12 që flet për masat stimuluese për konsumatorë. Me këtë projektligj rregullohet në fakt mbështetja që iu ofrohet familjeve që janë me asistencë sociale, për të cilat Ministria e Punës do të duhej të i blinte apo të ju mbulonte shpenzimet shtesë që këto familje do të kenë për të blerë aparat shtesë për të pranuar valët që tash do të transmetohen në digjital, në vend të asaj që ka qenë analog.

Megjithatë, i gjithë projektligji, i gjithë procesi i digjitalizimit do të sjell kosto shtesë për secilën familje në Kosovë, secila familje nëse nuk e ka një aparat televiziv të ri do të duhej të blejë një aparat shtesë që t mund të pranojë valët që tani transmetohen në sistemin digjital dhe mënyra

qysh është i rregulluar neni 12 në fakt, lë hapësirë të madhe për abuzim dhe për keqpërdorim dhe kjo nuk është rregulluar mjaftueshëm, sepse këtu i jepet mundësia siç thuhet qytetarëve që kanë kushtet më të pa favorshme për të konkurruar për të marrë një vouchër apo për bashkëfinancim nga Ministria e Punës, e cila quhet këtu si ministri përkatëse, por nuk ka asnjë mënyrë të rregullimit se si do të shkojë ky proces.

Qysh se i gjithë ky proces në fakt sjell hapësirë për shumë manipulime dhe abuzime nga ana e Qeverisë dhe mënyrën e shpërndarjes së aparatit i cili do të jetë ku di unë një formë, aparat për pranimin e valëve digjitale dhe po ashtu nuk është rregulluar mjaftueshëm as mënyra se si dhe kush do ta ketë mundësinë për shpërndarjen e këtyre aparateve, thuhet se do të ketë tender të hapur megjithatë ligji nuk i rregullon kushtet, mënyrat, nuk i përcakton. I është lënë hapësirë e madhe KPM-së por nuk është caktuar organi mbikëqyrës ose cili do të jetë roli i Kuvendit në mbikëqyrjen e gjithë këtij procesi. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Profesor, ne do të shkonim deri tek 15-shi pasi kemi unanimitet. Te 16-shi ndalemi veçantë, në qoftë se të gjithë pajtohemi ne shkojmë i votojmë në pako nga amendamenti 1 deri në 15 bashkarish edhe 15-shi përfshihet, në qoftë se ka kundër le të deklarohet dikush. S'ka kundër. Atëherë, ziles deputetë në qoftë se mundeni të kthehen sepse vetëm 58 deputetë i kemi, ndryshe s'mund të procedojmë.

Raif ndërkohë a dëshirove fjalën, por jo për këto se këtu pastaj 16-shi futemi më vonë. Atëherë, ne do të votojmë pako amendamentet 1 deri 15, në qoftë se ka dikush kundër le të deklarohet, në qoftë se nuk ka lus regjinë dhe deputetët përgatitemi për votim të amendamenteve 1 deri 15, përfshihet edhe 15-shi në fakt, votojmë tash.

Ne mund, shkojmë edhe njëherë gjersa ka deputetë të mjaftueshëm në sallë nuk ka votim, po shkojmë një na një.

Amendamenti 1

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 2

A ka kundër?

Miratohet.

Amendamenti 3

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 4

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 5

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 6

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 7

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 8

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 9

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 10

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 11

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 12

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 13

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 14

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 15

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 16

Jemi te neni 12, urdhëro Profesor më mirë qartëso amendamentin 16.

MUHAMET MUSTAFA: Amendamenti 16 ka të bëjë me nenin 12 me paragrafin 3, ndryshimi në mes të tekstit bazë që e ka propozuar Qeveria dhe amendamentit është se në tekstin bazë është dashur të marrin asistencë për blerjen e aparateve të cilat i përmendi kolegja deputete, vetëm ata të cilët përjashtohen nga pagesa e kontributeve sipas Ligjit mbi Radio e Televizionin e Kosovës.

Ndërsa, amendamenti thotë që duhet të mbështeten të gjithë ata që gëzojnë asistencën sociale. Tash deputetët mund të përcaktohen të votojnë ose për këtë amendament ose për këtë amendamentin tjetër, zgjedhje të tretë nuk mund të ketë, por meqenëse është harmonizuar amendamenti dhe po supozoj që përfshin domethënë një pjesë të qytetarëve që ju nevojitet kjo asistencë unë sugjeroj që të aprovohet amendamenti që e ka propozuar komisioni.

KRYETARI: Faleminderit! Jemi në propozim të këtij amendamenti nga ato çka tha edhe profesori Muhamet. E votojmë, a ka kundër? 2 kundër. Miratohet.

Amendamenti 17

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 18

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 19

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 20

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 21

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 22

A ka kundër?

Profesor, më mirë merre fjalën edhe njëherë jemi te 21-shi me plotësimet të cilat profesori i lexoi më herët.

MUHAMET MUSTAFA: Në pikën 2 të këtij amendamenti...

KRYETARI: Nëse ka nevojë...

MUHAMET MUSTAFA: Ka nevojë edhe njëherë t'i lexoj? Domethënë në pikën 2, pas pikës duhet të vijë teksti "KPM do t'i përcaktojë procedurat dhe kushtet e dhënies me koncesion të multipleksëve përkatës lokal dhe rajonal."

KRYETARI: Amendamenti 21 me përfshirjen e asaj çfarë profesori e tha, a ka kundër dikush? Miratohet.

Amendamenti 22

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 23

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 24

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 25

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 26, po urdhëro zonja Sahatqija.

TEUTA SAHATQIJA: Kryetar, në Komisionin për Integritet Evropian kemi pasur disa vërejtje patëm vërejtje edhe në amendamentin 10 dhe e patëm kthyer në komision dhe ai u përmirësua, prandaj edhe nuk reagoi.

Në amendamentin 26 më lejoni ta lexoj çka ka thënë komisioni është: Komisioni Funkcional e ndryshon përbërjen e komisionit mbikëqyrës dhe në këtë mënyrë prish bilancin e përfaqësimit të barabartë sa i përket dy rregullatorëve, si KPM dhe ARKEP. Në fakt në fillim kanë qenë nga dy përfaqësues e pastaj KPM-ja i ka pas tre përfaqësues, ndërsa ARKEP-i ka vazhduar me dy dhe një përfaqësues të ministrisë.

Prandaj, këtë amendament Komisioni për Integritet Evropian nuk e ka përkrahur.

**KRYETARI:** Faleminderit! Atëherë e kemi amendamentin 26 i komisionit funksional pa mbështetje nga Komisioni për Integritet Evropian, profesori Muhamet edhe Raif Qela janë lajmëruar, urdhëro Profesor.

**MUHAMET MUSTAFA:** Ne e kemi shqyrtuar siç tha edhe kryetarja e Komisionit për Integritet Evropian kemi shqyrtuar edhe këtë sugjerim nga komisioni pas analizës dhe kemi ardhur në përfundim se propozimi i Komisionit për Integritet Evropian nuk është në harmoni me rolin e Komisionit të Pavarur për Media të përcaktuar me Kushtetutë.

Kushtetuta i jep këto... Komisionit të Pavarur për Media dhe gjithashtu me këtë zgjidhje janë pajtuar dhe aktorët tjerë në fund edhe rregullatori, ARKEP-i të gjithë aktorët tjerë e kanë pa se kjo zgjidhje është simetrike sepse nuk mund të kemi një zgjedhje për një trup punues dhe një zgjedhje për një trup punues tjetër, sepse këto do të vijnë në kontradiktë njëra me tjetrën.

Domethënë, është një zgjidhje simetrike në harmoni me Kushtetutën dhe në harmoni me rolin dhe përgjegjësitë e KPM-së. Prandaj, unë ju ftoj që të aprovohet amendamenti që ka dhënë Komisioni për Zhvillim Ekonomik.

**KRYETARI:** Faleminderit! Raif Qela e ka fjalën, Ilir Deda përgatitet.

**RIAF QELA:** Faleminderit! Çështja e përfaqësimit komisioni ka vendosur grupi punues dhe komisioni kanë vendosur në bazë të asaj se ka qenë detyrim kushtetues. Ndërsa, një problem të cilin unë e shoh ky nen është se ka mbetur pa u zgjidhur, pa u rregulluar çështja se kush duhet faktikisht ta procedojë krejt këtë çështje, kush duhet ta themelojë, kush duhet ta nis procedurën e themelimit e Komisionit Mbikëqyrës, ka qenë ministria përgjegjëse, ndërsa tani ka mbetur kjo çështje pezull na është shmangur dhe nuk e di arsye pse.

Tani është mirë që edhe njëherë ta jap vlerësimin edhe kryetari i komisionit sepse dikush duhet ta nis procedurën e themelimit të komisionit mbikëqyrës.

**KRYETARI:** Faleminderit! Ilir Deda e ka fjalën pastaj Muhamet Mustafa, prapë. Edhe Blerim Grainca e ka kërkuar fjalën.

**ILIR DEDA:** Faleminderit! Në fakt, profesor Mustafa e ka mirë, sepse na kemi pasur një paqartësi në Komisionin për Integritet Evropian dhe atë çka nuk e di a është shkruar është se ne kemi thënë që neni 5 është jo kushtetues si i tillë, kështu amendamenti i juaj ky 26-shi është në rregull, është në përputhje me Kushtetutën edhe është në përputhje me praktikën evropiane, sepse nuk e lejon monopolin e ai 5-shi cilin edhe ne kemi qenë kundër ka qenë e kundërta edhe e ka

shkel Kushtetutën edhe ka qenë jashtë çdo praktike evropiane të cilin na në Komisione për Integritet është dashur me e pa kështu që në rregull jemi me atë çka po e thoni ju.

Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Faleminderit! Profesor a po e merr fjalën në fund, Blerimi le të flet pastaj e përmbyllim para votimi. Blerim urdhëro!

BLERIM GRAINCA: Përshëndetje!

Atë që desha të them unë thujse e tha Iliri tani, por poenta e krejt ligjit qëndron se ne duhet ta shohim si tërësi nëse fillojmë të analizojmë të ndara nenet dhe të veçuara nga njëra prej tjetrës, atëherë e krijojmë vërtet një konfuzion. Mirëpo, neni për të cilin po flasim është në harmoni të plotë me kompetencat kushtetuese që i ka KPM-ja si një kategori kushtetuese dhe ne nuk kemi mundur t'ia zvogëlojmë këto kompetenca apo t'ia marrim, edhe pse ka pasur një dualizëm në mes dy agjencive, që rregullojnë këtë fushë të KPM-së dhe Agjencisë për Komunikimet Elektronike.

Gjithsesi, përmbajtjen e komisionit mendoj se do të duhej të emërohet apo të fillohet procedura nga vetë Ministria për Zhvillim, si institucion i cili edhe është shtetëror, kontrollon dhe është përgjegjës për frekuencat në këtë rast.

KRYETARI: Atëherë, Profesori e ka fjalën, përfundimisht.

MUHAMET MUSTAFA: Është e vërtetë që ka pasur diskutime të shumta, mirëpo mendoj se me durimin që ka treguar grupi punues dhe deputeti Çela me disa takime që ka mbajtur me të gjithë, kanë ardhur deri te zgjedhjet më të mira.

Sa i përket kush e jep iniciativën, me vetë rolin që ka KPM-ja këtu, KPM-ja do të udhëheq me këto procese. Prandaj, KPM-ja do tu drejtohet me një letër të gjithëve, që t'ia delegojnë përfaqësuesit e vet edhe ARKEP-i edhe ministria, që t'ia dërgojnë përfaqësuesit e vetë dhe do të funksionojë në atë mënyrë. Nëse shprehimisht nuk është thënë, por nënkuptohet me rolin që e ka, që KPM-ja do ta iniciojë këtë, sepse e jep edhe kryesuesin dhe të gjitha. Faleminderit!

KRYETARI: Falënderoj të gjithë për qartësimet.

Atëherë, jemi në amendamentin e 26-të. A ka kush kundër? Aprovohet.

Amendamenti 27 i Komisionit Funkcional, por pa përkrahje nga Komisioni për Integritet Evropiane. Urdhëro, zonja Sahatqija!

TEUTA SAHATQIJA: Faleminderit, kryetar!

Edhe 26-shi me këtë shpjegimin e kryetarit mendoj se u bë më i qartë, pamë edhe anëtarët e komisionit që reagojnë pozitivisht. Në të njëjtën mbledhje kemi analizuar edhe amendamentin 27 dhe në komision kemi thënë që ky paraqet një konflikt të interesit, në rast se komisioni mbikëqyrë ose emëron dhe e mbikëqyrë punën e Komisionit Vlerësues.

Kisha pasur dëshirë që edhe për këtë amendament të na flasë kryetari i Komisionit Funkcional pasi që këto amendamente ne si komision i kemi kthyer atje dhe besoj që zoti Muhamet mund të japë shpjegim.

KRYETARI: Urdhëroni, profesor!

MUHAMET MUSTAFA: Amendamenti 27, në fakt nuk kemi të bëjmë me kurrfarë konflikti të interesit, sepse Komisioni për Vlerësim është një trup operacional që përgatit vendimet e Komisionit Mbikëqyrës.

Prandaj, Komisioni për Vlerësim do të emërohet, do të bëjë një raport, por do të japë vetëm propozim të cilat i aprovon komisioni mbikëqyrës. Domethënë, nuk ka konflikt interesi, është raport i një organi që formon një organ tjetër më të vogël operativ.

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë, e votojmë amendamentin 27. Kush është kundër? S'ka kundër. Aprovohet.

Amendamenti 28

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 29

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 30

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 31

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 32.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Tani, të nderuar deputetë, e votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. 64 deputetë janë në sallë. Votojmë tash!

64 deputetë kanë votuar. 55 për, 8 kundër, 1 abstenim. Kuvendi miratoi Ligjin nr. 05/L-027 për digjitalizimin e transmetimeve radiodifuzive tokësore.

Jemi në pikën tjetër të rendit të ditës.

### **- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për letërnjoftimin**

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për letërnjoftimin dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara. Ftoj raportuesin e Komisionit Funkcional, zotërinë Fadil Demaku, që ta paraqesë dhe arsyetojë raportin me rekomandime.

FADIL DEMAKU: Faleminderit, kryetar!

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së ka shqyrtuar në disa mbledhje Projektligjin nr. 05/L-15 për letërnjoftim dhe përfundimisht ka propozuar: 6 amendamente janë nga komisioni, një amendament është nga anëtari i komisionit Qerim Bajrami, i cili e ka marrë përkrahjen e komisionit dhe dy amendamente janë nga deputeti Nait Hasani, të cilat nuk e kanë marrë përkrahjen e komisionit.

Në mbledhjen e Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së të datës 29 korrik 2015 Komisioni ka vendosur ta procedojë për shqyrtim raportin për Projektligjin për letërnjoftim në lexim të dytë dhe ne ftojmë deputetët ta miratojnë këtë projektligj bashkë me amendamentet e propozuara nga Komisioni Funkcional.

Gjithashtu, kemi pasur edhe një propozim nga një anëtar i komisionit dhe që është përkrahur nga të tjerët, te kapitulli i dytë, neni 9, përmbajtja e letërnjoftimit, ku përfshihen të dhënat, të përfshihet në kuadër të të dhënave të letërnjoftimit të përfshihet edhe grupi i gjakut, është një praktikë që e aplikojnë disa vende, disa vende jo. Dhe, ky ka qenë edhe një propozim që është përkrahur nga komisioni. Faleminderit.

KRYETARI: Faleminderit! Në këtë projektligj janë propozuar gjithsej 9 amendamente. Urdhëro Shaip, pasi u lajmërove.

SHAIP MUJA: Faleminderit, zoti kryetar!

Unë desha të lus deputetët për një lëshim, i cili është bërë këtu në patentëshofer për grupin e gjakut. Mendoj, që patentëshoferët standardë të cilët sot kërkon edhe Bashkimi Evropian, por kërkon edhe nevoja e digjitalizimit të lejeve tu udhëtimit, për arsye të preventivës në rast të aksidenteve, secili ngasës i makinës duhet ta ketë në pasqyrim edhe identifikimin e grupit të gjakut. Për njohur, unë posedoj patentëshoferin e Shqipërisë, i cili është sipas standardeve të Bashkimit Evropian dhe pasqyrohet grupi i gjakut në të. Dhe po ashtu, e kanë edhe në Bashkimin Evropian, prandaj kishte qenë mirë që në amendament të caktohet qartazi në faqen e parë, të identifikuar grupi i gjakut, nëse nuk është ndryshe e pasqyruar, sa kam unë informacione. Faleminderit!

KRYETARI: Shaip, faleminderit! Por, ka reagime prej kolegëve të tjerë deputetë se për letërnjoftim jemi duke folur. Vazhdo, po po vazhdo merre fjalën. Më fal, Fadil! Regjia, Shaip të lutem... jo vetëm desha ta di a po i referohesh letërnjoftimit, apo...

SHAIP MUJA: Unë thash, në mjetet e identifikimit. Mjet identifikimit është letërnjoftimi, patentë i shoferit në raste të caktuara dhe pasaporta. Dhe, sot për digjitalizim, për nevojat e digjitalizimit, qytetarët e Republikës së Kosovës, për të mos shkuar dy-tri herë me e paraqitë në administratë, paraqesin edhe grupin e gjakut, i cili u përsëritet në të gjitha mjetet e identifikimit në pjesën "smart", që quhet pjesa e mbyllur, e cila nuk është e lexueshme në letërnjoftim, ndërsa në patentën e shoferit është e identifikueshme. Faleminderit!

KRYETARI: Tani është kryetari i komisionit Shaip, në qoftë se ka hapësirë... Urdhëro Fadil, fjala për ju.

FADIL DEMAKU: Faleminderit, kryetar!

Më duket se unë i sqarova. Ishin amendamentet që janë përkrahur nga komisioni, dy amendamente nga Nait Hasani që nuk kanë marrë përkrahjen e Komisionit dhe kemi një amendament, amendamenti nr. 9 nga deputeti Qerim Bajrami, i cili ka marrë përkrahjen e komisionit. Sa i përket çështjes së grupit të gjakut, unë sqarova tek kapitulli, te Projektligji për letërnjoftim, te kapitulli i 2-të, neni 9, te përmbajtja e letërnjoftimit, ku përfshihen të dhënat, është kërkuar nga komisioni që të përfshihen tek të dhënat e letërnjoftimit edhe grupi i gjakut. Kjo ishte e tëra sa i përket kësaj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Do të shkojmë t'i votojmë amendamentet.

Përgatitemi për votim. I kemi gjithsej 9 amendamente.

Nga amendamenti i parë deri tek amendamenti i shtatë, domethënë 1 deri në 6 kanë përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL, të gjitha janë unanimitet.

A ka kundër 1 – 6? S'ka kundër. Aprovohen.

Amendamenti 7. Deputeti Nait Hasani pa përkrahjen e Komisionit funksional. A ka kundër? Nait, e dëshiron fjalën? Po, urdhëro!

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Amendamenti 7 ka të bëjë me format dhe mënyra e punimit të letërnjoftimit përcaktohet me akt nënligjor nga ministria. Mendoj se propozimi im është që forma dhe mënyra e pranimit të letërnjoftimit përcaktohet me ligj, këtu është çështja. Nëse një letërnjoftim duhet të përcaktohet me ligj e jo nga ministria, sipas dëshirës apo vullnetit të ministrit. Prandaj, kërkoj që ky amendament të përkrahet dhe të votohet, sepse me anë të ligjit e përcaktojmë një rregull të caktuar, për shembull, të letërnjoftimit.

KRYETARI: Amendamenti 7, i propozuar nga deputeti Nait Hasani. Shkojmë me elektronikë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten. E thash tri herë, pa përkrahjen e komisionit funksional, Nait. Nuk të kanë përkrahur. Po shkojmë në votim elektronik, dhe e shohim a po të përkrahin deputetët. Votojmë tash!

Të nderuar deputetë, kemi vetëm 60 vota të hedhura në votim. A e provojmë edhe njëherë, pasi që 65 jemi. E provojmë edhe njëherë, në mënyrë që të mos e lëmë për seancën e radhës.

Atëherë, shkojmë me amendamentin 7 edhe njëherë. Deputeti Nait Hasani pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Votojmë tash!

Atëherë, 62 deputetë kanë votuar. 31 janë kundër, Nait. 21 janë për, 10 abstenime.

Kuvendi miratoi Ligjin për Letërnjoftimin. Më falni! Nait, nuk ka kaluar amendamenti yt. Kërkoj Falje!

Amendamenti 8, po ashtu deputeti Nait Hasani ka një propozim pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Amendamenti 8, neni 9 përbërja e letërnjoftimit. Në përbërje është: pika 1 letërnjoftimi përmban të dhënat në vijim: është stema e Republikës së Kosovës, emri i shtetit, emri i dokumentit, simboli i dokumentit elektronik biometrik, mbiemri, emri, datëlindja, gjinia dhe mungon etnia apo kombi, shtetësia, data e skadimit, vendlindjes, fotografimi, nënshkrimi e çështje tjera.

Në këtë nen, unë propozoj që të futet kombi apo etnia e personit që i lëshohet dokumenti zyrtar, pas pikës 1.8. gjininë, 1.9 kombi (etnia) dhe vazhdon siç është renditur nën numrin rendor.

Arsyetim:

Të nderuar deputetë,

Mos futja e kombit apo etnisë në dokumentet zyrtare mendoj se është një diskriminim që është shumë e dëmshme për Kosovën dhe në përgjithësi për popullin shqiptar në Kosovë. Këtë e them me përgjegjësi, sepse ka shumë keqpërdorime që po u ngarkohen shqiptarëve kudo këtu në Kosovë dhe jashtë, në mungesë të etnisë apo kombit.

Prandaj, shpërngulja e shumë shqiptarëve nga Kosova në fund të vitit të kaluar dhe në fillim të këtij viti ishte shumë e dhembshme, por askush nuk e dinte se kush u shpërngul. Ne e dinim se shqiptarët po shpërngulen, por e dëgjua edhe fjalime të tjera që kemi pasur në Kuvend, debatet që janë shpërngulur edhe pakica të tjera. Ata thoshin janë shpërngulur romët, ata tjerët thoshin janë shpërngulur boshnjakët, ata të tjerët thoshin janë shpërngulur ashkalinjtë, egjiptianët dhe serbët, prandaj nuk e dinim se kush është shpërngulur. Për mua, mund ta dimë vetëm sa qytetarë janë shpërngulur.

Me vendosjen e kombit apo të etnisë në dokumentet zyrtare, hiqen paqartësitë apo dilemat e shtetasit të Kosovës, sepse ai ka emër, mbiemër, ka kombin (etninë) dhe shtetësinë, që tregon një identitet të qartë shtetëror dhe veprimet e mira apo të dëmshme, që i bien personit në fjalë e jo komunitete të tëra, që jetojnë në Kosovë.

Me këtë them, se edhe të gjitha shtetet në dokumentet zyrtare e kanë shtetin e tyre si identifikim politik i jashtëm, por edhe kombin apo etninë, që përcakton identitetin kombëtar apo etninë e shtetasit, si identifikim i brendshëm. Me këtë mendoj, se në dokumentet zyrtare unë dua të kem përveç shtetësisë, dua të kem edhe kombin apo etninë, që përcakton identitetin tim kombëtar. Prandaj, kërkoj nga deputetët ta miratojnë këtë amendament, sepse kjo është një qartësi e plotë dhe një veprim, që tregon identitetin kombëtar, shtetëror, sepse kemi mjaftë keqpërdorime e këto keqpërdorime i eliminojmë me këtë veprim.

KRYETARI: Faleminderit, Nait! Teuta Sahatqija e ka fjalën rreth kësaj çështjeje.

TEUTA SAHATQIJA: Faleminderit, kryetar!

Gjithashtu, Ligji për letërnjoftimin është analizuar në Komisionin për Integritet dhe do ta lexoj vetëm pjesën në të cilën flitet për amendamentin 8 apo amendamentin e dytë të deputetit Nait

Hasani, ku përcaktohet që neni 9 të shtohet edhe kombi i personit, që i lëshohet dokumenti zyrtar, sipas pikës 1.8 – gjininë, kombi dhe të vazhdohet siç është e renditur me numër rendor.

Kjo nuk përkrahet nga Komisioni për Integritime Evropiane, pasi që nuk përkon me praktikën më të mirë evropiane. Gjithashtu, letërnjoftimi dhe kombi nuk mund të zgjidhin problemet të cilat janë. Çështja e migrimit nuk mund të zgjidhet me futjen e fushave të ndryshme në letërnjoftim. Atëherë, do të kishin dalë edhe fusha të tjera, të cilat në fakt më tepër do të diskriminonin, se sa do të ndihmonin në gjetjen e statistikave.

Prandaj, Komisioni për Integritime nuk e ka përkrahur këtë amendament.

**KRYETARI:** Faleminderit! Ilir Deda e ka fjalën, pastaj Nait, ti je në fund.

**ILIR DEDA:** Faleminderit!

Amendamenti 8 i cili është propozuar pa përkrahjen e Komisionit Funkcional dhe pa përkrahjen e Komisionit për Integritime Evropiane është antikushtetues. Është antikushtetues dhe kundër çdo praktike të mirëfilltë ndërkombëtare të ditës së sotme. Në ditë të sotme përkatësia etnike nuk shkruhet në letërnjoftime. Dhe, unë po ju them, nëse kjo kalon në Kuvend, ky ligj menjëherë bie në Gjykatë Kushtetuese.

**KRYETARI:** Faleminderit! Nait, cila është përgjigja jote?

**NAIT HASANI:** Faleminderit, kryetar! Po më çudit. Ne tentojmë të shkojmë drejt Evropës dhe këta çuditën me veprimet e veta. Nëse ne e kemi model Belgjikën dhe themi se edhe bisedimet mbahen në Belgjikë e në Bruksel dhe aty i kemi dy kombe që formojnë Belgjikën, valonët dhe flamanët, të tërëve u shkruan në dokumente zyrtare janë shtetas të Belgjikës dhe u shkruan “valon” dhe “flaman”. Prandaj, ne çuditemi t’i ikim identitetit tonë pikërisht duke menduar që po hyjmë në Evropë.

Përkundrazi, në Evropë hyjmë me identitet, nuk hyjmë duke i ikur identitetit tonë. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Amendamenti 8.

Do ta qesim prapë në votim elektronik. E kemi propozimin e deputetit Nait Hasani pa përkrahjen e Komisionit Funkcional. Votojmë tash!

Ju kisha lutur, të nderuar deputetë, për arsye se kemi vetëm 58 vota, që ta votojmë propozimin e deputetit Nait Hasani, pa përkrahjen e Komisionit Funkcional. 64 veta janë në sallë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatitemi bashkë për votim. Votojmë tash!

E lëmë për seancën e radhës, për arsye se nuk ka votim. Më falni! Arbenin s’e kemi këtu. Kush po na e interpreton Rregulloren. Sekretari po më thotë sa po mundet, jo, jo s’kalon, për ata nga radhët e juaja, profesor, e kemi një qartësim. Nga sekretari më thonë, jo më nuk mund të vazhdojë, pa i pasur 61 votë. Urdhëroni profesor, mos ta marr përgjegjësinë me e thye Ligjin. Vetëm keni parasysh një situatë reale, Gjykata Kushtetuese ka sjellë një aktvendim, profesori po e lëvizë kokën, se pa qenë 61 vota, pa e votuar, ne nuk e dimë cili është qëndrimi dhe s’mund të

procedojmë më tej. Ose duhet me qenë kundër, ose për, ose abstenim, por 61 duhet me qenë. Dhe, kjo është arsyeja pse administrata, përkatësisht sekretari disa herë po insiston tek unë të mos procedoj më tej.

Votojmë, po të doni, edhe me dorë, por 61 vota duhet të jenë gjithsesi. Po votojmë me dorë. Sa deputetë i kemi në sallë? 64 deputetë. Jemi tek amendamenti i 8-të. Deputeti Nait Hasani e ka propozuar, por nuk e ka përkrahjen e Komisionit Funkcional. Kush është për amendamentin e Nait Hasanit? Shkojmë, kush është kundër? Kush abstenon? I kemi 16 për, 34 kundër dhe 9 abstenime, që bëjnë 59 prapë. Me zor nuk mund ta fusim, më mirë kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës. E lëmë për tjetër herë. Shkojmë herë tjetër, e lëmë për seancën e radhës këtë pikë të rendit të ditës në tërësi. Ligji për letërnjoftim, shtyhet për seancën e radhës.

Jemi në pikën e radhës:

### **- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për markat tregtare**

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për markat tregtare dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Ftoj kryetarin e Komisionit funksional për zhvillim ekonomik, infrastrukturë, tregti dhe industri zotëriun Muhamet Mustafa që para deputetëve ta paraqesë dhe arsyetojë raportin me rekomandime.

MUHAMET MUSTAFA: Të nderuar deputetë,

I nderuari kryetar i Kuvendit,

I keni marrë amendamentet të cilat janë aprovuar nga të gjitha komisionet e Kuvendit dhe kanë të bëjnë kryesisht me rregullimet teknike, jo me ndonjë ndryshim përmbajtjesor dhe ju ftoj t'i votoni. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Vazhdojmë. Për këtë ligj i kemi të propozuar 11 amendamente. Do të shkojmë me votimin e amendamenteve të propozuara sipas radhës së paraqitur në raportin e Komisionit funksional.

Janë gjithsej 11 amendamente dhe ne do t'i votojmë në grup, të gjitha bashkërisht, por së pari të shohim sa deputetë janë të pranishëm në sallë. Janë 60 deputetë. Atëherë, ju kisha lutur t'i ftoni deputetët nëpërmjet ziles.

Pra, tani janë 61 deputetë në sallë. Po vazhdojmë me pakon e amendamenteve, pasi kemi unanimitet të plotë në votim.

A ka kundër? Atëherë, miratohen në parim.

Tani e votojmë tekstin e Projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara. I kisha lutur deputetët të ulen dhe të votojmë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim Ligjin për markat tregtare. Votojmë tash!

62 deputetë kanë votuar, 52 për, 4 kundër dhe 6 abstenime dhe konstatoj se Kuvendi e miratoi Ligjin Numër 05/L-040 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 04/L-026 për markat tregtare.

Jemi në pikën e radhës:

### **- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për patenta**

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për patenta dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Ftoj kryetarin e Komisionit funksional, zotëriun Muhamet Mustafa që para deputetëve ta paraqesë dhe arsyetojë raportin me rekomandime.

MUHAMET MUSTAFA: I nderuar kryetar i Kuvendit,  
Të nderuar kolegë deputetë,  
Komisioni dhe Grupi përkatës punues e ka amendamentuar këtë ligj dhe e ka mbërri një konsensus të plotë në Komision e gjithashtu edhe në komisionet tjera të Kuvendit e kanë mbështetur, prandaj ju ftoj që t'i votoni këto amendamente.

KRYETARI: Faleminderit! Shaip!

SHAIP MUJA: Faleminderit zoti kryetar!

Unë jam munduar të orientohem në ligj meqenëse është shumë e nevojshme që Republika e Kosovës për interesa të autorësisë së personave që merren me zbulime të kenë një ligj të fuqishëm i cili mund të mbrojë autorësinë e tillë dhe mendoj që zonja Hykmete, kur ka qenë deputete, pati thënë një herë – më mirë është mos të bihen ligjet që s'kuptohen se sa ligje të këqija që miratohen.

Prandaj, në këtë ligj ka disa vërejtje të cilat mendoj se janë edhe teknike, por janë edhe përmbajtjesore.

Në fillim, po filloj nga ato teknike, për shembull në fjalën “trips” qysh në hyrje të përkufizimeve për çudi që të nënçmohet ky ligj, thuhet “marrëveshja në lidhje me qeshjet”. Jo me qeshjet, por me qeshjet. Do të thotë, për “qeshjet tregtare e të drejtave të pronësisë intelektuale, shtojca IC e marrëveshjes e marruakëshit që e formojnë organizatën botërore”. Do të thotë, nuk kuptohet fare çka është dashur të thonë.

Mandej, në përkufizime të ndryshme, ky ligj për patentime bie në koalizion me ligjet tjera të Republikës së Kosovës që janë për patentime kryesisht në shëndetësi. Nuk po themi për teknologjinë e elektronikës apo të patenteve tjera, por bie në kolizion me ligjet e shëndetësisë.

Për shembull, tek lëndët e mbrojtjes me patentë, që janë duke filluar nga varietetet bimore ose shtazore, në nenin 9 pika 1.2, pika 1.3 po ashtu është i paqartë dhe në nenin 2.4 bie në kundërshtim me proceset e hulumtimeve gjenetike në shtazë.

Ka shkencëtarë në Republikën e Kosovës, të cilët për institutet tjera të republikave tjera, jashtë, siç është Gjermania ose Austria kanë patentuar zbulimet e veta të modifikimeve gjenetike, dhe ne nuk mund t'i lejojmë me këtë ligj.

Mandej, në dhënien e licencës së detyrueshme, pika 2 dhe pika 3, mendoj se është jashtë standardeve, të cilat duhet të trajtohen.

Në pjesë të tjera, të cilat janë – mirëmbajtja dhe ndërprerja e patentës, thuhet në nenin 83, pika 2 “tarifa vjetore e cekur në paragrafin 1 të këtij neni paguhet prej vitit të tretë dhe çdo vit vijues dhe llogaritet nga data e paraqitjes së aplikacionit”.

Unë mendoj që tarifa duhet të paguhet qysh në aplikacion dhe të ketë një tarifë standarde dhe pas aplikimit të certifikimit të paguhet certifikata e cila shkakton, sipas standardeve të shteteve të Bashkimit Evropian e ka të limituar një dekadë, ose ka disa shtete të cilat e limitojnë me një dekadë plus një dekadë.

Prandaj, kjo nuk është me standard ose me direktiva të disa shtete, po unë po flas për standarde të Republikës së Gjermanisë.

Neni 84, kuptimi i shprehjeve - aplikimi për zgjatje të afatit. Aplikimi për zgjatje, thotë “të afatit të certifikatës sipas nenit 13, 3 dhe nenit 36 të Rregullores së Europian community, numër 19.1.2016 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian, të datës 12 dhjetor 2006, për produktet mjekësore dhe përdorim në pediatri”. Do të thotë është për kategorinë e përkufizuar në pediatri, e cila do shpjegim, që bie në kundërshtim për aplikime në mjekësi.

Dhe, aq më tepër, ky ligj nuk lejon patentimet në aplikimet kirurgjikale, metodat kirurgjikale të cilat përdoren nga kirurgët, në një nen shpjegues i cili është i kufizuar këtu.

Zoti Mustafa, është në leximin e dytë, por duhet të kuptojnë edhe qytetarët që në leximin e dytë, je duke votuar diçka i cili do të nevojitet që të rishikohet edhe një herë. Nëse ju jeni të interesuar ta shndërroni në agjenci, unë jam tri herë më shumë i interesuar se ju, sepse ju jeni të interesuar vetëm të hapni vende pune por jo të bëni punë. Dhe ky është ndryshimi i cili sot është duke ndodhur në Republikën e Kosovës.

Prandaj, nëse mendon për zhvillim ekonomik, shumë shkencëtarë të Republikës së Kosovës sot punojnë në patente jashtë Republikës së Kosovës sepse ne nuk i japim as përkrahje me ligjet të cilët i kemi aprovuar këtu nga Ministria e Arsimit për përkrahjen në zbulime të shkencëtarëve të cilët merren me zbulime, por edhe mbrojtjen me patentë, prandaj zyrat të cilat do të ishin thirrur më shumë, zonja Hykmete më mirë kishte qenë ne ta sillnim në Parlament ratifikimin me një zyre të patentës së një shteti të fuqishëm, për shembull siç është Gjermania, të ratifikojmë përpara standardet, me ta të bashkëpunojmë dhe t'i adaptohem një standardi të tillë sepse është anëtar i Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Ndërsa më e fuqishme do të jetë nëse ne do

bëhemi anëtarë të Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe të anëtarësohemi në Zyrën në Gjenevë, e cila e mbulon edhe ratifikimin me zyrën në Bashkimin Evropian.

Në konsulta që thirrni ju dhe i keni bërë, zoti Mustafa ju asnjëherë nuk jeni thirrur në bashkëpunim me Agjencinë Kosovare për Produkte Medicinale dhe s'keni marrë asnjë mendim.

Ne, në mandatin e kaluar, i kemi ndaluar hulumtimet shkencore edhe në bimë. Ne kemi shkencëtarë këtu të cilët janë autodidaktë dhe të cilët nuk janë të thirrur për biologji por kanë zbuluar bimë, të cilat edhe janë mjekësore.

Janë ndoshta edhe qesharake për dikë, por për shembull një patentë që dy shqiptarë e kanë zbuluar në Gjermani dhe nuk kanë të bëjnë asnjëri me të fushës, sot janë në tregun gjerman shumë të fuqishëm dhe janë në interes për tregtinë e saj, prandaj këtu duhet ta paraqitësh në ligj se Agjencioni Kosovar për Produkte Medicinale dhe Qendra Klinike Universitare duhet të përmirësojë dy ligjet e shëndetësisë, por edhe i produkteve medicinale që i lejon kësaj zyre të patenteve të ketë një fuqi mbrojtëse intelektuale dhe të thirret për miratim para patentimit, kurse ne këtë nuk e kemi paraqitur këtu.

Në problemet mbrojtjes së të dhënave të patentës në dispozicion nga informacionet me zyret tjera ndërkombëtare, nëse një patentë paraqitet dhe duhet të thirret në referencë, kush do ta japë informacionin se ajo patentë nuk është i dubluar në nivel lokal, global apo në kuadër të Organizatës Botërore të Patentave në Gjenevë. Prandaj ne mund të patentojmë këtu patente dhe çka do të ndodhë? Do të shfaqet dikush në republika tjera, të shteteve tjera, për të cilat ne nuk kemi pasur një përkrahim ligjor që pa shpjegimin se ky patent në një afat prej dy a tre muajve, për shembull, jepet të thuhet se është ekzistues kjo patentë, dhe nuk regjistrohet.

Në fund fare, mendoj se neni 28, të përfaqësimit me personat që kanë të drejtë, thuhet “të jenë përfaqësues për patenta”. Përfaqësuesi i patentave thotë, mund të bëhet dhe është paraqitur një amendament pak më i modifikuar nga Grupi punues këtu dhe nuk e di nga kush, thotë “personi fizik banor në Republikën e Kosovës me studim të përfunduar universitar, duke e dhënë provimin kualifikues për një përfaqësues patenti në zyrë”, të cilin edhe nuk e kam të qartë, a është për atë që e ka patentuar dhe shkon e përfaqëson dikush dhe nuk është e thënë që të jetë, kurse nëse është zyra e patentave, është diçka tjetër dhe thirret si vend i punës.

Ndërsa në pikë n 2.2. thuhet “personat juridik që kanë vendin kryesor të biznesit në Republikën e Kosovës dhe të punësuar së paku 1 person që i plotëson kushtet e cekura në paragrafin 2.1 të këtij paragrafi” a i jep mundësi që të hapen zyre private të patentimeve apo të përfaqësojë patentuesin.

Mandej, është një shpjegim që në patent nuk është vetëm një shpikës. Ka “shpikës” ose “shpikësit”, dhe duhet të formulohet gjuhësisht dhe certifikata nuk i lëshohet secilit shpikës, por u lëshohet certifikata të gjithë shpikësve në grup, dhe quhet shpikësi i parë, shpikësi i dytë dhe shpikësi i tretë, dhe ata të gjithë e gëzojnë certifikatën e përbashkët.

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYETARI: Shaip, ligjin e kishe bërë prej fillimit vetë. Ky është leximi i dytë, dhe megjithatë ne i qëndruam parimit si ta dëgjojmë, por më mirë kishte me qenë ta futeni ndonjë amendament gjatë leximit të dytë. Profesor, a e dëshironi fjalën? Urdhëro!

MUHAMET MUSTAFA: Në vazhdim kësaj që e thatë ju, pikërisht ne kemi shumë ide këtu, që disa gjëra sigurisht edhe do të rregullohen, për shembull ky është shpikësi i parë, shpikësi i dytë, shpikësi i tretë dhe mund të rregullohen edhe këto aktet përcjellëse që do t'i nxjerrë ministria.

E sa i përket konformitetit evropian, ne i kemi dy vendime pozitive. Nën një e kemi Komisionin për integrime evropiane, nën dy mendimin e Zyrës së konformitetit me 'acquis communautaire' dhe ne duhet t'u besojmë këtyre organeve.

Çështjet tjera, mendoj se janë ide për t'i diskutuar, por sot nëse hyjmë për secilën ta diskutojmë, është e tejkualuar dhe ne kemi pasur debat në Komision dhe disa herë e kemi pas debatin parimor këtu dhe mendoj që sot ky diskutim është i vonuar. Është i vonuar dhe nuk po dua të lëshohem se sa është i drejtë apo i padrejtë, për arsye se në të shumtën çështjet janë të zgjidhura mirë dhe në konformitet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Shaip, urdhëro, por shkurt!

SHAIP MUJA: Zoti kryetar,

Pa dashur të keqkuptohem, ky ligj është shumë i domosdoshëm dhe nuk po them unë që ky ligj të anulohet, por më mirë, nuk ka ndonjë urgjencë ky që të aprovohet sot sepse me këtë ligj, me aq sa unë jam i orientuar dhe nuk kam dashur të paraqet amendamente që të kalojë si Naiti, ose si dikush tjetër.

Unë e di si funksionojnë amendamentet në komisione, prandaj unë po flas për çështje të procedurës së procesverbalit. Le të mbetet në procesverbal, ta lexojë dikush, siç e kam lexuar unë çka ka thënë zonja Hykmete në mandatin e kaluar. E kishte zërin më të lartë, thoshte, për shembull që më mirë është mos me sjell ligje të këqija se sa që po i miratojmë. Po edhe unë po them, ky nuk është ligj i keq.

Ju zoti kryetar i Komisionit thoni jemi thirrur në direktiva! Ku është thirrja në Agjencinë Kosovare për Produkte Medicinale, në këtë ligj. Ndërsa ti thua për çështje të zbulimeve biologjike të bimëve, patentime të bimëve, kush është ekspert në atë agjenci që ti do ta punësosh, por duhet ta marrësh mendimin profesional dhe institucional, duke filluar nga testimet klinike, nga testimet paraklinike dhe duke testuar nga toksociteti i barnave bimore me përmbajtje aktive të substancave që përdorin bimë gjatë një trajtimi, qoftë nga yndyrat ose nga lëngjet që mund të pihen.

Ne, e kemi një shkencëtare e cila pretendon sot nëpër media, thotë kam zbuluar. Dhe, ne si shtet nuk jemi në gjendje t'ia mbrojmë atë produkt i cili shëron, ose pretendon se shëron disa çështje, por e kemi politizuar dhe aq më shumë e kanë nxjerrë edhe në procedura të penaltetit duke e hetuar se ka bërë një krim shumë të madh. Prandaj, ne për të mos e sjellë këtë situatë të tillë, ne duhet të paraqesim çdo detal të mundshëm dhe direktivat e Bashkimit Evropian...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYETARI: Regjia, mos ia ndalni fjalën!?

SHAIP MUJA: ...të adaptueshme. Janë direktivat e Bashkimit Evropian në të cilat thirret edhe zonja Hykmete që i di, por edhe zoti Mustafa, që nuk janë obligative, por janë të adaptueshme. Çdo shtet i adapton sipas rrethanave të veta, por është e kënaqshme nëse ne mund t'i nxjerrim sipas një standardi të një shteti. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Profesori tash e ka fjalën!

MUHAMET MUSTAFA: Përsëri, është e njëjta situatë, kur është fjala për Agjencinë për Produkte Medicinale. Natyrisht, kur të regjistrohesh patenta, Agjencia për Pronën Industriale do të zhvillojë procedura, do të marrë mendime profesionale nga organizatat që janë dhe do të nxirren edhe akte tjera.

Ne këtu nuk mund t'i numërojmë të gjitha entitetet profesionale në një ligj për arsye se ajo është një procedurë që patjetër, nëse patenta është në fushën e mjekësisë, do të konsultohen organizatat tjera.

Prandaj, mendoj se nuk kemi nevojë t'i mbajmë njëri-tjetrit ligjëratë dhe të thërrasë Mustafa, ose unë Shaipi. Këto gjëra me kënaqësi i kishim diskutuar por mendoj se ligji e përmban atë që duhet përmbajtur dhe natyrisht që praktika do të tregojë se a ka nevojë diku të përmirësohet apo jo.

KRYETARI: Faleminderit shumë! Shaip, si pingpong mund të mbajmë sa do gjatë, por me aq sa po shohim, edhe kësaj seance i ka ardhur përfundimi, se i kemi edhe 2 minuta që të presim, sepse realisht nuk kemi deputetë në sallë. Urdhëroni! Ministrja do ta marrë fjalën, e në ndërkohë, nëse vijmë deputetit, do të votojmë.

MINISTRJA HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit kryetar!

Nënkryetar,

Të nderuar deputetë,

I nderuar deputet Shaipi,

Këtu ju jeni në cilësinë e deputetit, e unë jam në cilësinë e ministres, si zonjë nuk i kisha prurë këtu ligje. E para.

Dhe e dyta. Në kohën kur unë kam qenë deputete, në leximin e dytë, ne kemi prurë amendamente dhe asnjëherë nuk kemi hapur diskutime.

Unë mendoj se vlera e diskutimit të sotëm, sa për të mbetur në procesverbal, nuk ka asnjë vlerë. Ju është dashur të angazhoheni dhe t'i sillni sot amendamentet, e ne do të duhej të jemi të sigurt në atë që e diskutojmë dhe të arrijmë t'i bindim tjerët.

Nëse themi, e dimë se si funksionon dhe çka bëhet me amendamente, atëherë ne po pranojmë se kontributi ynë në këtë sallë është zero, kështu që ju ftoj ta votoni, sepse besoj që e ka përkratur edhe Komisioni. Faleminderit!

KRYETARI: Shaip, pasi ta ka përmendur emrin, por edhe ashtu nuk kemi deputetë dhe Shaip kot po flasim. Por, urdhëro Shaip!

SHAIP MUJA: Zoti kryetar,

Mua po më befason që po thotë zonja Hykmete s'ka asnjë vlerë debatimi në leximin e dytë. Kjo tregon që kësaj shoqërie që përfaqësohet në Qeveri i mungon memoria institucionale. Bash vlera kryesore është tash zonja Hykmete, sepse po ta çova unë ty në kushtetuese, që e di ti se mund të shkojë në kushtetuese dhe të kthehen për koalizion, që bien me ligje tjera.

Prandaj ti ke qenë shumë e zëshme dhe e ke çua, e ke shurdhura këtu sallën duke e çua zërin, e tash je bë shumë e moderuar dhe është shumë e çuditshme. Prandaj, ligjin nuk po e kundërshtoj unë dhe nuk jam duke e kundërshtuar, por jam duke sugjeruar që nuk ka asnjë urgjencë ky ligj, e nëse ju keni interes që ta shndërroni në agjenci për t'i punësuar disa njerëz, unë jam për ta shndërruar në agjenci, por jo me një ligj të tillë dhe i cili nuk i bën dobi as zhvillimit ekonomik e as industrisë që ju e përfaqësoni pas zhvillimit teknik.

Dhe, zoti Mustafa tha, ne mund t'i parashohim. Nuk mund t'i parashohësh me udhëzime administrative institucionet referente që me ligj duhet t'i referohesh. Nuk është e vërtetë, jeni mësuar me udhëzime administrative dhe e shkatërruat shtetin. Për atë edhe kjo punë, sepse ju jep dimension ministrave, por ju jep ministrave dhe sipas qejfit të udhëzimit administrativ ta krijoni, sipas kutit të vet. Prandaj, ne nuk guxojmë të lejojmë ligje të cilat na paraqesin probleme.

Pse çka të kushton ty të thuash qëndër referente do të jetë Agjencia Kosovare për Produkte Medicinale dhe do të thirresh në ligj, sepse kur e ke miratuar ligjin me zonjën Hykmete herën e kaluar që unë kam kundërshtuar për procesverbal, dhe mos ta miratojmë atë ligj, ju keni thënë se ligji... dhe bash zoti Beqiri ka qenë këtu i cili i ka kundërshtuar qëndrimet dhe amendamente e mia. Dhe sot, në këtë ligj, bie në kolizion ajo, prandaj memoriën institucionale kthjelleni pak. Nuk jemi ardhur këtu të bëjmë hajgare. Qytetarët kanë nevojë dhe këto shtresa intelektuale që janë duke dalë në Republikën e Kosovës nuk mund të na i falin neve ligjet të cilat nuk dinë të orientohen askush.

KRYETARI: Faleminderit! Smajl, je lodhë, a? Po s'jemi në numër o Smajl! Profesori u lajmërua, por si po e shihni, ne do t'i vazhdojmë diskutimet, por seancën do ta kemi nesër në orën 10:00, për çka ju paralajmëroj, meqë sot s'kemi kuorum. Pra, do ta vazhdojmë seancën nesër, në orën 10:00. Faleminderit!

\* \* \*

*Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 30 korrik  
Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.*

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Vazhdojmë me punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, e filluar më 30 korrik 2015, me pikat e papërfunduara, si në vijim.

### **- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për letërnjoftimin**

Të nderuar deputetë,

Kuvendi në seancën e djeshme ka shqyrtuar projektligjin për letërnjoftime dhe i ka miratuar amendamentet prej numrit 1 deri në 7, por në mungesë të kuorumit kanë mbetur pa u votuar amendamentet 8 dhe 9, si dhe teksti i projektligjit me amendamente.

Procedojmë me votimin e amendamenteve 8 dhe 9.

Amendamenti 8, i deputetit Nait Hasani, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Shkojmë vetëm kush është kundër, në qoftë se nuk ka kundër aprovohet. 64 deputetë janë në sallë. Nait ke folur dje. Urdhëro, Nait nuk punon foltorja, prandaj ju kisha lutur ta përdorni foltoren kryesore.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për deputetët,

Amendamentin që e kam propozuar dy herë dje nuk kishte numër të kuorumit në sallë edhe që deputetët votuan që të mos kalojë, është interesant, është e çuditshme kur të vetmit jemi ne shqiptarët që kërkojmë të heqim dorë nga identiteti ynë. Kjo është dëshmuar nëpër shumë vende, u dëshmuua kur shumë shqiptarë shkuan jashtë dhe e ndërruan kombësinë e etnitetin dhe kanë treguar që nuk janë shqiptarë për t'i fituar disa të drejta të tyre. Bile në njëfarë rasti, e kishin pyetur Haxhi Merxhën e ndjeri, tashmë nuk është më, ka qenë deputet dhe ishte në Bruksel me një zyrtar tonin, ai i tha “ju pakicat”. Haxhi Merxha i tha mos më thuaj, se nuk jemi pakicë, ne jemi shumicë, se krejt shqiptarët po shkruajnë sikur ne romët. Prandaj, neve na duhet identiteti ynë. Dokumentet, të cilët ne i lëshojmë, i posedojmë, duhet ta dëshmojnë identitetin tonë shqiptar dhe të mos e fyejmë askënd, por as të mos na fyejë askush me keqpërdorimet e veta që i bëjnë nëpër të gjitha vendet.

Unë kërkoj që deputetët ta votojnë amendamentin dhe ta mbrojmë identitetin tonë shqiptar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, Nait!

Atëherë amendamenti 8.

Kush është kundër propozimit të Nait Hasanit? Kundër, ju lutem, ngrehini duart kush është kundër. Adem, kush është kundër propozimit të Nait Hasanit? Kush është për? 26 vota janë kundër, 21 janë për. Kush është për abstenim? 7 abstenim.

Nuk ka numër të mjaftueshëm, janë 54 vetëm. Jo, jo pa i bërë 61 vota ne nuk e konsiderojmë as që ka kaluar, as s'ka kaluar.

Atëherë, dëgjoni. Do të votojmë edhe një herë, do ta marrim vetëm prezencën në sallë edhe kush është për, të tjerët i marrim, Nait nuk kalon propozimi juaj, 65 deputetë në qoftë se nuk kalon, pjesa tjetër merret se është kundër teje.

E lëmë për më vonë, e lëmë për fund. Vazhdojmë. Jo, jo e lëmë më vonë, me marrëveshje, ndoshta rregullohet elektronika, po shoh se edhe po skuqemi kur po votojmë kështu, ndoshta me elektronik.

### **- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për patenta**

Të nderuar deputetë,

Ju njoftoj se diskutimet për këtë pikë kanë përfunduar në seancën e djeshme. Në këtë projektligj janë propozuar gjithsej 10 amendamente.

Vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara sipas radhës të paraqitur në raportin e Komisionit FunkSIONAL.

Një deri në dhjetë të gjitha janë me unanimitet të Komisionit, shkojmë i votojmë të gjitha, vetëm kush është kundër. Përndryshe, aprovohet në qoftë nuk ka shumicë kundër.

65 deputetë janë në sallë.

Kush është kundër? Nuk ka. Aprovohen të gjitha.

Shkojmë në votimin e tekstit të Projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Pasi elektronika nuk punon për deputetët të cilët janë duke ulë jemi në shqyrtimin e dytë të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për patenta.

Votojmë tash:

Shqyrtimin e dytë të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për patenta. Kush është për? Kush është kundër? Edhe e aprovojmë se po shihet se shumica janë. Kush është kundër? Veç ta shohim kush është kundër. Nuk ka kundër. A ka abstenim? Abstenim është Shaipi edhe Ismajli. 68 deputetë janë, i kemi dy abstenime, pa kundër. Atëherë, Kuvendi e miratoi Ligjin numër 05/L-039 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 04/L-029 për patenta.

Vazhdojmë me pikën e radhës:

### **- Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Shkencës**

Salih, e ke kërkuar fjalën? Salih Morina e ka fjalën në emër të Komisionit FunkSIONAL.

SALIH MORINA: Faleminderit, kryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë sot këtu kam dalë që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet do të thotë për mbledhjen e radhës sidomos do të thotë për mbledhjen në vjeshtë me të vetmin arsyetim që ministrin sot këtu nuk e kemi prezentë dhe ministri është dashtë që paka shumë të na japë sqarime rreth vendimit të Këshillit Kombëtar të Shkencës. Ne u dakorduam bashkarisht edhe me kryetarin e Komisionit që kjo pikë e rendit të ditës të tërhiqet dhe kjo pikë e rendit të ditës të mbetet për shtator për sezonin e vjeshtës. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit!

Kemi një propozim nga Komisioni Funkcional, a e qesim në votim. Bekim, Ismajl a e dëshiruat fjalën, duhet dalë në foltore. Ismajli le të dalë një herë, Bekim.

**ISMAJL KURTESHI:** Faleminderit, kryetar!

Unë vetëm për shkak të korrektësisë desha me thanë se në Komision nuk është marrë ky vendim, ju e keni marrë dje edhe me shkrim vendimin e Komisionit edhe arsyetimin se këto propozime duhet t'i kthehen ministrisë Qeverisë më vonë, ndoshta Kryesia e Komisionit, nënkryetari dhe kryetari kanë marrë ndonjë vendim në krye vete, por kjo nuk është e Komisionit. Megjithatë, për mua nuk paraqet ndonjë problem të madh. Po si praktikë paraqet problem, sepse në emër të Komisionit duhet të flitet vetëm atëherë kur edhe i merr vendimet Komisioni. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Bekim, urdhëro!

**BEKIM HAXHIU:** Faleminderit, i nderuar kryetar!

Sinqerisht propozimi i kolegut është një propozim, i cili ka ardhur tani, mirëpo esenca është që ky këshill, edhe atë debat që e kemi pasur në Komisionin Parlamentar, të kompletohet dhe të jetë një përfaqësim institucional i të gjitha fushave shkencore në Kosovë me një përfaqësim edhe tani të universiteteve të reja të krijuara, ato duhet të përfaqësohen, të mos kemi përfaqësim të një fushe shkencore nga 2,3 deri në 4 kandidatë. Mirëpo, që në këtë Këshill Shkencor të jetë një përfaqësim më i mirë i fushave shkencore dhe teknologjike që shkenca të jetë në dobi të shoqërisë ashtu si ka qenë prej ekzistimit të shkencës në të mirën e shoqërisë duke propozuar institucioneve qendrore dhe komunale që ato vërtetë të jenë në shërbimin më të mirë të qytetarëve, kjo është edhe qëllimi i këtij këshilli. Mua më vjen keq që prej themelimit të këtij këshilli, ekzistencës së tij.

Ka pasur shumë pak punë, çdo njëri prej jush mund ta kërkonte në internet Këshillin Kombëtar të Shkencës veç përveç atyre civateve të cilat kanë qenë për këtë këshill në Kuvendin e Kosovës nuk mund të gjeni një ueb sajt të Këshillit Kombëtar të Shkencës, ndërsa këshillet kombëtare të shkencës të vendeve të rajonit, të Evropës, por edhe Këshilli Internacional Kombëtar të Shkencës mund të gjeni edhe publikime, edhe strategji dhe të gjitha tjerat, por ky këshill nuk ka përfaqësuar atë për çka është themeluar edhe në bazë të ligjit për kërkimet shkencore prandaj kërkoj që ministria edhe njëherë të ulet dhe këto propozime, të cilat vijnë për këshillin kombëtar të shkencës të jenë konform ligjit që këto propozime t'i propozojnë institucionet arsimore, institutet kërkimore dhe ato pastaj të procedohen për Kuvend. Dhe ky përfaqësim i sferave të ndryshme e begaton këshillin dhe do t'i ndihmojë institucioneve qendrore dhe komunale që ato pastaj të ndjekin strategjinë e tyre zhvillimore në dobi të shoqërisë.

Vetëm kërkoj që në shtator të na vijë emra të tjerë dhe të procedohet për arsye se këta nuk e kanë përmbushur misionin për të cilën është themeluar me ligj ky këshill. Ju kujtoj edhe një vërejtje e cila do të jetë e drejtpërdrejtë për Qeverinë e Kosovës me këtë ligj janë paraparë në 0,7% e buxhetit të ndahet për këtë këshill, për shkencë për hartimin e strategjive dhe objektivave të tjera shkencore.

Deri më tani ky këshill ka pasur në dispozicion jo këto mjete të parapara me ligj, ka pasur shumë më pak prandaj kërkoj që nga viti i ardhshëm të procedohen në veçanti një vërejtje më e madhe për ministrin e Financave që këto mjete t'i alokojë si vijë buxhetore për këshillin kombëtar të shkencës për hartimin e strategjive dhe projekteve shkencore. Në veçanti, për mbështetjen e hulumtuesve të ri në aspektin shkencor. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! I dëgjuam deputetët, ne do të votojmë, vetëm për propozimin të cilin e jepi deputeti Saliu. Kush është për që të bartet në sesionin vjeshtor? Kush është për?

Atëherë, siç po shihet, mos është kundër? Tre vetëm. Realisht ndoshta, abstenim a ka? 3 abstenime. Realisht, u shty për sesionin vjeshtor duke i konstatuar se kemi dy kundër, 68 vetë kanë genë, 2 kundër, 3 abstenime tjerët janë për.

Shtyhet kjo pikë e rendit të ditës për sesionin vjeshtor. Rikthehemi tek, shqyrtimi i dytë i Projektligjit për letërnjoftime tek amendamenti i 8 i deputetit Nait Hasani pa përkrahjen e komisionit funksional. Urdhëro, Nait edhe njëherë. Po tash realisht qartëso, edhe i kisha lut deputetët të futen në votim por një qëndrim ta marrim pro, kundër, abstenim një qëndrim duhet ta marrim.

**NAIT HASANI:** Faleminderit! Edhe njëherë po dëshmohej lufta për pushtet, unë kam kuptuar që pushteti është mjaftë i rëndësishëm edhe duhet të mbrohet pushteti, por në luftën për pushtet duhet të mbrohet edhe shteti.

Duhet të mbrohet edhe kombi, duhet të mbrohet identiteti. Në këtë pak të them që nuk më habit vendimi ose votimi kundër i një pjese të deputetëve, sidomos i pjesës që është tash me kryeministrin në pushtet. Është interesant, kjo traditë ka vazhduar herët unë nuk jam i interesuar t'i kthehem asaj, unë jam i interesuar që identiteti jonë kombëtar të mbrohet me dokumente, prandaj votojeni.

**KRYETARI:** Shkojmë kështu, më fal Teutë, shkojmë a e kryejmë këtë votim në marrëveshje të përbashkët, vetëm kur është për, përndryshe...

Dëgjo, mos të hyjmë në teori konspirative për arsye se elektronika as nuk e di si u prish, si e gjeta unë dhe ju e keni gjetur, por ani gjithë natën kam për të ndenjur tjera herë më nuk prishët, ishalla jemi shëndosh e rahat. Dëgjo, po votojmë, u prish profesor nuk kam çka i bëj për besë, shyqyr që s'është diçka më e rëndë. Njerëz janë mirë.

Dëgjo, po shkojmë po e votojmë veç kush është për, për propozimin e Naitit tjerët e marrim, dëgjo më fal, në qoftë se nuk janë Nait për tjerët merren të gjithë kundër dhe nuk kalon. Do të

votojmë, ... po s'po bën 61. Shkojmë, kush është për hajde do të shkojmë kundër, dhe abstenim edhe përfundojmë.

Do të shkojmë në bazë të Rregullores, kush është për, për amendamentin 8 deputetit Nait Hasani pa përkrahjen e komisionit funksional. Kush e përkrah këtë propozim të Nait Hasanit, kush është për?

Kush është kundër propozimit jo s'ka debat, jo se po ka reaksione. Kush është kundër propozimit të Nait Hasanit në amendamentin e tetë, vetëm kundër kush është? Dhe kush abstenon, vetëm abstenim, ju lutem? 5 abstenim.

Atëherë, 63 deputetë, 24 kanë qenë për propozimin e Nait Hasanit, 35 kanë qenë kundër propozimit të Nait Hasanit, dhe 4 abstenim. 69 deputetë kanë qenë gjithsej në sallë, Nait nuk kalon.

Amendamenti i 9 i deputetit Çerim Bajrami me përkrahjen e komisionit. Kush është kundër? A ka kundër? A e lexoj? Amendamenti i nëntë i deputetit Çerim Bajrami me përkrahjen e komisionit, neni i 10 shtohet paragraf i ri me përmbajtje si në vijim: formularin dhe letërnjoftimet për pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë shtypen edhe në gjuhët e tyre të cilat janë në përdorim në nivel lokal. Domethënë, formularët kanë me u shtyp në gjuhën e komuniteteve në nivel lokal.

XHAVIT HALITI: Unë mendoj që e kemi një normë kushtetuese në komunat ku janë 3% që e përbëjnë pakicat kanë të drejtë ta përdorin gjuhën e tyre. Dhe, ajo nuk mund të jetë normë në një komunë ku mund të jenë pesë veta dhe tani krejt komuna t'i ketë formularët e përgatitur për pesë veta.

Të zbatohen rregullat Kushtetuese në përputhje me këtë të bëhen edhe formularët dhe kemi zgjedhur me normë kushtetuese dhe unë mendoj që s'ka nevojë që të ketë kesi lloj amendamenti hiç.

KRYETARI: Atëherë, jemi tek Çerim po urdhëro, Çerim Bajrami e ka fjalën. Çerim duhet të dalësh në foltore.

ÇERIM BAJRAMI: I nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Vetëm një sqarim pasi nuk e keni elektronikën atje në vend, domethënë këtu është fjala për ato gjuhët, të cilat janë të pranura në nivelin lokal me Ligjin e përdorimit të gjuhëve.

Ovde je riječ dakle o onim jezicima koji su u upotrebi u lokalnom nivou po Zakonu o upotrebi jezika u Republici Kosovo. Ovi jezici koji pripadaju ovoj stavci su trenutno samo bosanski i turski, zato što je po Zakonu u upotrebi jezika dakle ograničeno je ovo što gospodin potpredsedavajući Skupštine rekao na pet, odnosno tri procenta. Trenutno, pošto taj zakon to ograničio, na Kosovu imamo samo upotrebi bosanski i turski jezik na lokalnim nivoima. To je jedno, drugo dakle imamo praksu koja je dakle u razvoju upotrebi već godinama na Kosovu, a to je da imamo formulare na lokalnom nivoima koji se izdaju na ova dva jezika. Takođe imamo

praksu unazad dve godine da se lične karte već i izdaju na turskom jeziku, i ovo je pravo koja bosnjačka i turska zajednica tražila unazad 15 godina.

Na žalost imamo jednu lošu praksu nasledenu iz UNMIK administracije da se nastavilo onom praksom koja je bila negativna, a sada pošto imamo definisanu stvar Ustavom Republike Kosovo, imamo takođe i definisano jasnu stvar Zakonom upotrebi jezika u Republici i Kosova. Sve je jasno, imamo praksu na terenu. Ovde riječ o zakonu o ličnoj karti, gde se jasno i glasno precizira komplet njen sastav i treba takođe ovim zakonom da se dodano precizira i ova odreda odredba. Prema tome, gospodine potpredsedavajući, u ovoj odredbi, ako ste dobro pročitali, ja je moram ponoviti, na albanskom ili drugom službenom jeziku jako je loš prevod, dakle jasno govori: formularët dhe letërnjoftimet për pjesëtarët e komuniteteve joshumicë shtypen edhe në gjuhët e tyre, të cilat janë në përdorim në nivel lokal.

Domethënë, kufizimi është në këtë fjalën e dytë dhe nuk është diçka që vlen për të gjitha komunitetet, vetëm për këta gjuhët të cilat janë në përdorim në nivel lokal dhe të cilët e kanë 5% e pjesëtarëve të komunitetit të vetë në këtë komunë.

Është i qartë dhe duhet domethënë të jetë kështu siç është në praktikë, sepse është fjala për Ligjin për letërnjoftime. Faleminderit!

KRYETARI: Fadili nga komisioni përkatës, e dëshiron fjalën si raportues? Urdhëro, Fadil ndërkohë e shohim edhe a kemi edhe kuorum.

FADIL DEMAKU: Faleminderit, kryetar!

Sa i përket këtij amendamentit të cilin e sqaroi edhe deputeti Çerim Bajrami ky është edhe anëtari i komisionit është diskutuar në komision ky ka gjet përkrahjen e anëtarëve të komisionit ka mbet që tani të vendos seanca sa i përket këtij amendamenti. Po para se të votohet nëse më lejohet kryetar, veç ta jap edhe një sqarim të cilin e kam dhënë edhe dje po mbasi nuk është votuar ligji te neni 9 te përmbajtja e letërnjoftimit te pika 1.21 të futet edhe grupi i gjakut ka qenë kërkesë e anëtarëve të komisionit. Faleminderit!

KRYETARI: Siç po e shoh, ne jemi para përfundimit të seancës, nuk ka kuorum. 59 deputetë janë për të biseduar, vetëm për të biseduar, por kuorum nuk kemi dhe s'mund të vazhdojmë më tutje.

Emilija urdhëro çfarë dëshiron, po presim edhe dy minuta ndërkohë që Emilija po flet, por realisht nuk kemi numër të mjaftueshëm për votim.

EMILIJA REDŽEPI: Hvala, gospodine predsedniče!

Poštovani kolege poslanici,

I te kako je važno da po ovom zakonu latinično pismo se ubaci na ličnim kartama, iz razloga za to što je Bošnjačka zajednica je treća po broju stanovnika na teritoriji Kosova, i jako je ubačen Turski jezik kao službeni jezik na ličnim karta, i već postoje te lične karte uz svu uvažavanje poslanicima iz Turske zajednice, koji su izdejstvovali na ovom Parlamentu i na nama je velika odluka da ubacimo i latinično pismo kao obeležje jedne nacije u institucijama kosovskog sistema. Zahvaljujem!

**KRYETARI:** Faleminderit! Atëherë, të nderuar deputetë, më vjen keq, po të shkojmë në pauzë, prapë nuk besoj... Po e përfundojmë sot seancën, apo po shkojmë në pauzë?

Xhaviti e ka fjalën.

**XHAVIT HALITI:** Unë edhe një herë po e përsëris dhe e mbroj qëndrimin në e kemi një Kushtetutë e cila garanton gjuhët që përdoren në Kosovë. Në qoftë se e ndryshojmë Kushtetutën kemi të drejtë tani me bë çfarë të duam. Unë dëgjova që ka edhe letërnjoftime turqisht unë nuk e di që është me Kushtetutë të Kosovës që letërnjoftimet shtypen turqisht, ne e dimë që gjuha turke nuk është gjuhë zyrtare në Kosovë dhe ne jemi aq tolerantë sa edhe në Parlamentin e Kosovës flitet turqisht dhe askush s'i ka ndaluar asnjëherë.

Gjuhët lokale janë gjuhë lokale të zgjedhura me Kushtetutë por Kushtetuta ne duhet të flasim drejt qysh e kemi situatën me amendamentet, le të propozohen amendamentet kushtetuese dhe le të respektohet kjo. Sa i përket formularëve unë nuk e besoj që është pengesë këtu gjuhët zyrtare që janë në Kosovë që t'i lexojnë edhe në gjuhët tjera të cilët i dinë shumë mirë dhe janë të njëjta pothuajse. Ne mundemi t'i shkruajmë, t'i shtojmë shpenzimet administratës dhe ku ta di unë.

Ta thjeshtësojmë situatën që e kemi. Askush s'e ka ndaluar asnjëherë dikë që të flas në gjuhën e tij në Parlamentin e Kosovës edhe pse prapë po e përsëris me Kushtetutën e Kosovës e kemi zgjedhur këtë problem për komunitetet që e kalojnë 3% në lokalitet ku jetojnë. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Cili i pari, Fikrim urdhëro! Fikrim Damka e ka fjalën.

**FIKRIM DAMKA:** Faleminderit, i nderuar kryetar!

Po më vjen keq se nënkryetari nuk e dinë mirë tamam saktë ligjin edhe për përdorimin e gjuhëve edhe për Kushtetutën, të lutem në qoftë se thua ti sipas Kushtetutës atëherë më tregoni në Kushtetutë a është ligji zyrtarë gjuha angleze, gjuhë zyrtare a është gjuha anglisht në Kushtetutë? Atëherë pse po ekziston në letërnjoftime gjuha angleze.

Tash, sipas Ligjit për përdorimin e gjuhëve në Prizren pa marrë parasysh në përqindje gjuha turke është gjuha zyrtare, ky është në ligj, të lutem nënkryetar, edhe tash për tash në letërnjoftimet tona e kemi gjuhën turke. Jo nuk është, aspak nuk është edhe sipas ligjit edhe sipas Kushtetutës është atëherë është kundër edhe gjuha angleze sipas Kushtetutës, jo të lutem.

**KRYETARI:** Urdhëroni, kuorum nuk kemi Çerim Bajrami si propozues, Emilija pastaj po e kërkon edhe ajo fjalën, vetëm qetë. Urdhëro, Çerim!

**ÇERIM BAJRAMI:** I nderuar kryetar dhe nënkryetar i Kuvendit të Kosovës!

Do të flas në gjuhën boshnjake, sepse flas zyrtarisht.

Këtu në shpjegimin tim para komisionit, edhe zoti Fadil Demaku e ka përmendur mirë që tërë komisioni e ka përkrahur këtë amendament për shkak të diskutimeve të gjata e me detaje, me argumente, edhe pro, edhe kundër, edhe kemi ardhur deri në këtë propozim.

Unë, pasi ju zoti nënkryetar, bazoheni në Kushtetutën, Kushtetuta në neni 5, dakle u Ustavu, član 5 jasno govori da su službeni jezici na Kosovu - albanski i srpski, a na lokalnim nivoima su

upotrebi jezici bosanski, turski, i romski, odnosno u Ustavu piše, da budem precizan - turski, bosanski i romski. Zakon o upotrebu jezika je jasno definisao i ograničio ovu odredbu na pet procenta stanovništva i nevećinskih zajednica koji je zakon, dakle u kojoj opštini može da bude u upotrebi taj jezik. To je zvanični jezik pet procenta, jezik u upotrebu može da bude sa tri procenta, međutim nema isti nivo. Dakle, u međuvremenu smo došli do spoznaje u kojim opštinama na Kosovu žive Bošnjaci turci, i romi, i ostale nevećinske zajednice.

I ovaj zakon je bukvalno romima, bez obzira na priznanje u Ustavu, onemogućio da imaju jeziku u upotrebi, zato što nemaju nigde tri i pet procenta, statuti opština Prizrena, Dragaša, Peći, Istoka, Prištine, Gnjilana, Mitrovice su jasni i glasno kazali koji su jezici upotrebi, i tamo stoji da su negde bosanski negde turski. Takođe, ako ste dobro pročitali, a verujem da ste dobro pročitali Zakon o upotrebi jezika na Kosovu, jeste ga vi ovde doneli, taj zakon je jako širok, i omogućava nevećinskim zajednicama da imaju prostora za upotrebu i službenu, i osobnu, i obrazovnu informativnu svojih jezika. Dakle nije ograničavajući, nije zakon komunističkog perioda, i donet je u jednom vremenu kad je ovde došla demokratija, i taj zakon je otvoren, i tamo se jasno govori o ličnim dokumentima o osobljem dokumentima, o osobnim dokumentima, ako oćete na bosanskom, o službenim dokumentima, o državnim dokumentima, i taj zakon se na terenu sprovodi. On se sprovodi dakle u Prizrenu i u Dragašu, i u Peću, i u Gnjilanu, i u Prištinu se izdaju posebna dokumenta kao što su rođeni izvodi, i ostala dokumenta i na ovim jezicima.

Ne možete danas da ograničite jednu osobu bošnjačke ili turske nacionalnosti, da ima ličnu kartu u džepu - letěrnjoftimet - i da ne zna šta na njoj piše. Danas deca generacije koji su spasali posle rata na Kosovu ne znaju šta piše na ćirilici u njihovoj ličnoj karti! I gotovo! Jasno je ovde stvar! Prema tome, ako ćete danas da ograničite jedno pravo koja je jasno govori u ćlanu pet Ustava, i u Zakonu o upotrebi jezika, dakle u ćlanu dva, ako neko ima taj zakon neka ga otvori, u paragrafu pet, i u ćlanu 8, od paragrafa 1 do paragrafa 3, naćićete ovu odredbi gde smo mi našli naše pravo za dakle štampanje, odnosno izdavanje lićne karata i na bosanskom, i na turskom jeziku. I nemojte ništa da govorite da su turci, ćuo sam politićke priće, dobili nešto uz pomoć bivše vlade. Nije istina! Bivši premijer i bivša vlada je ispunila turskoj i bošnjaćkoj zajednici ono što mi traćimo 15 godina ovde na Kosovu.

Samo su sada izašli u prošlom mandatu u susret. Ispunjeno je jedno pravo posle 15 godina traćenja, i niti je protivustavno, niti je protiv zakonsko, nego samo omogućava još jedno pravo u ovim zajednicama i daje Kosovu još jedan demokratski rejon, ako neko pita 'kuda ćemo sa ovom lićnom kartom', ja ću vam reći da idemo u Evropsku uniju. I ovo pravo ne vaći da piše na vaćoj lićnoj karti na bosanskom ako nećete, nego da piše na onoj lićnoj karti, koji kad podnese zahtev tamo napiše: 'Ja hoću lićnu kartu na bosanskom'. Za pripadnika turske zajednice, on će nam pisati da hoću na turskom. Na vaćem lićnu kartu to neće pisati. Dakle piše samo na naćoj. I još nešto, naći graćani plaćaju te lićne karte, kao što plaćamo svaki dokument.

Prema tome, ako vas još nešto zanima pošto bi trebalo da vas zanima, ovaj se dao punu podrćku ovom amandmanu i u pismenoj, i usmenoj formi, pošto oni prate šta je to u redu sa demokratskim... na Kosovu, verovatno bolje znaju od mene šta je to dobro. Hvala!

**KRYETARI: Faleminderit, Qerim!**

Dëgjo, ka shumë diskutime, por kuorum nuk kemi. Jo veç sa për t'u konsumuar për hir të publikut. Emilija, Zenuni bëhet gati. Xhavit ka ende për të folur.

XHAVIT HALITI: Po dua t'i tregoj Qerim Bajramit, që po na jep moral.

Unë nuk kërkova që t'u refuzohet e drejta as për të folur, as për të diskutuar, as tu ndalohen ata formularët. Ju e keni bërë amendamentin, është në rregull. Nuk jam që të ndalohet ajo. Unë thash që me Kushtetutën e Kosovës janë të zgjidhura këto probleme dhe Ligji nuk mundet me qenë në kundërshtim me Kushtetutën. Në qoftë se, është në kundërshtim me Kushtetutën atëherë duhet të harmonizohet ai ligj me Kushtetutën. Ky është problemi.

Nuk ka nevojë as për nervozë, as për të menduar dikush që po duan t'ia kufizojnë të drejtën dikujt. Larg asaj, se edhe po të dua unë, janë të gjithë këta deputetë, që nuk do të lejojnë që të shkelen të drejtat e asnjë nacionaliteti në Kosovë, sepse e njohin të drejtën e të gjithëve, që të përdorin gjuhën, kulturën, traditën, gjithçka që atyre u intereson. Dhe, jam për ta respektuar, jo 3%-shin, po edhe njeri në qoftë, në e fliste ndonjë gjuhë që flitet në planet tjetër në Kosovë, me ia krijua kushtet dhe mundësitë, që të flasë, të paktën, vetë me vete. Por, problemi është... unë e ngrita, e thash një çështje që juve u preku, pa të drejtë. Më thoni, a është në Kushtetutë kështu si po e them unë, apo s'është. Këtë! Unë nuk u thirra në ligj, nuk u thirra as në atë propozim-amendamentin e juaj, i cili është e drejtë e juaja që ta bëni, është e drejta e deputetëve që ta miratojnë ose jo, është e drejtë e deputetëve që ta rishqyrtojnë këtë projektligj, sepse edhe nga palët e ndryshme ka vërejtje lidhur me këtë projektligj, por si ligjvënës, si kolegë, si njeri që besoj se kam kontribuar diçka edhe për juve, që ta keni këtë të drejtë personalisht edhe me kolegët e mi. Po, jap një vërejtje e dhashë dhe juve u preku, nuk e di pse.

KRYETARI: Emilija, Zenuni, Myferaja dhe në qoftë se, bëhen 61 deputet po futemi në votim.

EMILIJA REDŽEPI: Zahvaljujem, predsedniče!

Ja podržavam, na žalost, ono što je gospodin potpredsednik Xhavit Haliti sada rekao. To jeste tako kako jeste u Ustavu Republike Kosove službeni jezici na Kosovu su Albanski i Srpski. Međutim, ako se napravio propust i tolerancija za turski jezik a popis stanovništva govori nešto sasvim drugo, govori da smo mnogo više mi Bošnjaci od turske zajednice, kolege poslanici, na nama, na vama svima ovde jeste velika obaveza, da li ćete to da izglasate ili nećete da izglasate.

Onda ćemo mi kao Bošnjačka zajednica znati gde smo. Ono što ja mogu da zamolim moje kolege poslanike unutar Parlamentarne Grupe PDK da nas podrže a naravno i koaliciju sa kojima smo sada u aktuelnoj vlasti. Zahvaljujem se!

A žalosno je što pripadnici AAK nisu ovde, ali se zahvaljujem Dautu Haradinaju, zahvaljujem se Nuridinu, Antonu, Fadilju, Ganimetri, što su podržali na komisiji predlog gospodina Bajramija, zahvaljujem se svima onima, znam da je bilo teško. Ali, molim vas! Bošnjački jezik mnogo više vredi da bi se ovde raspravljalo o jednoj zajednici. Naše pravo je da imamo latinično pismo u našim ličnim kartama i da budemo prepoznatljivi po tome. Hvala!

KRYETARI: Zenuni e ka fjalën dhe Myferaja pastaj. Më nuk do të kemi diskutime për këtë pikë derisa ta votojmë. Sot do të kemi, por herën tjetër, kur ta votojmë, e përfundojmë diskutimin me këtë herë, të merremi vesh.

ZENUN PAJAZITI: Po e shfrytëzojmë derisa nuk mund të bëhet, po shpresojmë, edhe kuorumi për votim. Mendoj që pas aprovimit të Kushtetutës ka pasur disa debate, në ndonjë prej tyre goxha shterues, për punën e përdorimit të gjuhëve dhe të drejtave të pakicave në përdorimin e gjuhëve. Edhe kur i kemi bërë dokumentet e para, ju e dini, ka pasur debat për përdorimin e alfabetit pastaj, që ne njëherë një version e kemi nxjerrë me alfabetin latin, e tjerë, e tjerë...

Mendoj që atë që e keni bërë ju në komision është mirë, e keni koordinuar me të gjithë deputetët e partive politike, por nuk është mirë që gjithë debatet me i nxjerrë në aspektet, sikur po na jepni a s'po na jepni të drejta. Mendoj që debati ishte, nëse është apo nuk është me Kushtetutë dhe me Ligj, është normal. Përndryshe, po aq sa keni ju përgjegjësi, normalisht që ju jeni ata që më së shumti keni përgjegjësi, se keni ardhur me vota të komunitetit tuaj këtu, për t'u kujdesur për përdorimin e gjuhës dhe alfabetit, por aq përgjegjësi kemi ne si komunitet shumicë. Bile, po ju them, që askush më shumë se ne në regjion nuk e ka marrë mësimin, se si nuk duhet të trajtohen pakicat. Të jeni të sigurt, që goxha shumë kemi edhe ne, jo vetëm përgjegjësi, por edhe atë që e kemi bërë e kemi bërë bashkë dhe duhet të krenohemi bashkë edhe me Ligjin edhe me Kushtetutën.

Mendoj që jo vetëm 2% a 3%, personalisht mendoj që asnjë qytetar i komunitetit pakicë, i cilitdo komunitet, nuk duhet t'i privohet e drejta për të shkuar e komunikuar në gjuhën e tij në një sportel të cilitdo shërbimi shtetëror në Kosovë e aq më tepër t'i ofrohet një formular i cili duhet të aplikojë për cilindo shërbim të tij në Republikën e Kosovës. mendoj që kjo është secili prej nesh mund ta bëjë dhe nuk ka një vullnet tjetër në këtë.

Debati ishte këtu më shumë, se a e kemi të rregulluar mirë me Ligj dhe me Kushtetutë apo jo. Mendoj, se deri tash nuk është shkelur Ligji dhe Kushtetuta. Mendoj, që ky amendament nuk e cenon askënd. Mendoj që veç ne na bën nder dhe mendoj që ju në mënyrën më të mirë, pa i politizuar këto debate shumë, duhet të vazhdoni kështu amendamentit derisa të dalë në votim, t'i punoni me kolegët tuaj të të gjitha komuniteteve dhe partive politike. Faleminderit!

KRYETARI: Myfera, fjala është për ju. Daut, përgatitesh. Po e përfundojmë debatin sot. Marrëveshje, më nuk do të ketë debat kur e vëmë në votim, qoftë sot, ose herën tjetër.

MÛFERA ŞINIK: Faleminderit, kryetar!

Teşekkür ederim,

Aslında bu tartışmaların bugün yersiz olduğunu görmekteyim. Fakat birkaç sefer Türk dilinin, Türkçenin konuşulduğu bir yerde de Türkçe essiz kalamaz, Türk temsilcileri sessiz kalamaz. Bu durumda, Anyasal hakkımız olan Türkçe ve yasal hakkımız olan Türkçenin kimlik belgelerinin olmasından dolayı bizleri destekleyen bütün milletvekillerine ben teşekkür ediyorum.

Bu durumda dönem bakanının da desteği vardır, bu yüzden Türkçe kimliklerin elde etmemizde çok büyük katkısı olan herkese teşekkür ediyorum. fakat Türkçenin ve Türk milletvekillerinin Kosova Parlamentosunda her zaman ön adımda olduğunu da bir kez daha vurgulamak istiyorum, ki peşimizden hemen Boşnak temsilcileri gelmektedir, onların da haklarını arama hakları vardır.

Ancak Türkçe ile Boşnakçanın her zaman aynı yerde olmasından bizler de yanayız, fakat Boşnakların daha fazla sayısı varsa biz Türkçeyi kimliklere koyduğumuz zamanda Boşnak

temsilcilerimiz de burda vardı, keşke onlar da biz kadar hazır, hızlı davransalardı, Ben tekrar desteklerinden dolayı teşekkür ediyorum, fakat bugün başkna yardımcımızın bu tepkisini de burdan kınıyorum. Herkese teşekkür ederim. Faleminderit, kryetar!

KRYETARI: Faleminderit! Dauti e ka fjalën. Profesor, e kërkuat fjalën edhe ju? Po. Profesori pastaj. Edhe ti Nur, po, po tash kush dëshiron, se po e konsumojmë për këtë amendament tani debatin.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryetar!

Shpresoj që nënkryetari shkon e mbyll bufenë se s'po bëhet kuorumi. Më parë dua ta jap një sqarim rreth këtij...

Këtu po shihet serioziteti i koalicionit. Ky ligj, domethënë propozimi i Qerim Bajramit e para është diskutuar gjerë e gjatë, jo njëherë, po disa herë në komision. Në komision ka deputetë, po fillojmë prej “Vetëvendosjes”, AAK-së, Nismës, LDK-së, PDK-së dhe të gjithë tjerëve, duke përfshirë edhe zotin Qerim Bajrami. Kjo në konsensus është dhënë vota për të mos e prishur harmoninë e komisionit. propozimi i Qerim Bajramit është i një anëtarit të komisionit, i cili ka kërkuar që të përfshihet gjuha boshnjake aty ku është 5% e më shumë i banuar, domethënë në atë nivel komunal, ku ka 5% e më shumë, duhet të shtohet gjuha.

Sa për informacion, zoti kryetar, në Serbi nuk përmendet, kqyrni në çirilicë e keni të shkruar në letërnjoftim, serbët në Serbi nuk e shkruajnë me çirilicë por e shkruajnë latinicë. Kjo gjuhë nuk i përfaqëson boshnjakët, ky tekst nuk i përfaqëson kroatët, nuk i përfaqëson malazezët që jetojnë në Kosovë dhe nuk mund t'ua mohojnë të drejtën, që këta ta kenë gjuhën e vet, për shkak se shikoni ku e kemi në letërnjoftim, që e ka shkruar “Republika e Kosovës” stema e Kosovës është e shkruar në çirilicë, që në fakt, as unë s'e kuptoj. Dhe, në Kushtetutën e Kosovës thotë “përdorimi i gjuhës serbe dhe alfabeti”. Cili alfabet, pse s'është shkruar? Ndoshta profesorët që kanë qenë përpara e dinë më mirë!

Sidoqoftë, edhe njëherë e përsëris, në rast se ka shkelë procedurën e rregullt të propozim amendamentit, mund ta ktheni ligjin prapa, mund t'i ndiqni procedurat e rregullta, por në parim të gjithë anëtarët e komisionit, përjashto komunitetin serb, ose nënkryetarin e komisionit zotin Bojan, i kanë dhënë përkrahje këtij propozim-amendamenti. Dhe, i kisha lutur deputetët, që ky debat duhet të jetë i koncentruar pikërisht në këtë, se ky është problem më serioz se sa a do ta kenë boshnjakët të drejtën e përdorimit të gjuhës së vet apo jo. Faleminderit! Kaq kisha!

*(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)*

KRYESUESI: Zoti Sabri Hamiti e ka fjalën, nënkryetar i Kuvendit.

SABRI HAMITI: Faleminderit, zoti kryesues i seancës!

Tash, në temë e kishim një amendament dhe kaluam në tema shumë më të gjera dhe raporte shumë më të gjera. Ta kemi të qartë, sepse në këtë rast amendamenti ishte pretekst, por mënyra e shtrimit të problemeve janë përtej atij amendamenti.

Zotëri Haradinaj e tha që ata e kanë përkrahur një amendament të një kolegu, sepse mendojnë që harmonia e komisionit, siç e tha Haradinaj, ruhet në këtë formë, krejt në rregull është. Po de, harmonia në komision, të gjitha grupet përfaqësuese janë pajtuar, unë kështu e kuptova. Tash, nuanca në të folur mund të jetë, si të doni e them. Unë dola të them këtë dhe, po e shfrytëzoj rastin, sepse u hapën probleme që në këtë Parlament, nëpër sesione të ndryshme dhe legjislatura të ndryshme janë përmendur e janë rishfaqur. Rreth këtyre problemeve ekziston Kushtetuta, e drejta kushtetuese dhe sa i përket problemit të gjuhës e drejta e përdorimit të gjuhëve.

Me Kushtetutë kemi dy gjuhë zyrtare dhe gjuhë të tjera në përdorim zyrtar, që nuk është e njëjta gjë. Ajo që është zyrtare i bie që duhet të përdoret në të gjitha dokumentet, në të gjitha letrat që shkruhen brenda republikës së Kosovës. Ajo që është gjuhë në përdorim zyrtar, specifikohet me Ligjin për përdorimin e gjuhëve, ku caktohet një përqindje e popullsisë që e flet një gjuhë në një terren, që nuk ka përqindja nuk i referohet Kosovës, por një komune. Kjo është me rëndësi ta dinë, ata që e kanë studiuar e dinë se nuk është e njëjta gjë. Por, nëse në një komunë ajo përqindje, unë nuk po e them, se e dinë të gjithë sa është, nuk plotësohet, ajo gjuhë nuk bëhet në përdorim zyrtar. Dikujt i bie mirë diku, dikujt i bie keq diku, pra nuk ka rrafshim, përqindja nuk i referohet popullsisë së Kosovës, por popullsisë së një komune. Kjo është me rëndësi të dihet, të bëhet saktë për çka po flasim.

Tjetra, problemet... unë do ta kryej, flisni pastaj, çka të doni thoni, punë për ju. Por, unë po ndjej nevojë sot këtu me i thënë këto gjëra, i kam thënë edhe tjera herë, por disa nuk i kanë dëgjuar.

Këtu po përzihet problemi i të drejtës Kushtetuese e ligjore me probleme identitare. Dhe, po e përziejnë edhe ata që janë entitete më të vogla, s'po u them pakica edhe ato që janë më të mëdha. Këtu patëm një diskutim të gjatë, që u bë rreth asaj që propozoj Nahiti, e njëjta gjë është, pak a shumë është e njëjta gjë. Veçse, po kemi të bëjmë prapë me letërnjoftim, kemi të bëjmë me një specifikim në atë letërnjoftim. Nuk është i njëjti problem, por jemi te i njëjti dokument dhe për shtesa, plotësime të të njëjtit dokument. Nuk kemi si s'pajtohemi, zotërinj të komisionit, se kështu është.

Eh tash, po përzihet, thash edhe njëherë, problemi, se edhe problemi i propozimit të Nahitit është problem identitar. Edhe tash, kur po diskutohet, nuk po diskutohet për përdorim praktik të gjuhëve, por për diskutim të gjuhëve në një dokument zyrtar për të ngritur problem identitar, veçori që është tepër e rëndësishme për një nocion, cilido qoftë.

E tash, problemi te ne këtu në Kosovë nuk është i thjeshtë, për shkak se po përzihen këto probleme. Te dikush gjuha është problem themelor identitar, unë e di që te shqiptarët është përcaktues historik identitar. Prandaj, edhe e duam gjuhën e njësuar, sepse po të përdornim kritere të të tjerëve, ne do t'i kishim dëgjuar. Dialektet bëhen probleme identitare dhe nëse nacioni përcaktohet me dialekt, bëhen dy.

Pra, ka popuj që problemin e gjuhës, mënyrës së të folurit ose dialektin e bëjnë problem identitar, është problem i tyre. Ka që tash po e bëjnë edhe kulturor dhe identitar edhe alfabetin, sepse ai që... e tha dikush këtu edhe ka të drejtë, serbi në Kosovë insiston, thotë "problem identitar" po thonë serbët e Kosovës që janë në Republikë të Kosovës, është serbishtja dhe në çirilicë, sepse në latinicë është problem kulturor, jo identitar. Tash, këtu dikush e mori argument, tha jo se në serbi

po e shkruakan në latinicë, nuk e di qysh e shkruajnë. Kjo vetvetiu tregon, që nuancimi kulturor ka kuptim politik, tash identitar, politik, interes politik, e tjera... po përzihen shumë çështje, që në të vërtetë janë të thjeshta.

Ne nëse insistojmë që në dokumentet zyrtare, që janë dokumente të Kosovës, jo të një komune, se vërtetimin për diçka e merr në komunë, po dokumentin e lejes së njoftimit, merre ne cilëndo komunë, ai komunikon për Kosovë, përtej Kosove shtetet ku qarkullojnë veç me leje, në Ballkan gati po bëhet puna për të kaluar me leje njoftimi. Në Evropë, ju e dini që kalojnë të gjithë ata me leje njoftimi, domethënë është dokument themelor. Atëherë, po them, mos... ku është nevoja, le të studiohet, le të bëhet, po mos të shkojmë në ekstremin e krijimit të diferencimeve brenda të të folurit, gjuhëve, alfabeve, sepse pjesëtimi bëhet shumë i madh dhe pastaj komunikimi na bëhet “babiloni” neve këtu. Në mes gjuhëve të ngjashme, me kulturë të përafërta edhe gjuhëve që s’kanë origjinë të përbashkët, se në Kosovë edhe kemi gjuhë që kanë origjina të përbashkëta, por edhe kemi gjuhë që kanë origjina as gjuhët evropiane, indoevropiane klasifikohen në dy krahë. Kështu që, e thash edhe njëherë, problemi identitar i nacioneve është i ndryshëm edhe i kulturave e shkrimit është i ndryshëm, por në një rregullim politik, demokratik, institucional, qysh është Kosova krijohen marrëveshjet, të cilat janë të domosdoshme për të mos krijuar mosmarrëveshje pafund. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Regjia, zotit Ibishi fjalën!

**NUREDIN IBISHI:** I nderuar zoti kryesues,

Të nderuar deputetë dhe deputete,

Unë vetëm do të lidhesha në çështjen që u diskutua përafërsisht rreth rrumbullakimit dhe një prej përkrahësve të këtij amendamenti, për arsye se edhe, siç tha nënkryetari, domethënë është në Kushtetutë, në nenin 5 është përcaktuar saktë se cilat janë gjuhët zyrtare në Kosovë, domethënë gjuha shqipe dhe gjuha serbe.

Mirëpo, Qeveria ka interpretuar ndryshe Ligjin për përdorimin e gjuhëve dhe ndërkohë ka futur gjuhën turke, si gjuhë për dokumentet civilë dhe atë letërnjoftimin, me siguri nënkupton edhe për të tjerat. Kështu që, për shkak të këtij përjashtimi, unë jam përkrahës i kësaj, i këtij amendamenti dhe mendoj se pasi që është bërë veç një përjashtim, tha edhe nënkryetari, që me Kushtetutë është saktësisht e përcaktuar, ndërsa Qeveria ka interpretuar ndryshe Ligjin për përdorim të gjuhëve, domethënë ka dhënë mundësi të tjera, e kuptimin e ka krejt ndryshe, për arsye se në nivelin lokal, edhe formularët edhe aspekti i përdorimit të gjuhëve u jep të drejtë edhe pakicave etnike në Kosovë, përdorimit të gjuhëve të tyre, mirëpo jo edhe në dokumente qendrore.

Mirëpo, kur është bërë ky përjashtim ne i kemi bërë edhe më shumë koncesione të tjera edhe... sidomos ndaj pakicës apo ndaj serbëve, mendoj se nuk është e përjashtuar edhe kjo të bëhet edhe për gjuhën boshnjake të futet në këtë dhe mendoj se duhet të përkrahët ky amendament.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zonja Tërmkollit e ka fjalën.

**MELIHATE TËRMKOLLI:** Faleminderit!

Kryesues,

Të nderuar deputetë,

Është një çështje që u hap në fakt, ndoshta pa dashur, u hap një temë shumë e rëndësishme dhe një temë shumë kruciale për funksionimin, jo vetëm të institucioneve, por edhe për çështjen e të drejtave, qoftë minoriteteve, qoftë të drejtave të bashkësive etnike, në përgjithësi.

Unë e di, që ligjin kur e kemi bërë më 2006, 2007 ka qenë nën mandatin e ministrisë të cilën e kam udhëhequr, e kemi pas paraparë diku nja 18% përdorimi zyrtar të atij komuniteti, që jeton në Kosovë, sepse kështu ishin praktikat në Botë. Praktika më e mirë, më e favorshme në Botë ka qenë 8%, praktika më e favorshme dhe atë, ka qenë diku në shtetet e Beneluksit e të tjerë... edhe e kemi sjellë kështu në Parlament. Domethënë, 8% e qytetarëve minoritarë në se janë 8% atëherë gjuha e tyre mund të jetë gjuhë zyrtare, ne shkuam jo 5% po shkuam 3%, sepse... OK, nuk po dua të them që u bë keq, ndoshta u bë mirë. Gjuhë zyrtare e bëmë gjuhën serbe me 5% të qytetarëve, që jetojnë këtu edhe minoritetet tjera me 3%.

Tash, të jemi shumë të sinqertë edhe shumë realë, se nuk është kjo punë çështje e dhënies, e sadakas, e kurrkujt, por është çështje e një të drejte. Është çështje e një të drejtë dhe një realiteti e mos të sillemi tash këtu me hipokrizi, kishe ne dikush po i duam më shumë minoritetet, dikush po i do më pak. Ne kemi këtu çështje ligjore, çështje të së drejtës, çështje edhe të praktikave më të mira ndërkombëtare, e tjerë... edhe ne i kemi tejkaluar të gjitha këto praktika ndërkombëtare në krejt Botën, në krejt Botën. Te ne ku ka 3% është përdorim zyrtar, 5% është gjuhë zyrtare. Gjuhë zyrtare, a... mos harroni. Tash, problemi shtrohet këtu, letërnjoftimet në gjuhën turke, kush i ka bërë ato, unë nuk e di, po ka bërë katastrofë. Ajo nuk shkon. Le të më falin këta njerëz. Nuk e kam kurrgjë as me komunitetin turk, mirëpo nuk mund të themi hajt ia paskemi bërë një favor pasi e kemi lejuar këtë punë. Nuk është punë lejimi këtu. Këtu është punë, rendi, rregulli, ligji dhe ju lutem shumë, në bazë të kujt e kanë bë. Letërnjoftimi nuk është çështje e përdorimit zyrtar. Letërnjoftimi është çështje e gjuhës zyrtare. Është çështje e gjuhës zyrtare e jo përdorim zyrtar.

Ndoshta këto që po i thonë zotërinjtë - formularë. Mund të jetë çështja e përdorimit, por letërnjoftimi nuk është çështje e përdorimit. Ajo është çështje e gjuhës zyrtare. Dhe, unë kërkoj, nga kjo foltore, rishqyrtimin e menjëhershëm të kësaj çështjeje. Nuk guxon kjo të kalojë kështu. Dhe, ata njerëz, duhet me u marrë në përgjegjësi, kush ka bërë, “me leje të Bajram Begut”. Kjo punë është bërë me “leje të Bajram Begut”, e as me ligj e as me Kushtetutë. Prandaj, këto gjëra duhet me i pa.

Dhe, pasi veç u hap kjo temë, unë nuk e di, pas pavarësimit të vendit... Mos çoni fort pluhur! Pas pavarësimit të vendit, ju e dini se shumicën e ligjeve na i kemi rishqyrtuar, i kemi riprodhuar ndoshta. Ligji për gjuhë zyrtare, me sa di, mund të jem gabim, nuk ka hyrë në këtë procedurën e rishqyrtimit. Ndoshta kishte me qenë mirë, disa çështje që kanë mbet ende pak a shumë pezull të definohen shumë më saktë e më qartë dhe të kërkohet prej Qeverisë të rishqyrtohet. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Paçaku e ka fjalën!

**KUJTIM PAÇAKU:** Faleminderit, i nderuar kryesues!  
Të nderuar deputetë,

Që nga amendamenti i zotëri Hasanit, që e solli një debat mjaft interesant, ndoshta sa i jemi larguar ligjit gjegjësisht rendit të ditës, nuk e di.

Prej diskutimit në diskutim po arrihet t'i kristalizojmë disa gjëra dhe unë e falënderoj zotëriun kryetar i Komisionit për medija, zotëri Zenun i cili i shtjelloi dhe dha informata.

Suksesi i përdorimit të gjuhëve është suksesi i një shteti. Nuk duhet tash për letërnjoftimin, për përdorimin e gjuhës rome në letërnjoftim, por duhet të flas mbi respektin që duhet të kemi për gjuhën rome. U klasifikua dhe qartësua mjaft mirë gjuha zyrtare dhe gjuha në përdorim, por kur është gjuha në përdorim atëherë nuk duhet tani të bëhet leksion nga romologjia, të flas për dialektet apo për pogadialektet e gjuhës. Edhe gjuha rome është e familjes indo-evropiane, sikurse është gjuha shqipe dhe gjuhët tjera, por kjo gjuhë jeton dhe vepron në Kosovë, në Ballkan, në Evropë afër shtatë shekuj.

Çka do të thotë, gjuha në përdorim? Gjuha rome sot, edhe para lufte, është përdorur nëpër shkolla fillore si mësim fakultativ. Gjuha rome është përdorur si gjuhë në media, në televizion, në radio dhe në media të shkruara.

Mua më pengon fakti i 3%-shit. Që nga regjistrimi i vitit 2011, kur është bërë regjistrimi i popullatës, pjesa dërrmuese e të intervistuarve të lagjeve rome...

**KRYESUESI:** Të lutem, rreth amendamenteve përqendrohuni, sepse për to po flasim, nuk kemi të bëjmë me regjistrime tash. Të lutem!

**KUJTIM PAÇAKU:** Po e përfundoj! Nuk ka pasur të regjistruar rom. Në bazë të kujt dihet përqindja e popullatës rome. Migrimet dhe vala e fundit për të migruar...

**KRYESUESI:** Të lutem, e kemi amendamentin dhe lidhur me dokumentin që e ka propozuar Qerim Bajrami po diskutojmë, e mos na futni tash 'llugave', dhe para Luftës së Parë Botërore.

**KUJTIM PAÇAKU:** Nuk është i 'llugave', por po flitet për nderin e një gjuhe. 3% duhet të hiqet sepse kjo gjuhë rome nuk është nga dje dhe përdoret që afër shtatë shekuj në Kosovë. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Me nder qofshi! Zoti Bojan Mitiq e ka fjalën!

**BOJAN MITIĆ:** Gospodine predsedavajući,

Poštovane kolege,

Pošto sam ja direktno prozvan malopre, moram da kažem sledeće. Ovaj amandman koji je predložio gospodin Čerim Bajrami, smatram da je to amandman Bošnjačke zajednice.

Bošnjačka zajednica svakako ima moju podršku kao predstavnika Srpske liste i imaće podršku i svih poslanika ispred Srpske liste.

Što se tiče glasanja samog u Komisiji, tu je došlo do greške i sad da li je moja krivica ili nečija druga, nije bitno i ne bih da ulazim u tom, ali još jednom da ponovim da Srpska lista podržava ovaj amandman i podržava ćirilčno pismo. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Bekim Haxhiu e ka fjalën!

BEKIM HAXHIU: Faleminderit i nderuar kryetar!

Faleminderit që e hape apo në fakt, e rihape këtë debatin për përdorimin edhe të komuniteteve tjera në letërnjoftimet zyrtare në këtë ligj. Plotësisht pajtohem me atë që e tha profesor Hamiti, por edhe me atë që e tha Nait Hasani.

Tani po diskutojmë për një shkrim të përdorimit të komuniteteve apo të etnive në letërnjoftim. E përkrah edhe këtë, do të thotë të përdorimit dhe përcaktimit në bazë të etnive në përdorimin e formularëve të tyre por edhe në letërnjoftim.

Është pak 'non sens', atëherë përse refuzohet që edhe poshtë në letërnjoftim të shkruhet etnia. Po dëshironi në formularë të jetë gjuha turke, në rregull. Po atëherë, pse po refuzoni që edhe në letërnjoftim me u shkrua etnia. Le të dihet, Kosovës ky disibilitet i etnive, i kulturës, e pasuron vendin tonë.

Dhe, dua të potencoj një rast, që viteve të kaluara, ndoshta edhe viteve tjera mund të ndodhë, por është abuzuar në regjistrime në universitet në emër të partive politike që i përfaqësojnë komunitetet këtu dhe kanë marrë vërtetime prej partive politike për t'u regjistruar në universitet. Por nëse në dokumentin zyrtar është e shkruar etnia, kombësia, kombi atëherë është në rregull, nuk duhet të abuzohet dikush pastaj me këtë. Mirëpo të gjithë e dimë se ka pasur shkrime edhe në media, që në emër të kësaj është bërë.

Prandaj, kërkoj dhe ndoshta do të kishte qenë mirë që komisioni edhe një herë të ulet e t'i rishqyrtojë këto amendamente dhe në veçanti që komisioni t'i japë përkrahje amendamentit të deputetit Nait Hasani, se është në tjetrën frymë, në të cilën është i përfshirë edhe propozimi i deputetit Qerim Bajrami. Është e njëjta gjë. Është ajo çka ka kërkuar Nait Hasani dhe kjo që po kërkon deputeti Qerim Bajrami, është e njëjta gjë.

Prandaj, do të duhej të kalonin edhe kjo, edhe ajo. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ismajl Kurteshi e ka fjalën!

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Unë mendoj që Komisioni e ka pas parasysh harmonizimin e këtij amendamenti me Kushtetutën dhe besoj që e ka bërë atë dhe me këtë duhet të merren ekspertët, të cilët e përcjellin këtë çështje të harmonizimit.

Për mua kërkesa e deputetëve të komuniteteve që t'i gëzojnë të drejtat e tyre kushtetuese është krejt normale dhe e drejtë dhe unë e përkrah një çështje të tillë.

Madje edhe kërkesa e tyre, edhe nëse nuk është në Kushtetutë dhe angazhohen që të realizojnë një të drejtë, po ashtu është e drejtë dhe detyrë e secilit komunitet që të luftojnë për të drejtat e komunitetit të vet të cilin e përfaqësojnë këtu.

Unë me këtë rast nuk mund të mos e përmendi edhe një çështje e cila lidhet me deputetët e komuniteteve pakicë të cilat vendet amë i kanë këtu në Ballkan e në të cilat vende jetojnë shqiptarët dhe të cilët nuk i gëzojnë as përafërsisht këto të drejta. Këta deputetë që këtu i kërkojnë të drejtat e veta me të drejtë, kanë obligim edhe moral, edhe zyrtar, meqë janë zyrtarë të lartë të Republikës së Kosovës që të angazhohen për reciprocitet, që qytetarët shqiptarë në Serbi, në Bosnje, në Turqi, e dhe në vende tjera t'i gëzojnë vetëm këto të drejta që po i gëzojnë këto komunitete në Kosovë, sidomos në Luginën e Preshevës, ku atje diskriminohen jashtëzakonisht shumë, por natyrisht...

**KRYESUESI:** Ismajl, të lutem rreth amendamenteve!

**ISMAJL KURTESHI:** Të lutem Xhavit, sepse po diskutohet edhe përtej amendamentit. Dhe, në asnjë vend nuk i kanë shqiptarët të drejtat të cilat i gëzojnë jo vetëm këta deputetë, por këto komunitete dhe të cilat janë të pakënaqura dhe unë po ashtu them këta le të kërkojnë edhe më tutje që të kenë edhe më shumë të drejta, por të mos harrojnë se vendet e tyre amë i kanë shumë borxh komunitetit shqiptar atje dhe duhet të angazhohen që ato të drejta t'u lejojnë t'i realizojnë shqiptarët. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! E fundit është Duda Balje dhe i fundit është zoti Mustafa, e tjerë nuk ka, dy herë s'ia jep askujt fjalën për të njëjtën çështje.

**DUDA BALJE:** Zahvaljujem!

Poštovani poslanici,

Samo da vas obavestim da je i pre pripreme samog amandmana dodan na Komisiji, mi smo konstatovali Ustav i zakon i definitivno smatramo da ovaj amandman ne krši ni Ustav ni zakon.

Imamo zakon o jezicima i potpuno smo ga ispoštovali i pre toga i mi se upravo i pozivamo na taj zakon.

Što se tiče opštine gde Bošnjaci žive i u koje imamo više stanovnika, ili onoliko koliko je po procentu po zakonu nalaženo, mi tražimo samo da se u ličnim kartama ubaci latinično pismo. Znači, ne kršimo nikakav zakon i meni je stvarno žao što se vi veći bojite manjih i vi ste nekad bili na našem mestu. Mi nemamo profesore problema sa identitetom, to što tražimo da naš bošnjački jezik bude na ličnim kartama niko ne može da negira da, recimo u opštini Prizren postoji zavidan broj Bošnjaka i da moje dete koje sad u opšte ne zna ćirilicu jer nije imao kontakt sa ćirilicom, rođena na Kosovu, ovde je išla u školu, moje dete sada u 16 godini dobila ličnu kartu i ne zna šta na njoj piše, jer ćirilčno pismo nije učio. On je stanovnik Kosova, kosovar je i rođena je ovde.

Znači, tražimo osnovna prava. Amandman je prošao kroz Komisiju i imao je potpunu podršku Komisije i ja očekujem da se ne ulazi u detalje, jer ako uđete u detalje mi ništa ne kršimo nego samo tražimo da se naša prava ispoštuju. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Mustafa! Apo, për replikë, e kërkon fjalën zoti Hamiti! Më fal Muhamet, se nuk e pashë kur u paraqit!

SABRI HAMITI: Jo veç nacionet, të mëdha e të vogla, por edhe grupet më të vogla brenda nacionit kanë elemente përcaktuese identitare. Është qesharake në të njëjtën kohë pikërisht me insistua në një identitet dhe në të njëjtën kohë me i thënë dikujt pse po e përmend. Ka identitete fetare dhe njeriu është me plot elemente identitare, gjuhësore, kulturore, fetare e tjera, e tjera.

As s'është më i mirë njëri as s'është më i keq tjetri, se ka pjesëtime identitetesh, dhe kuptoni drejt këtë punë. Mos insistoni. Insistimi në to, do të thotë është identitet. Kaq.

Dhe i gjuhës, keni kujdes! Punë për ju është, merreni qysh të doni, por më detyrove se më thirre me e thënë: merre identitetin, mos të vjen keq nëse e ke. Por unë nuk i them kurrkujt bëne filan elementi në identitet, se është problem i tij. Sepse, meqë po flasim për këto gjuhë që i njoh mirë prej zanatit, atëherë keni kujdes. Tashi, qysh me e shkrua kroatishten pra në Kosovë, se është një grup kroat – grupacion i cili thotë, dhe thotë, dhe janë kroatë. Qysh ta shkruajmë kroatishten? Duhet shkruar në latinicë, sepse nuk shkruhet cirilikë. Problemi tash është edhe... Rrini rahat ju boshnjakët, për ju s'po flas tash! Ju e thatë çka keni!

Atëherë, malazezve, qysh t'ua shkruajmë gjuhën? Në cirilikë, apo në latinicë? Kjo nuk është problem që e zgjedh Kuvendi i Republikës së Kosovës. Ky është problem identitetesh, të gjithë e kanë nivelin kulturor të vetin, trashëgiminë e vet, por nuk është problem i Kuvendit të Republikës së Kosovës t'i zgjidhë këto, por kur bëni replika, por jo në kuptimin konstitucional se ato të drejta dihen. Edhe përdorimi zyrtar i gjuhës dhe përdorimi individual, janë dy sende krejt të ndryshme. Ju e dini!

Ne po flasim për kategori kushtetuese, jo qysh e flet njeriu, a e flet argo-gjuhën e vet, a e flet në gjuhën letrare, sepse në tri nivele edhe ju vetë, po edhe unë e flas në dy-tri nivele dhe varet ku e flas. Kjo është punë individuale e artikulimit. Po puna e përcaktimit kushtetues është ai që është. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Muhamet Mustafa e ka fjalën!

MUHAMET MUSTAFA: I nderuar nënkryetar i Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Mendoj se sot e bëmë një debat që dolëm pak edhe jashtë suazave të një amendamenti, mirëpo janë këto probleme reale prandaj u sqarua dhe mendoj që debati megjithatë është i dobishëm, por unë e përkrah amendamentin që e ka propozuar Komisioni sepse në esencë unë sa po e kuptoj Kushtetutën dhe ligjin është harmonizimi këtu i dokumentit, dhe është në harmoni me afirmimin e të drejtave të minoriteteve dhe ne këtu nuk duhet të jemi restriktiv, kështu që mendoj se e kemi një amendament që e ka aprovuar komisioni një zëri dhe ne nëse kemi kuorum, propozoj që ta votojmë këtë amendament dhe nëse s'kemi kuorum, e votojmë kur kemi kuorum dhe faleminderit.

KRYESUESI: Deputetët votojnë, por jo në kundërshtim me Kushtetutën, pa marrë parasysh dëshirën tënde Muhamet Mustafa. Ti mund të kesh dëshirë edhe në shtëpi të flasësh ndryshe, por unë këtu nuk votoj diçka që është në kundërshtim me Kushtetutën.

Pra, nuk ka kuorum, i mbyll punimet dhe kjo po mbetet për Sesionin e shtatorit.

*E përgatiti:  
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*